



**SIGMA**

**Mbështetje për përmirësimin e Qeverisjes dhe të Menaxhimit**

Iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit European, financuar kryesisht nga BE

**STRUKTURAT DHE KAPACITETI I PROKURIMIT PUBLIK NË NIVEL QENDROR NË SHTETET  
ANËTARE TË BASHKIMIT EUROPIAN**

*DOKUMENTI i SIGMA-s NR. 40*

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit European. Pikëpamjet e paraqitura në të nuk përfaqësojnë opinionin zyrtar të Bashkimit European dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e OECD-së dhe të vendeve anëtare të saj apo të vendeve përfituese, pjesëmarrëse në Programin SIGMA.

## PROGRAMI SIGMA

Programi SIGMA - mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe të menaxhimit - është një iniciativë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Bashkimit Europian (BE), financuar kryesisht nga BE.

Duke punuar në partneritet me vendet përfituese, Sigma mbështet qeverisjen e mirë përmes:

- vlerësimin të përparimit të reformave dhe identifikimit të përparësive bazuar në të dhëna bazë që pasqyrojnë praktikën e mirë europiane dhe legjislacionin ekzistues të BE-së (the *acquis communautaire*);
- dhënies së ndihmës për vendimmarrësit dhe administratat në ndërtimin e institucioneve dhe të procedurave për realizimin e standardeve dhe praktikën e mirë europiane;
- lehtësimin të ndihmës nga BE dhe donatorë të tjerë brenda dhe jashtë Europës duke ndihmuar për hartimin e projekteve, garantimin e parakushteve dhe mbështetjen për zbatimin.

Në vitin 2007 Sigma po punon me vendet partnere që vijojnë:

- **Shtetet e reja anëtare të BE-së** - Bullgaria dhe Rumania
- **Vendet kandidatë të BE-së** Kroacia, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia
- **Vendet e Ballkanit Perëndimor**- Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina (shteti, federata e B&H dhe Republika Srpska), Mali i ZI, Serbia dhe Kosova (që qeveriset që në qershor 1999 nga UNMIK (Misioni i Përkohshëm Administrativ i OKB/UN Interim Administration Mission in Kosovo).
- **Ukraina** (aktivitetet e financuara nga Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar).

Programi SIGMA mbështet përpjekjet për reforma të vendeve partnere në fushat si më poshtë:

- Kuadri ligjor dhe administrativ, shërbimi civil dhe drejtësia, sistemi i integritetit publik
- Kontrolli i brendshëm financiar publik (KBFP), auditimi i jashtëm, lufta kundër mashtrimit, menaxhimi i fondeve të BE-së
- Menaxhimi i shpenzimeve publike, sistemet e buxhetit dhe të thesarit
- Prokurimi publik
- Hartimi i politikave dhe koordinimi
- Normimi më i mirë.

Për më shumë informacion mbi Programin SIGMA, shihni faqen tonë të internetit:

<http://www.sigmaweb.org>

**Të drejtat e autorit: OECD, 2007**

**Ky material është botuar për herë të parë në gjuhën angleze nën titullin: *Central Procurement Structures and Capacity in Member States of the European Union.***

**OECD autorizon përdorimin e këtij materiali pa pagesë, për qëllime jofitimprurëse. Të gjitha kërkesat për përdorim për qëllime fitimprurëse të këtij materiali ose për marrjen e të drejtave të përkthimit të materialit duhet të dërgohen në adresën elektronike [rights@oecd.org](mailto:rights@oecd.org).**

## PARATHËNIE

Shtetet anëtare të BE-së kanë nevojë për struktura organizative për kryerjen e funksioneve të prokurimit publik. Këto detyra kanë një shtrirje të gjerë: që nga hartimi i legjislacionit përkatës dhe hartimi i politikave për prokurimet publike deri në trajnimin e punonjësve prokurues dhe publikimin e njoftimeve të kontratave. Shumica e shteteve anëtare të BE-së kanë organe qendrore të prokurimit publik brenda strukturave të tyre qeveritare. Megjithëse ndryshojnë përsa i përket përgjegjësi, funksioneve dhe detyrave, këto organe kanë disa tipare të përbashkëta. Krahasuar me tablonë krejt uniforme që haset në shtetet e reja anëtare, 15 shtetet “e vjetra” anëtare paraqesin një tablo më të larmishme. Ndryshimet e vëna re në mënyrën se si janë organizuar funksionet e prokurimit qendror në shtetet anëtare, ngrenë një numër çështjesh themelore, të tilla si:

- arsyet kryesore të ndryshimeve midis shteteve anëtare në vendosjen e modeleve dhe të funksioneve të organizimit;
- mundësia e identifikimit të avantazheve dhe të disavantazheve të disa modeleve në organizimin e disave prej përgjegjësi kryeore që lidhen me funksionet e prokurimit në nivel qendror, duke marrë parasysh rrethanat specifike të shteteve të reja anëtare dhe të vendeve candidate.

Për shtetet e reja anëtare, krijimi i organeve qendrore të prokurimit publik është vlerësuar për ndikimin e tyre të fuqishëm në zhvillimet e suksesshme të kohëve të fundit dhe po ashtu në pozitën krahasimisht të favorshme të sistemeve të prokurimit publik në këto vende. Të gjithë aktorët kryesorë të sistemit të prokurimit publik - përfshirë parlamentin, qeverinë, entet kontraktuese, sektorin privat dhe qytetarët - mbështeten gjerësisht në faktin se sa mirë e mbështesin organet e prokurimit publik zhvillimin e një sistemi kombëtar të shëndoshë dhe eficient të prokurimit. Zotërimi i kapacitetit të mjaftueshëm administrativ, pavarësisht nga modeli i organizimit ose sistemi në fuqi, do të mbetet gjithmonë i rëndësishëm për të gjitha shtetet e sotme anëtare dhe shtetet që do të anëtarësohen në të ardhmen në BE. Kjo është e vërtetë po të kemi parasysh ndryshimet e parashikuara që do të ndodhin gjatë dekadës tjetër në lidhje me kuadrin legjislativ dhe rregullator, me zhvillimin teknologjik, me zhvillimin e sektorit publik, me forcimin e kapacitetit dhe matjen e performancës, me rritjen e integritetit dhe me koordinimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Ky studim paraqet një analizë të funksioneve, të strukturës, të statusit brenda qeverisë dhe të kapacitetit të organeve të prokurimit qendror publik të shteteve anëtare. Ai nuk përpiket të vlerësojë avantazhet/disavantazhet përkatëse të tyre apo të rekomandojë masa të veçanta institucionale. Mbi bazën e përgjigjeve kombëtare ndaj një pyetësi të hollësishëm u përgatitën 22 profile të veçanta të sistemeve të prokurimit publik në 22 shtetet anëtare pjesëmarrëse në studim. Studimi paraqet gjithashtu edhe një vlerësim të thellë të sistemeve të këtyre vendeve i cili bëri të mundur analizën krahasuese të këtij studimi. Kjo pjesë e analizës merret me trajtimin e modeleve të ndryshme në këto shtete anëtare, në veçanti me kontekstin dhe justifikimin e përdorimit të modelit të caktuar institucional.

Pikëpamja e Sigma-s është se kuptimi dhe njohja më e mirë e organizimit dhe e aftësive të strukturave qendrore të prokurimit publik në shtetet anëtare të BE-së do të shërbejë si një frymëzim dhe do të ndihmojë shtetet candidate të sotme e të nesërme për anëtarësim në BE si edhe vende të tjera partnere të Sigma-s në përpjekjet e tyre për ndërtimin ose reformimin e sistemeve të prokurimit publik.

## Metodologjia

Ky studim është kryer nga Ekipi i Projektit të Sigma-s dhe është rishikuar nga një Ekip Homolog. Të dhënat e nevojshme u grumbulluan përmes një pyetësoari të hollësishëm, i cili u dërgua në vitin 2006 në Pikat e Kontaktit në 25 shtetet anëtare të BE-së të asaj kohe si edhe në Bullgari dhe Rumani (zgjerimi i BE-së i janarit 2007). Studimi pasqyron situatën në shtetet anëtare në gusht të vitit 2006. Të gjitha shteteve anëtare iu është dhënë mundësia të bëjnë komentet e tyre mbi raportet për vendet e veçanta (shih tek Shtojca).

Anëtarët e **Ekipit të Projektit të Sigma-s** ishin Z. Martin Trybus, Z. Peder Blomberg dhe Z. Piotr-Nils Gorecki. Një **ekip homolog** u formua me qëllim që të bënte komente për metodologjinë, pyetësoarin, dhe projektraportin dhe raportin përfundimtar. Ky ekip përbëhej nga Z. Tomi Hytonen (Finlandë), Znj. Gabriele Herlemann (Gjermani), Z. Marian Lemke (Poloni), dhe Znj. Lourdes Camacho (Portugali).

U krijua gjithashtu edhe **Rrjeti i Pikave të Kontaktit** brenda administratave publike të shteteve anëtare që mori detyrën të furnizonte Ekipin e Projektit të Sigma-s me dokumentacionin e kërkuar dhe me informacionin në lidhje me strukturimin dhe perceptimin për organizimin e prokurimit qendror. Shumica e Pikave të Kontaktit ishin përzgjedhur ndër anëtarët e **Rrjetit Europian të Prokurimit Publik (REPP)**, i cili është një rrjet ndërkombëtar bashkëpunimi i zyrtarëve ekspertë për prokurime publike që përfshin të gjitha shtetet anëtare të BE-së, anëtarët EEA, Zvicrën, vendet candidate për në BE dhe vende të tjera europiane.

Ekipi i Projektit të Sigma-s përgatiti një pyetësor të hollësishëm i cili iu dërgua për plotësim rrjetit të Pikave të Kontaktit. Aq sa e kishin të mundur, Ekipi i Projektit të Sigma-s dhe Ekipi i Homologëve e analizuan materialin dhe e përdorën si bazë për përgatitjen e raporteve të posaçme për çdo vend si edhe për analiza krahasuese. Ekipit të Projektit të Sigma-s iu kthyen 22 pyetësorë në intervalin mars-gusht 2006 dhe, posaçërisht nga Austria, Bullgaria, Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Polonia, Portugalia, Rumania, Republika Sllovaqe, Sllovenia, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar.

Përsa i përket **kufizimeve të qasjes metodologjike** të përdorur në këtë studim duhet të bëhen disa komente. Së pari, pyetësoarin nuk e kthyen një numër shtetesh anëtare. Në këtë mënyrë, studimi nuk përbën një panoramë të plotë të strukturave të prokurimit publik në të gjitha shtetet e sotme anëtare të BE-së. Megjithatë, 22 nga 27 shtete të mundshme e kthyen atë dhe ky material përfaqëson një reagim pozitiv që është i mjaftueshëm për të ofruar bazën për një tablo kuptimplotë. Së dyti, Pikat e Kontaktit nuk dhanë përgjigje për të gjitha çështjet e pyetësorit i cili ishte relativisht mjaft i gjerë. Kjo disa herë ndodhte ngaqë informacionin ata thjesht nuk e kishin. Kështu që mbulimi i sistemeve kombëtare në raport nuk është i barabartë, përderisa disa Pika Kontakti sollën një informacion të gjerë, ndërsa disa të tjera informacion të kufizuar. Së treti, midis Ekipit të Projektit dhe Pikave të Kontaktit ka ekzistuar një mundësi e caktuar për keqkuptime. I gjithë studimi, përfshirë edhe pyetësorët, u krye në anglisht. Ky problem është trajtuar të paktën pjesërisht në momentin kur të gjitha raportet e vendeve individuale iu dërguan sërish mbrapsht Pikave të Kontaktit për komente. Megjithatë, të dhënat e dërguara nga shtetet anëtare ofrojnë një tablo objektive të sistemeve të prokurimit publik në fuqi.

Studimi nuk merret në mënyrë të veçantë me natyrën e kontratave me të cilat punojnë organet qendrore të prokurimit publik. Në disa shtete anëtare, këto rregullime organizacionale mund të kenë ushtruar ndonjë ndikim në përfundimet e dhëna në pjesën me tablonë krahasuese të studimit. Kjo është e rëndësishme sidomos për ato shtete anëtare në të cilat përgjegjësitë rregullatore për koncesionet nuk ushtrohen nga të njëjtat organe që janë të ngarkuara me rregullimin dhe monitorimin e kontratave të prokurimit publik, por nga një organizatë tjetër e veçantë. Studimit kështu i mungon një informacion sistematik mbi mënyrën e organizimit nga shtetet anëtare të strukturave rregullatore dhe mbështetëse, me referencë të veçantë tek lloji i kontratave.

Ideja themelore që udhëheq studimin është se shtetet anëtare nga pikëpamja organizative nuk përbëjnë ndonjë dallim përse i përket madhësisë së kontratës publike, domethënë nuk diferencohen në lidhje me

faktin nëse kontrata është nën apo mbi pragun e Komisionit Europian. Megjithatë, shtetet anëtare në përgjithësi i rregullojnë në mënyra të ndryshme prokurimet, jashtë fushës së veprimit të Direktivave të Komisionit Europian (KE). Në disa shtete anëtare, këto kontrata mund që edhe të mos jetë të rregulluara me norma ligjore gjë që në parim mund të ketë edhe pasoja institucionale, por në këtë studim nuk ka qenë e mundur të shqyrtohen rrjedhojat e një mundësie të tillë.

## PASQYRA E LËNDËS

PROGRAMI SIGMA.....	2
PARATHËNIE .....	3
Metodologjia .....	4
PASQYRA E LËNDËS.....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
PJESA I. PËRKUFIZIMI I NJË STRUKTURE QENDRORE TË PROKURIMIT PUBLIK .....	9
Hyrje .....	9
1. Identifikimi i funksioneve kyçe të prokurimit publik në nivel qendror .....	10
1.1 Funksionet e legjislacionit parësor dhe të politikave parësore .....	10
1.2 Funksionet e politikave dytësore dhe funksionet rregullatore .....	11
1.3 Funksionet e koordinimit ndërkombëtar.....	11
1.4 Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit.....	12
1.5 Funksionet këshillimore dhe të mbështetjes së operacioneve .....	12
1.6 Funksionet e publikimit dhe informimit .....	13
1.7 Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve .....	13
1.8 Funksionet e zhvillimit dhe të koordinimit të prokurimeve .....	14
1.9 Funksione të lidhura me prokurimin por që nuk zbatohen .....	15
2. Klasifikimi i funksioneve bazë dhe funksioneve plotësuese.....	16
3. Vendndodhja organizative dhe statusi brenda administratës publike .....	16
4. Modeli për klasifikimin e strukturave qendrore të prokurimit publik.....	17
PJESA II. ANALIZË KRAHASUESE E STRUKTURAVE DHE KAPACITETIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË SHTETET ANËTARE TË BE .....	18
5. Strukturat qendrore të prokurimit publik dhe modelet institucionale .....	18
5.1 Modeli i përdorur për klasifikim .....	18
5.2 Skema kryesore e organizimit të funksioneve bazë dhe funksioneve plotësuese të prokurimit18	
5.3 Shtetet anëtare me një strukturë të centralizuar ose gjysmë të centralizuar të prokurimit publik	21
5.4 Shtetet anëtare me një strukturë të decentralizuar të prokurimeve.....	22
5.5 Shembuj të decentralizimit në strukturën e prokurimit publik .....	23
5.6 Mungesa e disa funksioneve të prokurimit publik .....	24
5.7 Funksionet e prokurimit në një korporatë .....	24
6. Modele institucionale dhe skema e organizimit të brendshëm të organeve kryesore të prokurimit publik .....	25
6.1 Baza ligjore.....	25
6.2 Tablo e skemës së organizimit dhe e strukturave vendimmarrëse .....	26
7. Kapaciteti administrativ i strukturave qendrore të prokurimit publik.....	31
7.1 Përkufizimi i konceptit të kapacitetit administrativ.....	31
7.2 Kapaciteti administrativ i organeve qendrore të prokurimeve .....	33
8. Mjedisi që ndryshon i prokurimit publik .....	36
9. Përmbledhje e përfundimeve kryesore .....	38
SHTOJCË. TABLO KRAHASUESE E STRUKTURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK NË SHTETET ANËTARE TË BE .....	40
SHTOJCA: RAPORTET E VENDEVE TË VEÇANTA, SHTETE ANETARE TE BE.....	47

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Funksionet e mundshme për t'u kryer nga institucionet qendrore të prokurimit publik mund të ndahen në detyra që kanë të bëjnë me politikën dhe legjislacionin parësor, bashkëpunimin ndërkombëtar, detyrat administrative dhe të monitorimit, detyrat për zhvillimin dhe koordinimin e biznesit, publikimin dhe informimin, këshillimin dhe mbështetjen e veprimtarive, trajnimin dhe shtimin e njohurive.

Për qëllimet e këtij studimi, detyrat në lidhje me politikën dhe legjislacionin parësor, me koordinimin ndërkombëtar, dhe detyrat administrative dhe monitoruese janë klasifikuar si “**funksione bazë**”, dhe të gjitha detyrat e mbetura konsiderohen si “**funksione plotësuese**”. Funksionet bazë përkufizohen ato funksione të cilat rregullohen me ligjin kombëtar dhe që shpesh lidhen me detyrimet e anëtarësimit në Bashkimin Europian. Prandaj këto funksione duhet të trajtohen në nivelin e qeverisë qendrore dhe kështu ndodh. Për pasojë, të gjitha funksionet e tjera, megjithëse jashtëzakonisht të rëndësishme për funksionimin e sistemit të prokurimit publik, mund të klasifikohen si funksione plotësuese, përderisa ato nuk janë caktuar si detyrim ligjor nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Europian.

Ky studim nuk merret me funksionet e përmirësimit të një gjendjeje të caktuar dhe as me ato të blerjeve në nivel qendror, por përderisa këto funksione disa herë kryhen brenda së njëjtës strukturë organizative si edhe funksionet bazë dhe ato plotësuese, ato janë trajtuar shkurtimisht në këtë studim.

Të 22 shtetet anëtare të BE-së që marrin pjesë në këtë studim mund të ndahen në tri grupe të mëdha në përputhje me strukturat e tyre të prokurimit publik. 11 shtete anëtare vlerësohen si shtete që kanë një strukturë të **centralizuar** prokurimi. Në këto shtete vërehet një përqendrim i funksioneve të prokurimit në pak institucione qendrore. 9 shtete anëtare vlerësohen si shtete me një strukturë **gjysmë të centralizuar** të prokurimit. Në këto shtete vërehet një përqendrim i përzier i funksioneve të prokurimit në një numër institucionesh. 2 shtete anëtare futen në kategorinë e strukturës së **decentralizuar** të prokurimit. Këto shtete i kanë shpërndarë funksionet e prokurimit në një numër organesh brenda administratës publike.

Të gjitha shtetet anëtare i kanë të organizuara funksionet e tyre **bazë** në një mënyrë të **centralizuar**, ndërsa funksionet **plotësuese** mund të kryhen nga një spektër i gjerë organesh, përfshirë këtu edhe sektorin privat, në nivel qendror dhe në nivele të decentralizuara të administratës publike.

Në disa shtete anëtare, funksionet legjislativë dhe të politikës ushtrohen nga strukturat ministrore, ndërsa funksione të tjera të rëndësishme u janë caktuar një organi të posaçëm prokurimesh, i cili mund të jetë pjesë e qeverisë ose të jetë në varësi të parlamentit.

Në ato shtete anëtare që kanë një strukturë të prokurimit publik me një institucion qendror prokurimi, funksionet legjislativë dhe të politikave ushtrohen zakonisht nga i njëjti institucion. Kështu, funksionet legjislativë kryhen vetëm në institucione qendrore të cilat janë pjesë e qeverisë. Këshillimi i qeverisë, formulimi i politikës së prokurimeve, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe disa funksione monitoruese - me fjalë të tjera “**funksionet bazë**” të përmendura më sipër - ushtrohen zakonisht nga institucioni qendror, drejtues. Detyrat që lidhen me trajnimet dhe kërkimin shkencor, zhvillimin dhe administrimin e biznesit, publikimin dhe informimin dhe detyrat administrative dhe monitoruese kryhen jashtë institucionit qendror drejtues.

Në ato shtete anëtare që kanë struktura gjysmë të centralizuar ose të decentralizuar të prokurimit publik detyrat përkatëse ndahen midis institucioneve dhe organizatave të ndryshme. Ndërsa disa institucione, sidomos ministritë përkatëse të financave ose të thesarit, janë gjithmonë përgjegjëse për funksionet rregullatore, jo gjithmonë ekziston një pikë qendrore në formën e një institucioni ose të një organizate të vetme me një theks të veçantë në një institucion ose organizatë të veçantë. Në veçanti, kjo gjen zbatim në shtetet anëtare me një strukturë më të decentralizuar. Kjo kategori është e kundërta e strukturës së

centralizuar të prokurimit, e cila karakterizohet nga një përqendrim i madh i funksioneve të cilat u caktohen pak institucioneve.

Studimi del në përfundimin se kapaciteti administrativ nuk lidhet vetëm me numrin e stafit dhe burimet financiare në dispozicion brenda institucioneve qendrore të prokurimit, por ai ka nevojë të përkufizohet më gjerë. Kapaciteti i përgjithshëm i grumbulluar i shteteve anëtare për të mbështetur veprimtarinë e prokurimit publik mund të jetë i lartë nëse përfshihen të gjithë aktorët e shoqërisë, të tilla si shoqatat e pushtetit lokal e rajonal, entet dhe ndërmarrjet mëdha kontraktuese, institucionet e trajnimit, firmat juridike, dhe kjo do të thotë se nuk kufizohet vetëm në kapacitetin e institucioneve qendrore. Megjithatë, studimi zbulon disa informacione interesante mbi përmasat e burimeve të alokuara në nivel qendror. Në të njëjtën kohë, nuk duhet harruar se madhësia e institucioneve qendrore të prokurimit nga pikëpamja e stafit varet nga një numër faktorësh, të tillë si madhësia e ekonomisë dhe numri i enteve kontraktuese dhe i kontraktave të prokurimit dhe nuk pasqyron patjetër përparësitë e qeverisë. Numri i stafit në institucionet qendrore të prokurimit ndryshon nga njëri shtet anëtar në tjetrin. Për më tepër, përderisa shumë prej institucioneve të rëndësishme merren edhe me disa çështje të tjera përveç funksioneve të prokurimit publik të përmendura edhe më sipër, nuk është gjithmonë e qartë se sa njerëz punojnë aktualisht në funksionet bazë të prokurimit publik dhe sa të tjerë në funksionet plotësuese.

Prokurimi publik në shumicën e shteteve anëtare duket se financohet nga buxheti i përgjithshëm i qeverisë ose i ministrisë dhe në të gjitha shtetet anëtare pjesa më e madhe e kostos së prokurimit mbulohet nga një buxhet i tillë. Hungaria dhe Polonia marrin të ardhura shtesë nga tarifat dhe depozitat që duhen paguar për procedurat e vlerësimit. Megjithatë, një rregullim i tillë do të thotë që ky funksion i analizës duhet të kryhet nga i njëjti institucion që ushtron funksionet e prokurimit publik në nivel qendror, siç përcaktohet ky në këtë studim.

Cilido që të jetë modeli organizacional i zgjedhur, duket se prokurimi publik është zakonisht përgjegjësi e Ministrisë së Financave, e Ministrisë së Ekonomisë, ose e Ministrisë së Punëve Publike. Baza ligjore është shpesh ligji i prokurimit publik ose ligji administrativ. Disa shtete anëtare kanë ngritur zyra ose agjenci të prokurimeve publike, të cilave u kanë dhënë një status më të pavarur duke i vendosur në varësi të parlamentit ose drejtpërdrejt të qeverisë, ndërsa disa shtete të tjera i kryejnë këto funksione përmes departamenteve brenda strukturave të ministrive. Disa funksione të një natyre operacionale kryhen nga kompani publike.

Evolucioni i funksioneve kyçe të prokurimeve trajtohet shkurtimisht në dritën e ndryshimit të mjedisit të prokurimit publik, i cili është duke u rritur shkallë shkallë në tërësi si rrjedhojë e përdorimit të instrumenteve dhe mekanizmave të rinj të prokurimit, të zhvillimeve teknologjike, dhe të theksit më të madh në efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike. Çdo strukturë prokurimi do të ketë nevojë të mendojë se si të rrisë me shumë profesionalizimin e funksionit të prokurimit dhe si t'i plotësojë nevojat për zhvillim, veçanërisht se si të zhvillojë më shumë strukturën e mbështetjes së prokurimit. Këtë del se është shumë e rëndësishme të gjendet një model i përshtatshëm global organizimi cili siguron një ekuilibër efektiv dhe të natyrshëm midis specifikave të funksioneve të përfshira dhe kërkesave të këtyre funksioneve për sa i përket pavarësisë dhe bashkëveprimit, dhe në të njëjtën kohë të shmangë konfliktin e interesave.



## PJESA I. PËRKUFIZIMI I NJË STRUKTURE QENDRORE TË PROKURIMIT PUBLIK

### Hyrje

Të gjitha shtetet anëtare i organizojnë funksionet e rëndësishme të prokurimit publik brenda administratave të tyre publike, por ato ndryshojnë nga njëra tjetra për sa i përket mënyrës se si i organizojnë ato këto funksione, bazës ligjore për ndërtimin organizacional, fushës së veprimit të këtyre funksioneve dhe vendndodhjes së tyre brenda strukturës administrative, shpërndarjes aktuale të funksioneve dhe të përgjegjësisive ndërmjet organeve të ndryshme qendrore të prokurimit dhe mënyrës se si lidhen ato me njëra tjetrën, si edhe për sa i përket kapacitetit dhe burimeve që u jepen organeve të ndryshme.

Përgjatë viteve, Sigma ka mbështetur aktivisht reformimin e prokurimeve publike brenda grupit të shteteve anëtare që kohët e fundit kanë hyrë në BE (në vitin 2004 dhe në 2007). Pjesa më e madhe e këtyre vendeve ka një prejardhje të përbashkët historike si vende ish-komuniste, ku planifikimi shtetëror dhe sistemet e blerjeve kryheshin pa përdorimin e procedurave të konkurrimit në prokurime siç ndodh në ekonomitë e tregut. Fillimisht, një sfidë kryesore në procesin e reformës së prokurimeve përgjatë reformës ligjore, ka qenë çështja se si të organizohet më mirë struktura qendrore për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e prokurimeve publike në vend. Krijimi i një pike të fortë qendrore për prokurimet publike në një nivel të lartë qendror, të cilit i jepet një gamë e gjerë funksionesh dhe përgjegjësisish, është parë dhe vazhdon të shihet si një masë jetike për vendet në procesin e ndërtimit të sistemeve të tyre të prokurimit. Kjo duhet parë si një *qasje me shtytje, nxitje nga qendra*, ku “qendra” është iniciatori dhe vendoset në vendin e shoferit, drejtuesit për reformimin e prokurimit publik. Siç do të trajtohet edhe më tej në tablonë krahasuese, grupi tjetër i shteteve anëtare me një histori të gjatë në Bashkimin Europian, dëshmon një tablo më të larmishme për sa i përket mënyrës se si rregullohen funksionet e prokurimit në krahasim me tablonë krejt uniforme që duket se ka grupi i shteteve anëtare që porsa kanë hyrë në BE. Larmia e sistemeve institucionale në fushën e prokurimeve publike brenda grupit “më të vjetër” të shteteve anëtare mund të shpjegohet së pari me ndryshimet në traditat e tyre ligjore, politike dhe administrative, por gjithashtu edhe nga një faktor tjetër i rëndësishëm. Prokurimi publik, si një operacion komercial brenda administratës publike, është zhvilluar gradualisht për më shumë se njëqind vjet dhe sistemet specifike kombëtare janë formuar si pasojë e zhvillimeve të vazhdueshme në shoqëri, të tilla si lindja e shtetit të mirëqenies, një ripërkufizimi progresiv i rolit të qeverisë, ndryshimet e rëndësishme në sistemet e tregut, një bashkëpunim më i ngushtë ndërkombëtar dhe rajonal, evoluimi i përparësive politike (për shembull, mjedisi), dhe së fundi, por jo për nga rëndësia, zhvillimet në fushat e komunikacionit dhe të teknologjisë së informacionit. Nevoja për ngritjen e strukturave qendrore të prokurimit në këto vende mund të shihet të jetë rritur më shumë si rezultat i një *qasjeje me shtytje, nxitje periferike*, ku presioni për forcimin e disa funksioneve, por jo të të gjithave, në nivel qendror mund të mendohet si rrjedhojë e ndryshimeve afatgjata në mjedisin e jashtëm, i cili ka kërkuar një përshtatje të vazhdueshme të funksioneve dhe të rolit të administratës publike qendrore. Për më tepër, kërkesa për funksione qendrore të prokurimit është nxitur shpesh nga një interes i shprehur në nivel operacional – blerësit dhe operatorët ekonomikë - në iniciativat e qeverisë për krijimin e sistemeve të përshtatshme të mbështetjes që pasqyrojnë kompleksitetin në rritje në fusha të ndryshme të sistemit të prokurimit publik. Kjo kërkesë ka ardhur gjithashtu edhe prej angazhimeve të jashtme (si anëtarësimi në BE dhe në OBT), bashkë me futjen e kuadrove të reja komplekse rregullatore në fushën e prokurimit publik dhe prej nevojës për të ngritur pika kontakti për komunikimin me jashtë.

Studimi i Sigma-s ka identifikuar një gamë të gjerë detyrash të kryera nga organe të tilla, të cilat mund të përfshijnë përgatitjen e legjislacionit për prokurimet publike, këshillimin e enteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë në lidhje me zbatimin e legjislacionit, dhënien e trajnimit për prokurimin publik, publikimin e njoftimeve të kontratave, ose komunikimin me Komisionin Europian dhe me institucione të tjera ndërkombëtare. *Në disa vende, shumica e këtyre detyrave është e përqendruar në një institucion qendror; në vende të tjera këto detyra ndahen midis disa institucioneve qendrore, ndërsa disa vende mund të mos kenë fare institucione qendrore për kryerjen e disa prej këtyre detyrave.* Në Traktatin e Komisionit Europian, në direktivat e Komisionit Europian dhe në çdo legjislacion dytësor të Komisionit

zor se gjenden kërkesa të shprehura ligjore mbi organizimin dhe kapacitetin e prokurimit qendror. Përjashtimi i vetëm është se Direktivat Komisionit Europian për Kompensimet (EC Remedies Directives 89/665/EC dhe 92/13/EC) kërkojnë një analizë të momenteve të fundit, të pavarur të vendimeve për prokurimet publike. Megjithatë, shtetet e reja anëtare të BE-së dhe vendet kandidatë të BE-së janë përballur ose po përballen me këtë çështje si një nga kriteret kyç të kapitullit të prokurimeve publike për t'u pranuar në BE. Për një vend kandidat nuk mjafton që ai thjesht të respektojë *acquis*, po kaq e rëndësishme është që vendet që po hyjnë në BE duhet të dëshmojnë se ato e kanë një kapacitet administrativ të një shkalle të kënaqshme në nivelin e qeverisë qendrore për të zbatuar ligjin vendas që transponon Direktivat e KE, për të monitoruar me efektivitet operacionet e prokurimit publik dhe për të përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Direktivat e KE, të Traktatit të KE dhe të financimeve të BE-së pas datës së anëtarësimit. Këto detyrime nënkuptojnë krijimin e institucioneve dhe të mekanizmave të përshtatshme, përfshirë edhe ato që merren me zgjidhjet ligjore pas ankimimit dhe garantimin që këto institucione janë të pajisura me staf sipas nevojës dhe e kanë kapacitetin të ushtrojnë të gjitha funksionet e tyre me efektivitet, funksione të cilat mund të mbulojnë një gamë të gjerë funksionesh të prokurimit, funksione bazë dhe funksione plotësuese.

## **1. Identifikimi i funksioneve kyçe të prokurimit publik në nivel qendror**

Mbështetur në pyetësorët e marrë dhe në përvojën e vetë Sigma-s, si edhe me qëllim përmirësimit e tablosë mbi mënyrën e organizimit të funksioneve të prokurimit publik qendror në shtetet anëtare, ky raport jep një strukturë bazë të funksioneve më kryesore të prokurimit të cilat janë identifikuar, përfshirë këtu edhe një klasifikim të këtyre funksioneve përsa i përket aspektit të organizimit. Megjithatë, midis funksioneve të ndryshme brenda një klasifikimi të gjerë nuk mund të shmangen edhe disa mbivendosje. Klasifikimi i funksioneve të ndryshme siç del edhe më poshtë, është bërë vetëm për qëllime të këtij studimi dhe nuk duhet parë si një model për organizimin e strukturave të prokurimeve publike. Në këtë kuadër, mund t'u referohemi diskutimeve në fund të Komisionit Këshillimor dhe marrëveshjes midis grupit të shteteve të reja (dhjetë plus) dhe Komisionit mbi Shërbimet për listën e funksioneve kyçe të prokurimit.

Siç përshkruhet edhe më poshtë, funksionet kryesore për t'u kryer nga institucionet qendrore të prokurimit publik, mund të kategorizohen si më poshtë:

1. Funksione të legjislacionit parësor dhe të politikave parësore
2. Funksione të politikave dytësore dhe funksione rregullatore
3. Funksione të koordinimit ndërkombëtar
4. Funksione të monitorimit dhe të kontrollit
5. Funksione të këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve
6. Funksione të publikimit dhe informimit
7. Funksione të profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve
8. Funksione të zhvillimit dhe të koordinimit të prokurimeve

Në disa shtete anëtare, funksionet e blerjeve qendrore dhe ato të zbatimit dhe të ankimimit janë pjesë e strukturës qendrore të prokurimeve publike, por për natyrën e tyre specifike, këto funksione nuk janë mbuluar nga ky studim, por vetëm sa janë trajtuar shkurtimisht në diskutimet më poshtë. Siç do të trajtohet më vonë në këtë raport, ekziston një larmi e madhe e ndërtimit institucional e identifikuar në shtetet anëtare, por uniformizmi i funksioneve të kryera nga strukturat e prokurimit publik është befasuese.

### **1.1 Funksionet e legjislacionit parësor dhe të politikave parësore**

Të gjitha shtetet anëtare u kanë caktuar organeve të nivelit qeveritar detyrën e hartimit të politikave themelore të prokurimit që synojnë në përcaktimin e kuadrit të përgjithshëm ligjor për veprimtarinë e

prokurimeve publike. Funkzioni më i rëndësishëm në këtë kontekst është të përgatitet dhe të hartohet legjislacioni parësor për prokurimet publike, i cili përfshin legjislacionin kombëtar në zbatim të Direktivave të KE-së për Prokurimet Publike si edhe kuadrin rregullator ose të politikave që do të zbatohen në fusha jashtë fushës së veprimit të Direktivave të KE-së. Të gjitha shtetet anëtare kanë transpozuar Direktivat e KE-së (por direktivat e reja ende nuk i kanë transpozuar të gjitha shtetet anëtare) në legjislacion parësor, por jo të gjitha ato i kanë rregulluar në ligjin parësor fushat e pambuluara nga direktivat. Mesa duket, funksioni i hartimit të legjislacionit shpesh ushtrohet nga Ministria e Financave/Thesarit, Ministria e Ekonomisë, dhe Ministria e Drejtësisë, ose të organizuara veçmas, ose si një përbërës i një organi qendror të prokurimit publik. Brenda këtij funksioni zakonisht caktohen detyrat e mëposhtme:

- Të udhëheqë grupin e punës në procesin e hartimit dhe të organizojë procesin e konsultimeve me aktorët kryesorë në sistemin e prokurimeve;
- Të marrë pjesë në aktivitete të tjera legjislative të cilat kanë rëndësi për prokurimet publike;
- Të përcaktojë pragun monetar të monedhës kombëtare - nëse këto nuk janë përcaktuar nga Komisioni për vendet që nuk janë anëtare të BE-së- për zbatimin e ligjit të prokurimit publik në përputhje me Direktivat e KE-së dhe me ato që përbëjnë shqetësim për vendin.

### **1.2      *Funksionet e politikave dytësore dhe funksionet rregullatore***

Funksionet e politikave dytësore dhe rregullatore kanë të bëjnë me rregullat që miratohen zyrtarisht nga qeveria për të zbatuar ligjin parësor në fusha të veçanta ose për të ofruar mjete zbatimi në mbështetje të vënies në jetë të ligjit parësor. Midis shteteve anëtare ekzistojnë ndryshime të qarta në lidhje me nevojën për legjislacion dytësor dhe përmasat e tij. Disa shtete anëtare operojnë pa ndonjë legjislacion dytësor fare ose me fare pak legjislacion të tillë dhe, në vend të tij, mund të mbështeten për shembull, në tekste (shënime që interpretojnë dispozita të ndryshme) për përgatitjen e ligjit parësor në parlamente, në komunikimet interpretuese të organeve të caktuara për këtë qëllim, ose në vendimet e mëparshme të gjyqeve. Shtete të tjera anëtare kërkojnë me ligj që të hartohen paketa e legjislacionit dytësor në shkallë të ndryshme dhe, në disa raste, kjo vihet edhe si kusht për efektivitetin e legjislacionit parësor. Të tjera shtete anëtare mund ta plotësojnë më tej legjislacionin parësor dhe dytësor me ofrimin e legjislacionit tretësor (për shembull, udhëzimet për veprim) që miratohet nga organe të caktuara qendrore të prokurimeve. Paketa e rregullave plotësuese mund të përfshijë tipet e mëposhtme të dokumentacionit:

- Rregullat për zbatimin, të cilat mbulojnë aspektet teknike të procesit të prokurimit, fushat e pambuluara nga legjislacioni parësor ose fushat në të cilat nevojiten udhëzime për zbatim;
- Udhëzime për veprimet;
- Formate standarde për njoftime kontratash në rastet kur formularët standardë të BE-së janë të detyrueshëm;
- Modele të dokumenteve për tendera për mallra, shërbime dhe punë, përfshirë këtu udhëzime për tenderuesit, formularët e tenderit dhe specifikimet teknike;
- Modele të kushteve të përgjithshme të kontratave për mallra, shërbime, punë dhe koncesione, përfshirë edhe formularët e kontratave.

### **1.3      *Funksionet e koordinimit ndërkombëtar***

Koordinimi i aktiviteteve ndërkombëtare dhe ndëreuropiane të prokurimeve publike është një funksion i rëndësishëm i një shteti anëtar, i cili zakonisht duhet të mbulojë çdonjërin prej detyrave të mëposhtme:

- Të jetë përgjegjës për kontributin kombëtar në aktivitetet rregullatore ndërkombëtare, midis të tjerave, në fusha të tilla si Marrëveshja Qeveritare për Prokurimet e Organizatës Botërore të Tregtisë ose Ligji Model i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare;
- Të jetë përgjegjës për kontributin kombëtar në komisionin këshillimor të BE-së dhe të grupeve të tij të punës që merren me prokurimet publike;
- Të veprojë në rolin e një pike kontakti kombëtare për Komisionin Europian për çështjet dhe procedurat e zbatimit mbi bazën e Nenit 226 të Traktatit të Komisionit Europian;
- Të marrë pjesë, ose si përfaqësues i një institucioni, ose si një ekspert individual, në rrjetet ndërkombëtare, të tilla si Rrjeti Europian i Prokurimit Publik (RREPP);
- Të bashkëpunojë me institucionet korresponduese në vendet e tjera.

#### **1.4      *Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit***

Duke qenë se fushat e monitorimit dhe të kontrollit të prokurimit publik në shtetet anëtare rregullohen nëpërmjet ligjit kombëtar dhe detyrimeve që rrjedhin nga Direktivat e Komisionit Europian, këto funksione luajnë një rol qendror në të gjitha sistemet kombëtare të prokurimeve publike. Kontrolli në këtë kontekst nuk përfshin përgjegjësitë e institucioneve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm ose të organeve të shqyrtimit të ankesave, por ka të bëjë vetëm me detyrat e ushtruara nga institucionet qendrore të prokurimeve publike. Funksione të tilla është parë se përfshijnë detyrat e mëposhtme:

- Përgatitja e një raporti vjetor për qeverinë në lidhje me funksionimin e sistemit kombëtar të prokurimit publik;
- Grumbullimi i informacioneve statistikore dhe informacioneve të tjera, për shembull, në lidhje me planifikimin e prokurimit publik, futjen në treg, kontratat e dhëna, me performancën dhe efikasitetin e sistemit të prokurimit publik (përfshirë grumbullimin e të dhënave mbi tregun e prokurimeve publike, siç parashikohet ai nga Direktivat e KE);
- Ushtrimi i një funksioni autorizues nëpërmjet dhënies së miratimit paraprak për entet kontraktuese në lidhje me vendime të caktuara në procesin e prokurimeve, të tilla si përdorimi i procedurave më pak konkurruese ose përdorimi i procedurave të përshpejtuara;
- Menaxhimi i një liste zyrtare të operatorëve ekonomikë të çertifikuar dhe/ose të nëpunësve të çertifikuar të prokurimeve;
- Megjithëse nuk rekomandohet nga Bashkimi Europian, menaxhimi nga disa shtete anëtare i listave të zeza zyrtare të operatorëve ekonomikë që shkelnin rregullat e prokurimit publik, që nuk përmbushnin detyrimet kontraktuale ose që keqinterpretonin informacionin.

#### **1.5      *Funksionet këshillimore dhe të mbështetjes së operacioneve***

Këto dy funksione të rëndësishme kryhen nga të gjitha shtetet anëtare për të mbështetur entet kontraktuese si edhe operatorët ekonomikë në detyrat e tyre respektive për t'i bërë ato të afta të veprojnë efektivisht dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar, me parimet themelore të Traktatit të KE-së dhe me praktikën e mira. Në mënyrë më specifike, funksionet e këshillimit ligjor janë zakonisht përgjegjësi e organeve të prokurimit publik në nivel qendror, por përveç kësaj, disa nga këto funksione ushtrohen edhe nga një numër i madh aktorësh brenda komunitetit të prokurimit publik, të tilla si shoqatat e administratave rajonale e lokale, entet dhe kompanitë e mëdha kontraktuese, sektori privat (konsulentët dhe firmat ligjore), dhomat e tregtisë dhe shoqatat e ndërmarrjeve të vogla e të mesme (SME). Në veçanti, funksionet e mbështetjes profesionale duket se menaxhohen nga një numër i madh aktorësh brenda strukturës dhe

komunitetit të prokurimit. Zakonisht, bashkë me funksionet këshillimore dhe funksionet e mbështetjes së operacioneve janë edhe:

- Organizimi i funksionit të dhënies së ndihmës në tavolinë për të dhënë mbështetje ligjore dhe profesionale për blerësit dhe operatorët ekonomike mbi bazë ditore;
- Zhvillimi i sistemeve të ndihmës dhe i instrumenteve operacionale – në internet dhe letër - për menaxhimin e të gjitha fazave të procesit të prokurimit, për shembull, metodologjitë për vlerësimin e tenderit;
- Nxjerrja e publikimeve, komentarëve dhe dokumenteve interpretuese për subjekte të ndryshme.

Në disa shtete anëtare, disa nga detyrat dhe dokumentacioni i përdorur miratohen zyrtarisht nga legjislacioni dytësor (shih më sipër pikën 1.2).

### **1.6 Funksionet e publikimit dhe informimit**

Në një numër shtetesh anëtare, funksionet e publikimeve të ndryshme mund t'i caktohen një organi qendror prokurimesh. Ky mund të jetë ngarkuar me detyrën e administrimit të buletinit kombëtar të prokurimeve publike, i cili në shtetet anëtare është duke u zëvendësuar gradualisht nga një uebsajt kombëtar për publikimin e njoftimeve për kontrata mbi kufirin monetar të KE-së si edhe për kontrata të tjera kombëtare. Kjo detyrë mund të përfshijë edhe një kontroll të cilësisë të njoftimeve para publikimit ose përpara dorëzimit në zyrën e publikimit në Luksemburg (TED), e cila në disa raste mund të përfshijë gjithashtu edhe njoftime në lidhje me kontratat nën pragun monetar të KE -së. Përsa u përket kontratave mbi kufirin monetar të KE-së, organi qendror mund të ngarkohet me përgjegjësinë të kryejë komunikimin e njoftimeve të enteve kontraktuese dhe shërbimeve publike në Gazetën Zyrtare të Komunitetit European, e cila do të përfshinte detyrën e refuzimit të drafteve të njoftimeve që nuk përmbushin kërkesat e Direktivave të KE-së për Prokurimet Publike ose të Traktatit të KE-së. Publikimi dhe shpërndarja e informacionit mbi legjislacionin dhe politikat e prokurimit publik, përfshirë edhe disa burime të informacionit shtesë, të materialeve dhe të këshillave, është një tjetër detyrë e lidhur me këtë. Ky informacion mund të përfshijë versionet në letër si edhe burimet e internetit ose burimet e ndonjë medie tjetër. Detyrat e lidhura me këtë funksion më hollësisht janë:

- Nxjerrja e modeleve të njoftimeve të kontratave dhe të udhëzimeve mbi përdorimin e tyre;
- Vënia në funksionim e sistemeve të publikimit në internet të njoftimeve për tendera dhe të fitimit të tyre, përfshirë përpunimin e njoftimeve, kontrollin e cilësisë dhe të ligjshmërisë së njoftimeve të marra, publikimin e njoftimeve dhe dorëzimin e njoftimeve në TED;
- Mbajtja e regjistrave të prokurimeve publike dhe të bazave të tjera të të dhënave mbi prokurimet (që përdoren edhe si pjesë e funksionit të monitorimit, shih më sipër, pika 1.4);
- Mirëmbajtja e listave të enteve kontraktuese;
- Vënia në funksionim e një sistemi informacioni dhe udhëzimesh me bazë internetin për të mbështetur komunitetin e prokurimeve, përfshirë edhe dokumentacionin me udhëzime, dokumentacionin me modelet e tenderave dhe të kontratave, komantarët dhe dokumentet interpretuese (të cilët janë gjithashtu pjesë e funksioneve këshillimore, shih për këtë më sipër, pikën 1.5).

### **1.7 Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve**

Profesionalizimi i detyrave të prokurimit dhe forcimi i kapacitetit të operacioneve të prokurimeve shihen sot si funksione themelore për rritjen e efikasitetit të çdo sistemi kombëtar të prokurimeve publike. Këto funksione mund t'u caktohen organeve qendrore të prokurimeve, dhe mund të përfshijnë fillimin dhe

koordinimin e programeve kombëtare të trajnimit për sektorin publik dhe sektorin e shërbimeve; lehtësimin e mësimdhënies së pavarur dhe të kërkimeve në universitete, në kolegjet e trajnimeve dhe përmes kompanive private; organizimin e programeve të kërkimit mbi ligjin e prokurimit publik, ekonominë dhe politikën; pjesëmarrjen në veprimtari akademike kombëtare dhe ndërkombëtare dhe veprimtari të tjera mbi ligjin e prokurimit publik, ekonominë dhe politikën. Trajnimi është një aktivitet kyç brenda këtij funksioni, por organi qendror vepron më shumë në cilësinë e një *nismëtari* (që përfshin përgjegjësinë për përcaktimin e politikës së trajnimit), të *lehtësuesit dhe koordinatorit* të trajnimit mbi prokurimet për blerësit publikë dhe operatorët ekonomikë, sesa në cilësinë e zbatuesit të programeve të trajnimit. Përfshirja praktike e organeve qendrore të prokurimit zakonisht kufizohet vetëm në organizimin e konferencave dhe të seminareve të natyrës informative, me prezantime mbi legjislacionin dhe fushat e tjera që lidhen me të, të cilat janë një përgjegjësi e rëndësishme e këtyre organeve. Sidoqoftë, ai mund të përfshijë përgatitjen e programeve dhe materialeve të trajnimit, por aktivitetet për forcimin e kapaciteteve më të plota, të specializuara dhe afat-gjata kryhen zakonisht nga universitetet, institutet kërkimore dhe, së fundi, por jo nga rëndësia, nga sektori privat. Në disa shtete anëtare, organet qendrore janë përgjegjëse për skemat e ndryshme të akreditimit të nëpunësve të prokurimeve publike ose të konsulentëve të prokurimit. Megjithatë, profesionalizimi dhe forcimi i kapacitetit nuk kufizohen vetëm me trajnimet dhe kërkimin. Ky funksion ka të bëjë me një qasje dhe sfidë shumë më të gjerë, që kryesisht janë:

- Zgjerimi i konceptit të prokurimit publik përtej fazës së tenderimit dhe të zbatimit të kuadrit rregullator për të mbuluar të gjitha fazat e ciklit të prokurimit;
- Futja e funksionit të prokurimit në hartën politike në mënyrë të tillë që ai të njihet si një faktor strategjik kyç për ofrimin e shërbimeve efçente ndaj publikut me koston më të vogël të mundshme;
- Garantimi që prokurimi mbahet në qendër të buxhetit dhe të procesit të shpenzimeve publike;
- Marrja e ekspertizës së duhur dhe profesionale mbi prokurimet dhe rritja e statusit të profesionit të prokurimit;
- Përcaktimi i mënyrës më të mirë për të organizuar dhe menaxhuar operacionet e prokurimit në nivelin e kontraktimit;
- Ngritja e strukturave vendimmarrëse dhe gjetja e ekuilibrit të drejtë midis autoritetit për të marrë vendime vetë dhe kontrollit mbi vendimet e marra.

### **1.8 Funksionet e zhvillimit dhe të koordinimit të prokurimeve**

Së fundi, studimi zbulon një grup funksionesh aktive brenda strukturave të prokurimeve publike të cilat ose nuk futen natyrshëm brenda ndonjërit prej funksioneve të tjera qendrore të renditura më sipër, ose meritojnë një vëmendje të veçantë. Funksionet e zhvillimit dhe të koordinimit të prokurimeve janë bërë të rëndësishme në të gjitha shtetet anëtare si rezultat i rritjes së qëndrueshme të kërkesës për nisma të qeverisë qendrore dhe për mbështetje organizacionale dhe operacionale në fushat që i nënshtrohen ndryshimeve të shpejta teknologjike dhe legjislative, të tilla si Direktivat e reja të KE-së. Në disa shtete anëtare, këto funksione janë përgjegjësi e organeve qendrore të prokurimeve, ndërsa në shtete të tjera këto funksione dhe përgjegjësi u janë ngarkuar organeve të specializuara. Këtu përjashtim bëjnë funksionet thjesht legjislative dhe monitoruese të cilat janë përgjegjësi e organeve qendrore rregullatore të prokurimeve. Funksionet e zhvillimit dhe të koordinimit të prokurimeve mund të përfshijnë çdonjërin prej detyrave të mëposhtme:

- Lehtësimin dhe koordinimin e marrëveshjeve kuadër në sektorët e qeverisë dhe në bashkitë;
- Koordinimin dhe mbështetjen e koncesioneve/të projekteve të PPP;
- Zhvillimin e sistemeve dhe të metodologjive për prokurimin elektronik;
- Vënien në përdorim të sistemeve për matjen e performancës së prokurimeve publike;

- Zhvillimin e teknikave të prokurimeve, të tilla si specifikimet teknike të mbështetura në performancë;
- Marrjen e nismave për përpunimin e modeleve të kontratave që përdoren në sektorin publik.

## **1.9      *Funksione të lidhura me prokurimin por që nuk zbatohen***

### **1.9.1    *Blerjet në nivel qendror***

Një organ qendror mund të veprojë si një njësi blerjesh në nivel qendror për autoritete të tjera kontraktuese në nivel lokal, rajonal e kombëtar si edhe për shërbimet publike. Mundësia e ngritjes së njësisve të tilla të blerjeve në nivel qendror pranohet shprehimisht në Direktivat e reja 2004/17/EC dhe 2004/18/EC. Në disa juridiksione, funksioni i blerjeve në nivel qendror ka qenë baza e organizimit të të gjitha funksioneve të tjera. Me fjalë të tjera, funksione të tilla si hartimi i politikës së prokurimit dhe shërbimi si një pikë kontakti për Komisionin ishin shtesa të mëvonshme në listën e detyrave të një njësie e cila merrej fillimisht me blerjet në nivel qendror. Megjithatë, funksioni i blerjeve qendrore nuk konsiderohet një funksion prokurimi për qëllimet e këtij studimi. Pavarësisht nga kjo, vendosja e këtij funksioni të blerjes në nivel qendror ka qenë objekt kërkimesh për të përcaktuar nëse ai ushtrohej veçmas nga funksionet e tjera qendrore të prokurimeve apo jo.

### **1.9.2    *Shqyrtimi dhe zgjidhja ligjore***

Disa detyra në kontekstin e komponentëve të analizës, të ankimimit dhe të zbatimit të sistemit të prokurimit publik mund të vendosen brenda strukturës qendrore të prokurimeve publike. Organeve qendrore të prokurimit mund t'u caktohen një numër funksionesh administrative që kanë të bëjnë me zbatimin. Të tilla janë:

- Gjoritja e autoriteteve kontraktuese që kanë shkelur rregullat e prokurimit publik;
- Marrja e masave disiplinore ndaj punonjësve individualë që merren me kontratat.

Megjithatë, funksionet më të rëndësishme lidhen me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe analizën e ankesave, të cilat mund të përfshijnë funksionet e mëposhtme:

- Zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve midis enteve kontraktuese dhe kontraktorëve;
- Fillimin e procedurave për shqyrtim juridik në gjykata të shkeljeve të ligjit për prokurimin publik ose për hetimin e rasteve të korrupsionit dhe të veprave të tjera penale në prokurimin publik;
- Përgatitjen e rregullave për arbitrazhin dhe administrimi i listës së arbitrave;

Megjithatë, duhet të vihet në dukje se Direktivat 665/89/EEC dhe 92/13/EC kërkojnë që hetimi gjyqësor i formës së prerë - me fjalë të tjera, hetim gjyqësor që çon në një vendim ose gjykim i cili nuk mund të apelohej më tej në nivel kombëtar - të merret nga një organ i pavarur gjykues i kryesuar nga një jurist. Kjo kërkesë vë kufizime në lidhje me vendosjen e trupit gjykues që merr vendime të formës së prerë në të njëjtën strukturë organizative siç ndodh me funksionet e tjera.

Për pasojë, shqyrtimi juridik i formës së prerë nuk konsiderohet një funksion prokurimi për qëllimin e këtij studimi. Megjithatë, vendosja e trupit gjykues që merr vendim të formës së prerë ka qenë objekt studimi për të përcaktuar nëse ky funksion është ushtuar veçmas nga funksionet e tjera qendrore të prokurimeve.

Si përfundim, blerjet qendrore dhe zbatimi i masave për zgjidhjen e problemeve nuk trajtohen në këtë studim, por ajo vetëm sa përmenden meqë në disa shtete anëtare disa aspekte të këtyre funksioneve mund të jenë komponentë të rëndësishëm brenda kuadrit të strukturës qendrore të prokurimeve publike. Këto funksione janë elemente themelore të sistemit të prokurimeve publike, por ato ushtrohen zakonisht dhe pozitivisht veçmas nga funksionet qendrore të politikëbërjes dhe të këshillimit të strukturës qendrore të

prokurimeve. Kombinimi i këtyre dy funksioneve brenda së njëjtës strukturë mund të bëjë të lindin situata të konfliktit të interesit dhe mund të çojë edhe në rrezikun e mungesës së përputhshmërisë me kërkesat e BE-së.

## 2. Klasifikimi i funksioneve bazë dhe funksioneve plotësuese

Për qëllimet e këtij studimi, funksionet e identifikuar dhe të renditura më sipër mund të klasifikohen ose si **funksione bazë**, ose si **funksione plotësuese**, por ky kategorizim nuk bëhet mbi bazën e rëndësisë së tyre, por mbi bazën e natyrës së detyrave që realizohen. Funksionet bazë janë përkufizuar si funksione që rregullohen me ligjin kombëtar, shpesh si reagim i drejtpërdrejtë ndaj detyrimeve që lidhen me anëtarësinë në Bashkimin Europian. Këto funksione duhet të trajtohen në nivelin e qeverisë qendrore, dhe kështu ndodh. **Funksionet bazë** janë si më poshtë:

- a) Funksione të legjislacionit parësor dhe të politikave parësore
- b) Funksione të politikave dytësore dhe funksione rregullatore
- c) Funksione të koordinimit ndërkombëtar
- d) Funksione të monitorimit dhe të kontrollit

Për pasojë, të gjitha funksionet e tjera, megjithëse janë jashtëzakonisht të rëndësishme për funksionimin e sistemit të prokurimeve, mund të klasifikohen si **funksione plotësuese**, përderisa ato nuk janë caktuar si një detyrim që rrjedh prej ligjit për të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Europian. Pavarësisht nga kjo, këto funksione mund të mbahen nga organe qendrore të prokurimeve brenda strukturës së prokurimeve publike dhe kështu ndodh në lidhje me aspektet rregullatore dhe monitoruese të këtyre funksioneve. Megjithatë, këto funksione shumë shpesh ndahen ose ushtrohen nga shumë organe të ndryshme brenda strukturës së prokurimit publik ose më gjerë në administratën publike, si edhe nga sektori privat. Në funksionet plotësuese bëjnë pjesë:

- a) Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve
- b) Funksionet e publikimit dhe të informimit
- c) Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve
- d) Funksionet e zhvillimit dhe të koordinimit të prokurimeve

## 3. Vendndodhja organizative dhe statusi brenda administratës publike

Një fushë me interes për qëllimet e këtij studimi është struktura administrative dhe statusi kushtetues i organit qendror të prokurimeve. Në këtë kontekst, çështje themelore janë vendndodhja e organit ose organeve qendrore të prokurimeve në strukturën institucionale të qeverisë, baza ligjore e këtij organi dhe statusi i tij, ndërtimi organizativ dhe funksionet kryesore të tij.

Përsa i përket **vendndodhjes** së organit ose të organeve qendrore të prokurimeve, studimi zbulon se ekzistojnë disa zgjidhje organizative. Funksionet qendrore të prokurimit publik ushtrohen nga organe qendrore që mund të organizohen sipas një larmie linjash raportimi. Këto organe qendrore më shpesh organizohen brenda ose varen nga:

- Ministria e Financave ose e Thesarit;
- Ministria e Punëve;
- Ministria e Zhvillimit Rajonal;
- Zyra e Kryeministrit/Kancelarit/Presidentit si një organ në varësi;
- Këshilli i Ministrave;



- Parlamenti;
- Autoriteti i Konkurrencës ose një organ tjetër publik.

Mund të ekzistojnë shumë njësi që kryejnë një ose më shumë funksione të prokurimeve publike dhe që organizohen përmes një kombinimi të mjediseve institucionale. Shpesh, funksionet e politikave dhe të legjislacionit parësor janë vendosura në një ministri si Ministria e Financave ose Ministria e Drejtësisë, ndërsa në të njëjtën kohë funksionet e këshillimit dhe të publikimit gjenden më shpesh në organe qendrore në një mjedis tjetër dhe me linjë të ndryshme raportimi.

**Statusi** i organit prokurues është një fushë tjetër e rëndësishme që kërkon trajtim, përderisa statusi përcakton rolin dhe ndikimin e mundshëm të këtyre organeve brenda sistemit të prokurimeve publike. Statusi ka të bëjë me elementët e mëposhtëm:

- Pozicioni ose vendndodhja e organit prokurues brenda administratës publike (shih më sipër);
- Kompetenca vendimmarrëse, mandati dhe funksionet e dhëna organit dhe baza ligjore për autoritetin e tij (për shembull, ligji i prokurimeve publike);
- Pavarësia e menaxhimit, siç është shprehur ajo në kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve (për shembull, kryetari, drejtori, përgjegjësi i njësisë);
- Mënyra e organizimit, përbërja dhe burimet e personelit të cilat i japin atij organi;
- Mjetet financiare dhe sasia e burimeve për kostot e stafit dhe kostot operacionale (për shembull, buxheti i përgjithshëm, fondet e posaçme, vetëfinancimi);
- Mjetet e mbikëqyrjes mbi veprimtarinë e organit prokurues;

#### 4. Modeli për klasifikimin e strukturave qendrore të prokurimit publik

Mbështetur në informacionin e grumbulluar nga përgjigjet e pyetësorëve, strukturat e prokurimeve publike të shteteve anëtare mund të klasifikohen në grupe të ndryshme në varësi të mënyrës dhe vendit se ku janë organizuar funksionet bazë dhe plotësuese të prokurimeve.

Së pari, mund të dilet në përfundimin se të gjitha shtetet anëtare i kanë organizuar të katër funksionet bazë të prokurimeve në nivel qendror brenda administratave të tyre publike.

Së dyti, çdo diferencim midis modeleve të ndryshme kombëtare do të bazohet më shumë në shkallën e **përqendrimit** të funksioneve të prokurimit që u janë caktuar organeve kryesore qendrore. Në qoftë se një numër i rëndësishëm funksionesh dhe, në veçanti, funksionet bazë, u caktohen pak organeve qendrore, atëherë këto shtete anëtare konsiderohen si shtete anëtare me strukturë të **centralizuar** të prokurimit. Ekstremi tjetër karakterizon ato shtete anëtare që kanë një përqendrim të shpërndarë të funksioneve, ku disa funksione të caktuara u janë caktuar një numri të madh organesh brenda strukturës së prokurimit publik. Këto shtete anëtare i përkasin kategorisë së strukturës së **decentralizuar** të prokurimit. Midis këtyre dy ekstremeve ne mund të gjejmë një përqendrim të **përzier** të funksioneve, të cilat mund të shihen që përbëjnë një situatë shumë të përhapur, në veçanti në grupin e shteteve anëtare “të vjetra” dhe njihet si një strukturë **gjysmë e centralizuar** e prokurimit.

*Duhet të nënvizohet se ky klasifikim i strukturave organizacionale të shteteve anëtare nuk është bërë me ndonjë saktësi shkencore, por vetëm me qëllim identifikimin e disa modeleve të caktuara, lehtësimin e panoramës për lexuesin dhe të kuptimit të raportit. Në fakt, ky klasifikim është i debatueshëm.*

## **PJESA II. ANALIZË KRAHASUESE E STRUKTURAVE DHE KAPACITETIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË SHTETET ANËTARE TË BE**

### **5. Strukturat qendrore të prokurimit publik dhe modelet institucionale**

*Përsa i përket pjesës së mësipërme metodologjike, lutemi të vini re se studimi nuk bën ndonjë lidhje të veçantë me natyrën e kontratave që janë përgjegjësi e organeve qendrore të prokurimit publik, gjë që mund të kishte pasur ndonjë ndikim në përfundimet e bëra në këtë pjesë. Nga pikëpamja e organizimit, kjo është veçanërisht e rëndësishme për shtetet anëtare ku përgjegjësitë rregullatore për koncesione trajtohen veçmas nga ato organe të ngarkuara me rregullimin dhe monitorimin e kontratave të prokurimeve publike.*

#### **5.1 Modeli i përdorur për klasifikim**

Duke ndjekur modelet e klasifikimit të trajtuara më sipër, duket se të 22 shtetet anëtare që marrin pjesë në këtë studim mund të grupohen në tri kategori sipas mënyrës me të cilën ato i kanë organizuar strukturat e tyre qendrore të prokurimit publik:

1. Shtete anëtare me një strukturë të **centralizuar** të prokurimit, që karakterizohen nga një përqendrim i lartë i funksioneve të prokurimit të alokuara në pak institucione qendrore (zakonisht një ose dy institucione);
2. Shtete anëtare me një strukturë **gjysmë të centralizuar** të prokurimit që karakterizohen nga një përqendrim i përzier i funksioneve të prokurimit të alokuara në një numër të kufizuar institucionesh të vendosura në nivele të ndryshme brenda administratës publike (zakonisht tre ose katër institucione);
3. Shtete anëtare me një strukturë të **decentralizuar** të prokurimit, që karakterizohen nga një përqendrim i shpërndarë i funksioneve të prokurimit të alokuara në disa institucione të vendosura në nivele të ndryshme brenda administratës publike dhe që shpesh përfshijnë edhe kompani private dhe publike (zakonisht përfshihen më shumë se pesë institucione).

#### **5.2 Skema kryesore e organizimit të funksioneve bazë dhe funksioneve plotësuese të prokurimit**

Të gjitha shtetet anëtare që marrin pjesë në këtë studim, përfshirë dhe ato me një strukturë shumë të decentralizuar, i kanë organizuar funksionet bazë të prokurimit (kryesisht funksionet legjislativë dhe të politikave, por edhe koordinimin ndërkombëtar dhe monitorimin) brenda strukturave të tyre qendrore të prokurimit publik dhe shumica ka një strukturë me pak institucione përgjegjëse për funksionet kryesore të prokurimit. Në fakt, mbështetur në modelin e klasifikimit të përdorur, shumica e shteteve anëtare që marrin pjesë në këtë studim, kanë brenda administratave të tyre qeveritare institucione të vendosura në qendër që janë përgjegjëse për shumicën ose për shumë funksione të prokurimit të përmendura më sipër. Këto institucione kanë kështu një pozicion kryesor, drejtues brenda strukturës së prokurimit (shih Shtojcën).

Megjithatë, këto institucione ndryshojnë nga njëri tjetri përsa i përket funksioneve që ata kanë grumbulluar. Modelet rendisin nga një maksimum funksionesh, të tilla si Departamenti i Kontratave i Maltës (DC) ose Zyra Polake e Prokurimeve Publike (PPO), ku janë përjashtuar vetëm funksionet e blerjeve në nivel qendror dhe i gjykimit të formës së prerë e deri në një minimum funksionesh të tilla si në Slloveni kur Departamenti për Prokurimet Publike, Shërbimet Publike dhe Koncesionet (DPPUC) ushtron vetëm detyrat më të rëndësishme. Kështu, mund të gjenden edhe ndryshime të tjera brenda grupit të shteteve anëtare me struktura të centralizuara prokurimi. Megjithatë, të gjitha këto shtete anëtare kanë institucione që kanë grumbulluar funksionet më të rëndësishme pa lënë që ndonjë institucion tjetër të ketë një numër të tillë të krahasueshëm funksionesh themelore.

## 5.2.1 Vendndodhja e funksioneve bazë brenda strukturës së prokurimit publik

### 1. Funksionet legjislative dhe të politikave

Funksionet legjislative dhe të politikave shpesh vendosen në organin përkatës qendror të prokurimeve. Kështu ndodh me Bullgarinë, Qipron, Rumaninë, Republikën Sllovaqe, dhe Mbretërinë e Bashkuar. Përsa i përket përgatitjes së legjislacionit ekzistojnë edhe ndryshime. Në Mbretërinë e Bashkuar, juristët e Departamentit Juridik në Mjestrinë e Financave, të cilët janë vendosur në Zyrën Qeveritare të Tregtisë (OGC), hartojnë ligje nën drejtimin e OGC.

Megjithatë, në varësi të statusit të organit qendror të prokurimit publik, hartimi i legjislacionit parësor dhe ndonjëherë edhe i legjislacionit dytësor organizohet herë pas here në mënyrë të pavarur brenda strukturës së qeverisë. Zakonisht përgjegjësia për këto funksione i ngarkohet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë ose Ministrisë së Drejtësisë. Kështu ndodh, për shembull, në Estoni ku Ministria e Financave në të cilën bën pjesë edhe Zyra e Prokurimit Publik (PPO), është përgjegjëse për këtë detyrë. Për pasojë, ky funksion kryhet në afërsi dhe në lidhje të ngushtë me PPO-në e Estonisë. Ndryshe nga ky rast, PMB e Letonisë dhe PPO e Lituaniës nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në përgatitjen e legjislacionit, megjithëse ato përfshihen shumë në procesin e konsultimeve, përderisa këto detyra përbëjnë respektivisht sferën e veprimit të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Ekonomisë.

Vendet në të cilat funksioni i hartimit të politikave dhe legjislacionit është qartësisht i ndarë nga organet qendrore të prokurimeve janë Estonia, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania dhe Suedia.

### 2. Funksioni i koordinimit ndërkombëtar

Ky funksion i koordinimit ndërkombëtar përfshin për shembull, përgjegjësinë për kontributin kombëtar në komisionet këshillimore të BE-së dhe në grupet e saj të punës që merren me prokurimet publike dhe që veprojnë si pika kontakti kombëtare për Komisionin Europian për çështjet dhe zbatimin e procedurave të Nenit 226 të Traktatit të KE-së.

Në shumicën e shteteve anëtare, ky funksion është përgjegjësi e organit qendror të prokurimeve publike ose e organit përgjegjës për hartimin e legjislacionit, por shpesh ky funksion ndahet midis dy organeve, si në rastin e Estonisë, Hungarisë, Letonisë, Lituaniës dhe Suedisë.

### 3. Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit

Fushat e monitorimit dhe të kontrollit të prokurimit publik në shtetet anëtare rregullohen me ligjin kombëtar dhe me detyrimet që rrjedhin nga Direktivat e KE-së, dhe prandaj këto funksione luajnë një rol qendror në të gjitha sistemet kombëtare të prokurimeve publike. Me përjashtime të pakta, shtetet anëtare i kanë organizuar këto funksione brenda organit kryesor qendror të prokurimeve publike. Përveç detyrimeve për të dhënë statistika vjetore për Komisionin Europian dhe detyrës së zakonshme të përgatitjes së një raportit vjetor për qeverinë mbi funksionimin e sistemit kombëtar të prokurimit publik, një numër shtetesh anëtare përdorin sisteme kontrolli mbi një bazë *ex ante* në fushën e prokurimit publik. Organi qendror i prokurimeve publike ose një njësi e posaçme e caktuar mund të ketë kompetencën t'u japë miratime paraprake enteve kontraktuese në lidhje me disa vendime në procesin e prokurimit ose të bëjë të njohura mendimet e veta gjatë procesit mbi përputhshmërinë me kuadrin rregullator në fuqi. Disa organe prokurimi kanë edhe detyrën të menaxhojnë një listë zyrtare të zezë - në ato vende ku ka lista të tilla - të operatorëve ekonomikë që kanë shkelur rregullat e prokurimeve publike, që nuk kanë përmbushur kontratat e tyre, që kanë keqinterpretuar informacionin ose që kanë ofruar ryshfet.

Shembuj të shteteve anëtare që kanë në përdorim disa forma kontrolli mbi një bazë *ex ante*, janë: Qiproja, Estonia, Franca, Hungaria, Letonia, Malta, Polonia dhe Rumania.

Në përfundim, në shtetet anëtare kur funksionet bazë menaxhohen nga më shumë se një organ qendror prokurimi, nevojitet një bashkëpunim dhe koordinim i ngushtë midis këtyre organeve. Zakonisht për këtë grup shtetesh anëtare të gjitha këto organe janë të përfaqësuar në Komisionin Këshillimor.

## 5.2.2 Vendndodhja e funksioneve plotësuese brenda strukturës së prokurimit publik

Grupi i funksioneve plotësuese është përkufizuar si grup që përmban aktivitete në strukturën e prokurimit publik pa ndonjë referencë të qartë tek ose pa ndonjë detyrim që rrjedh nga Direktivat e KE-së ose nga Traktati i KE-së. Megjithatë, këto aktivitete janë shumë të rëndësishme për funksionimin e sistemit të prokurimeve publike. Kështu, vendet që hynë së fundi në BE kanë pranuar që “kapaciteti administrativ” për të zbatuar dhe monitoruar me efektivitet legjislacionin për prokurimin publik ishte një pjesë themelore e procesit të anëtarësimit në BE. Kjo çështje është trajtuar vazhdimisht në Raportet e Progresit të nxjerra çdo vit nga Komisioni Europian dhe ishte një element i rëndësishëm në diskutimet dhe negociatat dypalëshe me Komisionin e Shërbimeve gjatë viteve përpara pranimin në BE.

### 1. Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve

Organizimi i funksioneve të **dhënies së ndihmës në tavolinë** brenda strukturave qendrore të prokurimeve publike për të dhënë mbi një bazë ditore këshilla ligjore dhe profesionale, dhe mbështetje për blerësit, dhe shpesh edhe për operatorët ekonomikë, është e zakonshme në shtetet anëtare, por fusha e veprimit e këtyre funksioneve ndryshon ndjeshëm nga vendi në vend. Zhvillimi i sistemeve të udhëzimeve dhe i mjeteve operacionale – në internet dhe në letër – bëjnë pjesë në këtë kategori detyrash për të menaxhuar të gjitha fazat e procesit të prokurimit, për shembull, metodologjitë për vlerësimin e tenderave. Studimi del në përfundimin se funksionet e këshillimit ligjor përdoren më dendur sesa funksionet tipike të mbështetjes profesionale. Shpjegimet kryesore për këtë diferencë mund të jenë përbërja specifike e stafit të organeve qendrore të cilat kanë një shumicë juristësh të punësuar, dhe fakti se kjo fushë konsiderohet zakonisht si përgjegjësi e aktorëve të tjerë brenda komunitetit të prokurimit, përfshirë edhe sektorin privat.

Po ashtu, është e dukshme se grupi i shteteve anëtare ka zbatuar përgjithësisht një qasje më të centralizuar, me organe qendrore të prokurimit që ofrojnë një gamë më të gjerë shërbimesh në krahasim me grupin tjetër të vendeve.

### 2. Funksionet e publikimit dhe të informimit

Ndërsa shumica e institucioneve qendrore të prokurimeve japin **informacion dhe udhëzime** për prokurimin publik me anë të mjeteve të ndryshme, përfshirë edhe uebsajtet e tyre, ekzistojnë dallime të ndjeshme përsa i përket funksioneve të **publikimit**. Për shembull, në Bullgari, Estoni, Letoni, Poloni dhe në Republikën Sllovaqe institucionet përkatëse kanë një funksion publikimi të cilin e kryejnë për të garantuar që kontratat jashtë fushës së veprimit të Direktivave të KE-së i nënshtrohen shërbimeve qendrore të publikimit. Me fjalë të tjera, këto institucione janë të ngarkuara për nxjerrjen e një buletini kombëtar për kontratat që mbulon të gjitha kontratat që i nënshtrohen detyrimeve të publikimit. Për më tepër, në Hungari dhe në Republikën Sllovaqe, për shembull, zyrat e prokurimeve i kontrollojnë draftet e njoftimeve përpara se ato të dërgohen në Gazetën Zyrtare të BE-së. Në Irlandë, Slloveni dhe në Mbretërinë e Bashkuar institucionet qendrore të prokurimeve nuk e kanë një funksion të tillë. Në këto vende, buletini i kontratave ose seksioni i kontratave i gazetës zyrtare është i organizuar jashtë institucionit dhe autoritetet kontraktuese i dërgojnë njoftimet e tyre drejtpërdrejt në Gazetën Zyrtare të BE-së.

### 3. Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapacitetit

Fushatat e trajnimit, të informimit dhe të ndërgjegjësimit si rregull përdoren nga organet qendrore të prokurimeve, por përfshirja e këtyre organeve është shpesh e kufizuar, duke mbuluar kryesisht aspektet ligjore dhe procedurale të nismave të reja rregullatore dhe të akteve të reja ligjore, ndërsa trajnimi i thellë dhe zhvillimi i njohurive kryhen nga organe të tjera të tilla si universitetet, kompanitë private, ose qendrat kombëtare të trajnimeve të përgjithshme për sektorin publik. Organet prokuroese veprojnë më shumë si nismëtarë, koordinatorë dhe lehtësues për krijimin e programeve të rregullta të trajnimeve në fushën e prokurimit publik brenda sistemit ekzistues arsimor, për shembull, në universitete e kolegje dhe më pak përfshihen praktikisht në ofrimin e këtyre trajnimeve. Megjithatë, institucionet qendrore të shteteve anëtare japin ndihmesën e tyre në aktivitetet e këtyre organeve, për shembull, si folës në seminaret dhe konferencat e tyre.

#### 4. *Funksionet e zhvillimit dhe të koordinimit të prokurimeve*

Me hyrjen në fuqi të Direktivave të reja të KE-së, kjo fushë specifike e funksioneve po merr rëndësi gjithnjë e më të madhe në shtetet anëtare, por kjo ndodh më shumë në ato vende ku marrëveshjet kuadër dhe marrëveshjet e koordinuara të blerjeve janë tërësisht një tipar i ri. Në disa shtete anëtare, këto funksione janë bërë përgjegjësi e organeve kryesore qendrore të prokurimeve, si në Mbretërinë e Bashkuar, ndërsa në disa vende të tjera këto funksione dhe përgjegjësi u janë caktuar organeve të specializuara si në Suedi. Megjithatë në parim është e mundur që këto funksione të jenë brenda organit qendror përgjegjës për funksionet e politikave dhe funksionet rregullatore, shtetet anëtare duket se janë të ndërgjegjshme për rreziqet e mundshme të konflikteve të interesit dhe madje edhe të klasifikimit si një ent kontraktues. Për këtë arsye, aspekti operacional i këtij funksioni është zakonisht i organizuar në njësi të veçanta, ndërsa funksionet e lidhura me politikën mbeten brenda organit qendror. Në Mbretërinë e Bashkuar, një njësi e veçantë e lidhur me institucionin qendror të prokurimeve (OGC) që quhet “OGC Buying Solutions” është përgjegjëse për prokurimin dhe për koordinimin e marrëveshjeve kuadër për sektorin qeveritar për disa fusha të produkteve dhe të shërbimeve.

Aspekti operacional i prokurimit elektronik dhe çështjet e teknologjisë së informacionit kryhen zakonisht nga organe të specializuara brenda administratës publike.

#### 5.3 Shtetet anëtare me një strukturë të centralizuar ose gjysmë të centralizuar të prokurimit publik<sup>1</sup>

##### 5.3.1 *Centralizimi i dyfishtë*

Në dy shtete anëtare, të gjitha ose shumica e detyrave të rëndësishme **ndahen midis dy institucioneve kryesore qendrore të prokurimeve**. Për më tepër, këto dy institucione janë **të pavarura** nga njëri tjetri. Ky sistem mund të quhet edhe një “centralizim i dyfishtë”. Këto dy shtete janë Republika Çeke dhe Italia. Në Republikën Çeke, me këtë punë merret Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Zyra për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe në Itali merren Autoriteti i Punëve Publike dhe CONSIP. Zakonisht, dallimi më i dukshëm midis këtyre dy organizatave është fakti që njëri është i varur nga qeveria, si ministria, ndërsa tjetri gëzon një nivel të caktuar pavarësie. Ky centralizim i dyfishtë lejon ndarjen e funksioneve midis një institucioni të varur dhe një institucioni të pavarur.

Në ato shtete anëtare që kanë një organizim të prokurimit publik me dy institucione drejtuese për prokurimet, **funksionet legjislativ dhe të politikave** e kanë vendndodhjen më shumë në institucionin e prokurimit që është më i varur, pra tek ministria, sesa në institucionin e prokurimit që është më i pavarur. Në Republikën Çeke, këto funksione janë të vendosura në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, në Itali legjislacioni parësor hartohet në parlament dhe në Këshillin e Ministrave dhe legjislacioni dytësor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe në Institucionet Rajonale.

Në **Republikën Çeke**, Ministria për Zhvillimin Rajonal është e ngarkuar edhe me përgjegjësi për ushtrimin e funksioneve të trajnimit, administrimit, zhvillimit dhe të administrimit të biznesit. Për më tepër, ajo është përgjegjëse edhe për funksionet që lidhen me publikimin. Zyra për Mbrojtjen e Konkurrencës është përgjegjëse kryesisht për shqyrtimin e ankesave dhe zgjidhjen e tyre dhe dërgon një raport vjetor në parlament dhe në qeveri.

Në **Itali**, Autoriteti i Punëve Publike është i ngarkuar me disa funksione monitorimi dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve; ai raporton çdo vit në parlament dhe kryen edhe disa funksione monitorimi dhe administrative. CONSIP merret me trajnimet dhe kërkimet, monitoron sistemin e prokurimit publik dhe

mbulon publikime të caktuara, disa funksione të zhvillimit dhe të administrimit të bizneseve dhe vepron si një agjenci qendrore prokurimesh.

### 5.3.2 *Strukturat e prokurimit publik me një organ drejtues prokurimesh*

Në shtetet anëtare që kanë një strukturë të prokurimit publik me një institucion kryesor prokurues, detyrat e rëndësishme mund të ndahen midis shumë institucioneve dhe organizatave të ndryshme, ndërsa një institucion ka një pozicion më të rëndësishëm. Shembuj të kësaj janë: Austria me Shërbimin Kushtetues të Kancelarisë Federale (BKA-VD); Gjermania me Ministrinë Federale të Ekonomisë dhe Teknologjisë (BMW); Hungaria me Këshillin e Prokurimeve Publike (PPC) dhe Luksemburgu me Ministrinë e saj të Punëve Publike. Këto shtete formojnë një grup.

Në **Austri**, BKA-VD është e ngarkuar me funksione legjislativë, me bashkëpunimin ndërkombëtar, dhe me këshillimin e qeverisë. Për më tepër, ajo ofron këshillim të kufizuar për agjencitë kontraktuese. Detyrat e tjera janë të ndara midis Zyrës Federale të Prokurimeve (*Bundesvergabeamt*), Ministrisë Federale për Ekonominë dhe Punën, Ministrisë Federale të Financave, kompanisë private *Bundesbeschaffungs GmbH*, dhe funksionin e organizuar veçmas të publikimeve, për shembull, "*Lieferanzeiger*".

Në **Gjermani**, BMW është e ngarkuar me funksionet legjislativë, me bashkëpunimin ndërkombëtar, me grumbullimin e të dhënave statistikore dhe me disa detyra informimi. Funksionet e tjera kryhen nga Ministria Federale e Transportit, e Ndërtimit dhe e Punëve Urbane, nga Agjencia Qeveritare Federale e Koordinimit dhe Këshillimit, Zyra e Prokurimeve e Ministrisë Federale të Brendshme, Zyra Federale e Administratës (*Bundesverwaltungsamt*), Akademia Federale e Administratës Publike, funksioni i organizuar veçmas i publikimit dhe Zyrat e Këshillimit për Prokurimet.

Në **Hungari**, Këshilli i Prokurimeve Publike merret me funksionet e administrimit dhe të monitorimit, me këshillimin e qeverisë, merr pjesë në përgjatitjen e legjislacionit dhe është përgjegjës për bashkëpunimin ndërkombëtar, trajnimet dhe publikimet. Funksionet e tjera përkatëse ndahen midis Ministrisë së Drejtësisë dhe të Zbatimit të Ligjit, Bordit të Arbitrazhit të Prokurimeve Publike, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Drejtorisë së Shërbimeve Qendrore, sektorit privat dhe universiteteve, Zyrës së Auditimit të Shtetit dhe Zyrës së Kontrollit Qeveritar.

Në **Luksemburg**, Ministria e Punëve Publike përgatit legjislacionin dhe merret edhe me bashkëpunimin ndërkombëtar. Ajo bashkëpunon me ministrinë e tjera edhe për shumë detyra të tjera. Funksionet e tjera i janë ngarkuar Qendrës së Kërkimeve, Zyrës së Auditimit, Drejtorisë për Kontrollin Financiar, Institutit Kombëtar të Administratës Publike dhe gazetave private.

Në **Suedi**, NOU është përgjegjës për hartimin e politikave, monitorimin, informimin dhe dhënien e këshillave për qeverinë dhe tenderuesit. Funksionet e tjera janë ndarë midis Ministrisë së Jashtme, Bordit Kombëtar për Shërbimet e Tregtisë ndaj Klientit, Ministrisë së Financave, Agjencisë Qendrore të Statistikave, Autoritetit të Konkurrencës, konsulentëve privatë dhe universiteteve, kompanive private të publikimeve, si Allego dhe Opic.

### 5.4 *Shtetet anëtare me një strukturë të decentralizuar të prokurimeve*

Në shtetet anëtare që kanë strukturë të decentralizuar prokurimesh që karakterizohet nga një përqendrim i shpërndarë i funksioneve të prokurimit, detyrat e rëndësishme ndahen midis shumë institucioneve të ndryshme. Ndërsa disa institucione (më shumë ministrinë e financave ose të thesarit), kanë gjithmonë përgjegjësinë e disa prej funksioneve kryesore, nuk ekziston një pikë fokale organizuese dhe nuk ka një theks në ndonjë institucion ose organizatë të veçantë. Këtë grup e formojnë Finlanda dhe Portugalia. Megjithatë, në të ardhmen e afërt, Finlanda mund të mbetet vendi i vetëm me një organizim të tillë, sepse sistemi portugez mund të reformohet në drejtim të një centralizimi më të madh të funksioneve dhe një numri më të kufizuar aktorësh.

**Finlanda** është shembulli më i qartë i një strukture prokurimi me një sistem të decentralizuar që karakterizohet nga një përqendrim i shpërndarë qartë i funksioneve, ku funksionet e prokurimit janë përgjegjësi e shumë institucioneve dhe ku nuk ka një institucion drejtues të prokurimit. Deri më sot, nuk ka asnjë plan për ta ndryshuar këtë sistem. Detyrat e rëndësishme janë grumbulluar në Ministrinë e Financave (hartimi i politikave dhe i dokumenteve standarde) dhe në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë (hartimi i legjislacionit dhe një pjesë e monitorimit). Megjithatë, funksionet e tjera janë ndarë midis Ministrisë së Punëve të Jashtme, Bordit Qeveritar të Prokurimeve, Njesisë së Këshillimit të Prokurimeve Publike, Shoqatës së Bashkive dhe të Autoriteteve Rajonale të Finlandës, Zyrës së Auditimit të Shtetit dhe HAUS Ltd., Efeko Ltd. and Hansel Ltd të organizuara në mënyrë private (por kryesisht në pronësi publike). Për më tepër, vendi është i decentralizuar vertikalisht, përderisa qarqet dhe bashkitë kanë një rol të madh, kryesisht përmes shoqatës së tyre kombëtare. Edhe një herë, nuk ka plane për ta ndryshuar këtë strukturë bazë.

Në **Portugali**, legjislacioni hartohet nga qeveria dhe nuk ka ndonjë organ specifik që të hartojë ndonjë politikë kombëtare për prokurimet publike. Funksionet e rëndësishme ndahen midis organeve të ndryshme, më të dallueshmit ndër të cilët janë *Direcção Geral dos Assuntos Comunitários*, *Direcção Geral do Património*, *Instituto de Mercados de Obras Públicas e Particulares Imobiliárias*, *Instituto Nacional de Administração* and *Direcção de Serviços do Aproveitamento Público*, i cili është pjesë e *Direcção Geral do Património*. Për më tepër, vendi është i decentralizuar vertikalisht, përderisa Azoret dhe Madeira kanë qeveri shumë autonome dhe bashkitë luajnë një rol të madh në prokurimet. Megjithatë, në të ardhmen Portugalia mund t'i bashkohet grupit të shteteve anëtare që kanë një strukturë të centralizuar të prokurimeve me një përqendrim të lartë të funksioneve në pak institucione, përderisa ekzistojnë plane për krijimin e një “*Unidade Nacional de Compras*”.

**Tabela. Përmbledhje e karakteristikave të strukturave të prokurimit publik**

Strukturë e centralizuar	Strukturë gjysmë e centralizuar	Strukturë e decentralizuar
Bullgaria	Austria	Finlanda
Qiproja	Franca	Portugalia
Republika Çeke	Gjermania	
Estonia	Irlanda	
Hungaria	Italia	
Letonia	Luksemburgu	
Lituania	Sllovenia	
Malta	Suedia	
Polonia	Mbretëria e	
Rumania	Bashkuar	
Republika Sllovake		
<b>11</b>	<b>9</b>	<b>2</b>

### 5.5 Shembuj të decentralizimit në strukturën e prokurimit publik

Në një strukturë vertikale të prokurimit publik, institucionet dhe organet nën nivelin qeveritar mund të kryejnë disa funksione të prokurimeve. Dy kategoritë e decentralizimit duhet të diferencohen. Së pari, organet qendrore të prokurimeve mund të kenë **zyra lokale** jashtë zyrave të tyre qendrore. Shembulli më i

qartë është Republika Sllovaqe ku tre zyra lokale të OPP kryejnë disa funksione këshillimi dhe trajnimi. Së dyti, shtetet anëtare mund të jenë të decentralizuara në lidhje prokurimet publike. Në shtetet anëtare federale si Austria dhe Gjermania, dhe në shtetet anëtare me një qeveri të decentralizuar si në Mbretërinë e Bashkuar, me Parlamentin Skocez dhe Asambletë në Uells dhe në Irlandën e Veriut, ose në Portugali me qeveritë e pavarura të Azoreve dhe të Madeirës, shpesh shtetet ose njësitë federale kanë edhe institucione prokurimesh që kryejnë funksione prokurimi të kufizuara ose edhe shumë të zgjeruara. Për më tepër, në shumë shtete anëtare, rajonet, provincat, distriktet dhe bashkitë mund të kenë organe të ngjashme, të cilat mund të jenë të centralizuara ose të decentralizuara.

Në **Austri** dhe **Gjermani**, shtetet federale (rajonet) marrin pjesë në përgatitjen e legjislacionit federal përmes “Grupit të Punës të Shteteve të Federatës” (Austri) dhe Komisioneve të Prokurimeve (Gjermani), ministritë shtetërore të financave, ekonomisë dhe të punëve japin këshillim për qeveritë dhe tenderuesit e tyre, ndërsa akademitë shtetërore (rajonale) të shërbimeve civile organizojnë disa aktivitete trajnuese, ndërsa gjykatat shtetërore (rajonale) të auditimit kryejnë funksionet e monitorimit. Shteti gjerman i Rinit Verior-Vestfalisë mban një listë të zezë të tenderuesve. Në **Itali**, rajonet, provincat dhe bashkitë kanë të gjitha njësi të prokurimeve që kryejnë disa nga funksionet kryesore. Po ashtu, pjesët e decentralizuara të **Mbretërisë së Bashkuar** dhe të **Portugalisë** kanë institucionet e tyre të prokurimit publik.

Autoriteti i Punëve Publike i **Italisë** ka zyra lokale të cilat nuk kanë personalitet ligjor të veçantë. Këto zyra ofrojnë këshillim, organizojnë trajnime dhe grumbullojnë informacion në nivel vendor. Funksionet e këtyre zyrave të varura janë disi të kufizuara. Në të kundërt me këtë, institucionet e prokurimit të shteteve, rajoneve, ose të bashkive mund të kryejnë një gamë të gjerë aktivitete, përfshirë këtu edhe hartimin e politikës vendore për prokurimin, funksionet e administrimit dhe të monitorimit, funksionet e publikimit dhe të informimit, funksionet e këshillimit, si edhe funksionet e trajnimit dhe të kërkimit shkencor.

## **5.6 Mungesa e disa funksioneve të prokurimit publik**

Ndërsa shumë shtete anëtare kanë një strukturë qendrore të prokurimit e cila mbulon shumicën ose të gjitha funksionet e përshkruara më sipër, në disa vende disa funksione nuk mbulohen nga ndonjë institucion. Shembujt më të dalluar të aktiviteteve të cilat nuk kryhen në disa shtete anëtare janë: monitorimi i rregullt i sistemit të prokurimeve publike me qëllim që të matet performanca dhe të vlerësohet efektiviteti i tij, atudimet për prokurimet publike, programet e plota të trajnimeve për punonjësit kontraktues, dhe edhe hartimi i një politike të plotë prokurimesh. Nga ana tjetër, funksionet themelore, të tilla si përgatitja e legjislacionit, bashkëpunimi ndërkombëtar, këshillimi i autoriteteve kontraktuese dhe publikimet mbulohen në të gjitha shtetet anëtare.

## **5.7 Funksionet e prokurimit në një korporatë**

Në disa shtete anëtare, disa prej funksioneve të prokurimeve janë bërë detyra të një korporate. Një kompani e tillë mund të jetë plotësisht ose pjesërisht në pronësi të qeverisë, dhe qeveria zakonisht mbikëqyr kompaninë deri në një farë shkalle. Detyrat e mbuluara nga këto kompani mund të përfshijnë blerjet qendrore, lehtësimin e marrëveshjeve kuadër, publikimin e njoftimeve për kontratat, trajnimet dhe administrimin e listave të të kualifikuarve, por këtu nuk përfshihen funksionet bazë të prokurimit. Logjika e këtyre masave mund të ndryshojë nga njëri shtet anëtar në tjetrin, por përparësitë e modelit korporativ sipas të drejtës private lidhen me natyrën komerciale të këtyre veprimeve. Kjo natyrë komerciale ka të bëjë me strukturën e veçantë të të ardhurave dhe kostove, me detyrimet kontraktuale, me nevojën për diferencime në paga, etj., gjëra të cilat janë të vështira të krijohen brenda strukturës administrative.

Për shembull, në **Austri**, kompania publike **Bundesbeschaffung GmbH (BBG)** vepron si një njësi qendrore blerjesh në varësi të Ministrisë së Financave. BBG lehtëson edhe marrëveshjet kuadër. Në vitin 2004, kjo kompani vuri në përdorim një procedurë të prokurimit elektronik.



Bashkë me kompaninë në pronësi publike Edita Plc, Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë e **Finlandës** krijoi një shërbim interneti për njoftimin e prokurimeve nën e mbi kufirin monetar të prokurimeve të KE-së. Shërbimi i internetit mbahet në funksionim nga Edita Plc. Përveç kësaj, organizatat tregtare të trajnimeve, sidomos HAUS Ltd që kontrollohet nga qeveria (60% e saj në pronësi të shtetit) ofrojnë kurse të zgjedhura trajnimi për sektorin publik, sektorin e shërbimeve në infrastrukturë dhe tenderuesit. HAUS Ltd. është në varësi të Ministrisë së Financave. Bashkitë e Finlandës kanë një kompani të ngjashme trajnimesh që quhet Efeko Ltd. E fundit, Hansel Ltd. është një kompani private 100% në pronësi të shtetit e cila funksionon si një organizatë jofitimprurëse. Kompania vepron si një organ qendror blerjesh dhe harton e administron marrëveshjet kuadër për prokurimin e produkteve dhe të shërbimeve. Hansel Ltd. është pjesë e krahut administrativ dhe në varësi të Ministrisë së Financave.

Në **Gjermani**, listat e të kualifikuarve në lidhje me kontratat e punëve administrohen nga “*Verein für die Präqualifikation von Bauunternehmen*”, që është një shoqatë e përbashkët e enteve kontraktuese, e tenderuesve dhe e organizatave të biznesit për parakualifikimin e kompanive të ndërtimit. Në **Luksemburg**, kontratat botohen në gazetata kombëtare private, ndërsa në **Suedi** detyra e bërjes publike të kontratave u jepet në kompanive private, të tilla si *Allego* ose *Opic*.

## 6. Modele institucionale dhe skema e organizimit të brendshëm të organeve kryesore të prokurimit publik<sup>2</sup>

*Lutemi të vini re që në lidhje me pjesën metodologjike që u përshkrua më sipër, studimi nuk përmban ndonjë referencë të veçantë për natyrën e kontratave që janë përgjegjësi e organeve qendrore të prokurimeve publike të cilat mund të kishin pasur ndikimin e tyre në përfundimet e bëra në këtë pjesë. Kjo ka rëndësi veçanërisht për shtetet anëtare ku përgjegjësitë ligjore për koncesionet, nga pikëpamja organizacionale, administrohen të ndara nga këto organe të ngarkuara me rregullimin dhe monitorimin e kontratave të prokurimeve publike.*

Kjo pjesë e tablosë krahasuese do të diskutojë modelet e ndryshme institucionale që ekzistojnë në shtetet anëtare, në veçanti në lidhje me organet qendrore të prokurimit publik dhe me mënyrën se si janë organizuar këto në linjat kryesore. Organizimi i brendshëm i këtyre organeve mund të ndryshojë ndjeshëm përse i përket bazës ligjore, varësisë dhe statusit, strukturave bazë të organizimit dhe vendimmarrëse. Megjithatë, ekzistojnë edhe ngjashmëri të mëdha.

### 6.1 Baza ligjore

Koncepti i bazës ligjore të një organi qendror prokurimesh publike ka të bëjë me dispozitat e një dokumenti ligjor që legjitimon ngritjen e institucionit dhe rregullimin e objektivave, funksioneve, organeve dhe kompetencave të tij. Kushtetuta, një ligj i parlamentit ose një akt ligjor, një dekret mbretëror ose presidencial, një dekret të ministrit, ose një normë mund të formojnë bazën ligjore të një organizate qendrore të prokurimeve. Për më tepër, baza ligjore mund të jetë e shpërndarë në shumë instrumente ligjore, veçanërisht kur funksionet e prokurimit i janë caktuar një numri organesh. Baza ligjore e organeve të prokurimeve që formon një pjesë integrale të një ministrie është zakonisht pjesë e ligjit të përgjithshëm i cili rregullon organizimin dhe procedurat e qeverisë. Për shembull, funksionet e prokurimit të Ministrisë së Financave në Estoni janë përcaktuar në Ligjin për Qeverinë dhe Republikën, ato të DAJ të Francës janë përcaktuar në një dekret të Kryeministrit dhe funksionet e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve Elektronike të Letonisë janë përcaktuar në Statutin e Kabinetit. Në të kundërt me këtë, baza ligjore e zyrave ose agjencive të specializuara të prokurimeve publike përcaktohet në ligjin për prokurimet publike. Ndër të tjera, kështu ndodh edhe me PPA e Bullgarisë, Këshillin e Prokurimeve Publike të Hungarisë, me


Autoritetin e Punëve Publike të Italisë, me Zyrën e Monitorimit të Prokurimeve të Letonisë, me Zyrën e Prokurimeve Publike të Polonisë, me Zyrën Sllovaqe të Prokurimeve Publike. Zyra Çeke për Mbrojtjen e Konkurrencës e ka bazën e saj ligjore në kushtetutë, në Ligjin për Organizimin e Qeverisë, në Ligjin për Kontratat Publike dhe në Ligjin për Koncesionet. Baza ligjore e Zyrës së Tregtisë së Qeverisë e Mbretërisë së Bashkuar është një dekret ministror, ndërsa baza ligjore e CONSIP-it italian është një dekret legjislativ dhe dy urdhëra të ministrit. Baza ligjore e Departamentit të Kontratave të Maltës është Ligji për Financat dhe Auditimin. Baza ligjore e organeve qendrore të prokurimeve në korporata, të tilla si BBG e Austrisë dhe Hansel Ltd. e Finlandës gjendet në ligjin për kompanitë si edhe në ligjin ose dekretin që autorizon kompaninë të kryejë disa funksione të prokurimit. Rëndësia e bazës ligjore të një organi qendror prokurimesh lidhet me përfshirjen e parlamentit përkatës dhe me pavarësinë e qeverisë përkatëse siç rezultojnë këto nga kjo përfshirje. Nëse institucioni funksionon me një dekret të ministrit ose me ndonjë rregullore të brendshme që rregullojnë organizimin dhe procedurat e qeverisë, ministri ose e gjithë qeveria mund t'i ndryshojnë këto funksione ose të drejta, madje edhe t'i anulojnë ato pa qenë nevoja e përfshirjes së parlamentit. Një bazë e tillë ligjore e bën institucionin përkatës një pjesë të varur të qeverisë. Nëse baza ligjore e një institucioni rregullohet me një ligj të parlamentit ose me një ligj zyrtar, atëherë çdo ndryshim në funksionet dhe të drejtat e institucionit duhet të miratohet nga parlamenti përveçse në rastet kur ligji ia njeh të drejtën qeverisë t'i bëjë këto ndryshime. Varësia nga miratimi i parlamentit i jep institucionit një pavarësi të caktuar nga qeveria dhe kjo pavarësi është edhe më e lartë kur baza ligjore përcaktohet plotësisht ose pjesërisht në kushtetutë.

## **6.2      *Tablo e skemës së organizimit dhe e strukturave vendimmarrëse***

Përpyekja për një përmbledhje të shkurtër dhe kategorizimin e modeleve të ndryshme institucionale në shtetet anëtare është një detyrë e komplikuar, sepse në praktikë ekziston një larmi e madhe zgjidhjesh organizacionale. Megjithatë, analiza krahasuese dallon midis strukturave të brendshme të organeve kryesore të prokurimit:

1.      Kuadrin bazë të strukturave të menaxhimit dhe të atyre vendimmarrëse (si janë organizuar këto organe kryesore, cilat janë strukturat dhe kompetencat, si caktohen drejtuesit, cilat janë linjat e raportimit, cili është statusi dhe autoriteti);
2.      Strukturën ekzekutive dhe operacionale (si është i organizuar niveli operacional, cilat janë funksionet dhe detyrat kryesore).

**MODEL I PËRGJITHSHËM INSTITUCIONAL**  
**STRUKTURA QENDRORE E PROKURIMIT PUBLIK**



*6.2.1 Strukturat e menaxhimit dhe të vendimmarrjes*

Shumica e shteteve anëtare ndjekin një model të shërbimit civil ku organet qendrore të prokurimeve publike janë pjesë e shërbimit civil dhe janë pajisur me personel nga punonjësit që emërohen, mbikëqyren dhe shkarkohen në të njëjtën mënyrë si edhe të gjithë nëpunësit e tjerë civilë. Nëpunësi civil që drejton duhet të raportojë te eprorët e tij në qeveri.

Agjencia e Prokurimeve Publike në **Bullgari** menaxhohet nga një drejtor ekzekutiv kontrata e të cilit firmoset, ndryshohet dhe mbyllet nga Ministri i Ekonomisë dhe i Energjisë në bashkëpunim me Kryeministrin. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës së Prokurimeve Publike të **Estonisë** i cili emërohet nga Ministri i Financave, firmos vendimet për ankesat dhe organizon punën e zyrës. Kryetari i Zyrës së Monitorimit të Prokurimeve i **Letonisë** përfaqëson zyrën, vendos mbi shpenzimet, lëshon udhëzime të brendshme dhe emëron dhe shkarkon punonjësit dhe zyrtarët. Drejtori i Agjencisë Shtetërore të

Prokurimeve Elektronike të Letonisë drejton punën e agjencisë: bën drejtimin e përditshëm të agjencisë, përgatit strategjinë, përfaqëson Agjencinë, rekruton dhe shkarkon punonjësit dhe përgjigjet për alokimin e burimeve financiare. Drejtori emërohet nga ministri pas një konkurrimi të hapur, i cili publikohet në gazetën zyrtare. Drejtori i DAJ-it të **Francës** emërohet me dekret dhe i raporton Ministrin të Ekonomisë, Financave dhe Industrisë. Departamenti për Prokurimet Publike, Shërbimet në Infrastrukturë dhe Koncesionet i **Slllovenisë** ka një përgjegjës në krye. Divizioni i Politikës së Prokurimeve i Zyrës për Tregtinë e Qeverisë i **Mbretërisë së Bashkuar** drejtohet nga një nëpunës i lartë civil dhe mbështetet nga një Zyrë Menaxhimi e Divizionit dhe raporton te njëri nga drejtorët ekzekutivë të bordit të menaxhimit të OGC-ë. Njëlloj si ky, kryetarët e institucioneve respektive të prokurimit në **Austri**, **Gjermani**, **Luksemburg** dhe **Maltë** janë nëpunës civilë.

Në disa shtete anëtare, organi qendror i prokurimeve publike drejtohet nga një president ose nga një kryetar i fortë. Emërimi dhe përfundimi i punës së tij në këtë detyrë është një faktor themelor për rëndësinë relative të prokurimeve publike në strukturën institucionale të qeverisë. Karakteristika përcaktuese e këtij modeli është se drejtuesi i prokurimeve nuk emërohet nga një ministër i veçantë, por nga kryetari i qeverisë ose kryetari i shtetit, ose edhe nga parlamenti. Një numër i kufizuar shtetesh anëtare ndjekin këtë model dhe këto janë Qipro, Republika Çeke, (Zyra për Mbrojtjen e Konkurrencës), Polonia, Rumania dhe Republika Sllovaqe.

PPD-ë e **Qipros** është një Drejtori brenda Thesarit të Republikës, i cili është një shërbim i pavarur (i cili nuk varet nga ndonjë ministri) dhe kryesohet nga Llogaritari i Përgjithshëm i cili emërohet nga Presidenti i Republikës dhe nuk mund të hiqet nga detyra deri në moshën e pensionit. Zyra për Mbrojtjen e Konkurrencës e **Republikës Çeke** kryesohet nga një kryetar që emërohet nga Presidenti i Republikës me propozim të qeverisë për një periudhë gjashtëvjeçare. Autoriteti Kombëtar për Rregullimin dhe Monitorimin e Prokurimeve Publike i **Rumanisë** kryesohet nga një kryetar dhe një zëvendëskryetar të cilët varen nga Kryeministri.

Sipas Ligjit për Prokurimet Publike të **Polonisë**, Kryetari i Zyrës së Prokurimeve Publike duhet të emërohet nga Kryeministri dhe zgjidhet ndër kandidatët që dalin nga një konkurrim i hapur. Të drejtën për këtë post e ka çdo person me arsim universitar dhe njohuri të sistemit të prokurimeve publike. Kohëqëndrimi në detyrë është pesë vjet dhe mund të zgjatet po kaq vetëm një herë. Kryetari i zyrës rri në detyrë deri në zëvendësimin e tij me një tjetër. Pavarësia e Kryetarit të PPO-së ka krijuar një post të fortë për prokurimet publike në Poloni.

Zyra për Prokurimet Publike e **Slllovakisë** drejtohet nga një kryetar i cili emërohet dhe shkarkohet nga qeveria. Zëvendëskryetari emërohet dhe shkarkohet nga qeveria pas një propozimi nga kryetari. Si për kryetarin ashtu edhe për zëvendësin e tij kohëqëndrimi në detyrë është pesë vjet dhe mund të përsëritet vetëm një herë. Sipas Nenit 111 të Ligjit Nr. 25/2006, kohëqëndrimi në detyrë i këtyre dy zyrtarëve duhet të përfundojë me skadimin e afatit pesëvjeçar, me dorëheqje nga detyra, me shkarkimin e tij nga detyra nga qeveria Sllovaqe, ose me vdekjen ose me deklarimin e vdekjes. Qeveria duhet ta shkarkojë kryetarin ose zëvendësin e tij kur ai është dënuar me ligj për një shkelje, kur i është hequr kapaciteti i tij ligjor me vendim të ligjshëm gjyqor ose kur kapaciteti i tij ligjor është kufizuar; kur ai mban një detyrë ose kryen një aktivitet i cili është i papajtueshëm me postin e kryetarit ose të zëvendësit; ose kur ai nuk i ka ushtruar funksionet e tij për një periudhë në vazhdim prej mbi gjashtë muajsh kalendarikë. Qeveria mund të pezullojë ekzekutimin e funksioneve të kryetarit ose të zëvendëskryetarit nëse ndaj tij ka filluar hetim penal në lidhje me kryerjen prej tij të funksioneve që ai mban. Kështu, sipas ligjit, organi drejtues i Zyrës së Prokurimeve Publike mund të lërë detyrën vetëm në raste të parashikuara dhe jo thjesht sepse ai ka humbur besimin e qeverisë. Kjo mbrojtje ligjore përfaqëson një përmirësim të ndjeshëm për mbrojtjen e postit. Si edhe në rastin e Polonisë, pavarësia e kryetarit e garantuar me ligj, ka krijuar një post të fortë për prokurimet publike në Republikën e Slllovakisë.

**Zëvendëskryetarët ose nënpresidentët**, qofshin të emëruar nga kryetari i organit qendror të prokurimeve publike apo qofshin të emëruar nga jashtë, mund të jenë një ose më shumë. Drejtori Ekzekutiv i PPA-së së **Bullgarisë** emëron Sekretarin e Përgjithshëm, i cili drejton, koordinon dhe kontrollon funksionimin e PPA-

së sipas një legjislacioni dytësor dhe kërkesave të përcaktuara nga Drejtori Ekzekutiv. Drejtoria e Prokurimeve Publike e **Qipros** kryesohet nga Zëvendësllogaritari i Përgjithshëm, i cili është një ekspert kontabël profesionist. Në mungesë të kryetarit, zëvendëskryetari përfaqëson Zyrën e Monitorimit të Prokurimeve të **Letonisë**. Dy nënpresidentët aktualë të Zyrës së Prokurimeve Publike të **Polonisë** duhet të emërohen dhe pezullohen nga Kryeministri me kërkesën e Presidentit të PPO-së.

Në shtete të tjera anëtare, organi qendror i prokurimeve ka një organ drejtues epror në formën e një këshilli të prokurimeve publike, të komisionit ose të bordit. Hungaria, Italia dhe Suedia ndjekin këtë model. Në rastin e **Hungarisë** kryetari zgjidhet nga Këshilli i Prokurimeve Publike. Këshilli është një organ i pavarur administrativ dhe sipas Ligjit mbi Prokurimet Publike, varet vetëm nga parlamenti. Anëtarët e tij emërohen nga përfaqësuesit e tre aktorëve - tenderuesit, entet kontraktuese dhe personat që përfaqësojnë interesat publike. Ligji përcakton personat/organizatat që kanë të drejtë të emërojnë anëtarët e Këshillit. Anëtarët zgjedhin një kryetar për një afat pesëvjeçar me 2/3 e votave dhe një zëvendëskryetar për dy vjet me shumicë të thjeshtë. Anëtarët e Këshillit, me përjashtim të kryetarit nuk janë të punësuar me kohë të plotë. Autoriteti i Punëve Publike i **Italisë** ka një kryetar dhe katër anëtarë të emëruar bashkarisht nga Kryetari i Senatit dhe Kryetari i Dhomës së Deputetëve. Kryetari i bordit zgjidhet nga vetë anëtarët. Çdo anëtar mbetet në detyrë për pesë vjet, pa të drejtë të përsërisë kohëqëndrimin. CONSIP-i i Italisë ka një bord drejtorësh të emëruar nga Ministri i Ekonomisë dhe i Financave dhe përbëhet prej nëntë anëtarësh përfshirë edhe kryetarin edhe CEO-s. Kryetari është përgjegjës për zhvillimin strategjik, për marrëdhëniet institucionale dhe komunikimin, ndërsa CEO është përgjegjës për aktivitetet në përgjithësi. NOU i **Suedisë** është një bord kombëtar dhe anëtarët e tij emërohen nga qeveria me propozim të aktorëve të ndryshëm. I gjithë bordi me të tetë anëtarët e tij është një drejtuesi kolektiv i NOU-s në çështjet e hartimit të politikave dhe të interpretimeve brenda mandatit të vet. Anëtarët janë përfaqësues të autoriteteve kontraktuese dhe të tenderuesve. Kryetari është një jurist nga Gjykata Administrative e Apelit. Bordi takohet një herë në muaj. Emërimi nga parlamenti i krerëve të institucioneve hungareze dhe italiane e rrit ndjeshëm pavarësinë e tyre nga qeveritë përkatëse.

Organet e prokurimit me strukturë kolektive qeverisjeje, si në Hungari dhe Suedi, kanë organe ekzekutive që punojnë me kohë të plotë brenda strukturave të tyre organizative. Organi punonjës i Këshillit të Prokurimeve Publike të **Hungarisë**, që është Sekretariati, mbikëqyret nga Sekretari i Përgjithshëm dhe përbëhet nga njësi të ndryshme sipas detyrave specifike të këshillit. Sekretari i Përgjithshëm është emëruar nga këshilli në vitin 1995 me një kohëqëndrim të pakufizuar në detyrë. Punët e përditshme të NOU-t të **Suedisë** drejtohen nga një sekretariat i cili ka në krye një drejtor.

Këshilli ose bordi mund të veprojë në cilësinë e një organi **këshillues** të organit qendror të prokurimeve. Ai mund të përfaqësojë aktorë të ndryshëm në sistemin e prokurimeve publike, të tilla si qeveria, parlamenti, organizatat industriale, sindikatat ose botën akademike. Për shembull, Këshilli i Prokurimeve Publike i **Polonisë** është një organ këshillues i Presidentit të PPO-s. Ai përbëhet nga 10-15 anëtarë të emëruar nga Kryeministri. Aktualisht, ai ka 14 anëtarë. Grupet parlamentare, organizatat e vetëqeverisjes kombëtare, dhe organizatat kombëtare të sipërmarrësve propozojnë kandidatë për në këtë Këshill. Kryeministri emëron anëtarët e këshillit. Kryetari i Këshillit emërohet nga Kryeministri dhe zgjidhet prej anëtarëve të këshillit. Nënkryetari i Këshillit emërohet nga Kryeministri dhe është anëtar i Këshillit. Këshilli ka për detyrë të shprehë mendimet e tij për çështje veçanërisht të rëndësishme në lidhje me sistemin e prokurimeve publike të cilat atij i propozohen nga Presidenti i PPO-s. Ai jep mendim në lidhje me aktet normative për kontratat publike, jep mendim për raportet vjetore të Presidentit të PPO-së përse i përket funksionimit të sistemit të kontratave publike, përcakton parimet e etikës profesionale të personave që kryejnë detyrat e përcaktuara në Ligjin për Prokurimet Publike brenda sistemit të kontratave publike dhe jep mendim në lidhje me strukturat që dalin nga kontrolli i kryer nga Presidenti i PPO-së. Autoriteti Kombëtar për Rregullimin dhe Monitorimin e Prokurimeve Publike i **Rumanisë** ka gjithashtu një bord këshillimor. Këshilli i Prokurimeve Publike i **Hungarisë** dhe NOU i **Suedisë** përfaqësojnë gjithashtu aktorët e sistemit të prokurimeve publike, por ndryshe nga sa ndodh në Poloni, ata janë organet kryesore vendimmarrëse të institucioneve të tyre.

## 6.2.2 *Strukturat ekzekutive dhe operacionale*

Funksionet ekzekutive të organit qendror të prokurimeve publike pasqyrojnë detyrat që i janë ngarkuar atij, siç janë përcaktuar ato në pjesët e mëparshme të këtij studimi dhe që kanë të bëjnë me funksionet kryesore që hasen zakonisht brenda këtyre strukturave qendrore të prokurimit.

Agjencia e Prokurimeve Publike e **Bullgarisë** ka tre nënndarje kryesore: Drejtoria e Financave dhe Juridike; Seksioni i Monitorimit, të Analizës dhe Metodologjisë; dhe Baza Elektronike e të Dhënave. Drejtoria e Prokurimeve Publike e **Qipros** ka dy nënseksione: Njësia e Politikave dhe e Zhvillimit (PDU) dhe Njësia e Monitorimit dhe e Kontrollit (MCU). PDU është përgjegjëse për hartimin e projektligjeve, të dokumenteve standarde të tenderave dhe të kontratave si edhe për hartimin e udhëzimeve të përgjithshme. Kjo njësi ka edhe përgjegjësinë të organizojë programin kombëtar të trajnimeve për sektorin publik dhe për sektorin e shërbimeve. MCU është përgjegjëse për përgatitjen e udhëzimeve dhe të instruksioneve, për ndihmën dhe monitorimin e autoriteteve kontraktuese dhe grumbullimin e të dhënave statistikore dhe të të dhënave të tjera. Po ashtu, MCU monitoron edhe zbatimin e ligjit Qipriot të Prokurimeve Publike, për shembull, në rastin kur zbatohen procedura përjashtimore, të përsheptuara ose të zgjeruara. Funksioni i ndihmës në tavolinë ushtrohet nga MCU dhe kjo jep mbështetje fillestare për autoritetet kontraktuese duke shpjeguar legjislacionin për prokurimet publike. PPO e **Estonisë** ka dy seksione kryesore: Departamentin e Mbikëqyrjes dhe Departamentin e Rregjistrimit. Departamenti i Mbikëqyrjes kryen detyra në lidhje me funksionin e zbatimit të ligjit dhe të masave përmirësuese/korrigjuese si edhe me funksionin e kontrollit dhe të monitorimit. Departamenti i Rregjistrimit merret me funksionin e publikimit dhe të informimit. Nëndrejtorja e prokurimeve publike e DAJ-it të **Francës** përbëhet nga tre njësi: njësi për çështjet e legjislacionit dhe ndërkombëtare, njësi për këshillimin e blerësve publikë dhe njësi për parashikimet dhe çështjet teknike. Këshilli i Prokurimeve Publike i **Hungarisë** ka një Njësi Juridike, një Njësi për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Trajnimet, dhe një Bord Editorial. Ky i fundit është përgjegjës për publikimin e njoftimeve në buletin dhe komunikimin e atyre njoftimeve që lidhen me procedurat komunitare të Gazetës Zyrtare të BE-së, duke i rishikuar të gjitha njoftimet nga këndvështrimi i legjislacionit të prokurimit publik, duke i kthyer njoftimet që kanë mangësi në të dhëna, dhe duke përdorur sistemin elektronik të menaxhimit të njoftimeve dhe faqen e internetit të Këshillit. Grupi për Analizat Ekonomike kujdeset për menaxhimin dhe analizën e statistikave për prokurimet publike; Njësia e Financave dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore planifikon buxhetin e Këshillit, organizon konsultimet me Ministrinë e Financave dhe zbaton e kontrollon buxhetin e miratuar. Së fundi, Kontrollori i Brendshëm kryen auditimin financiar në organizatë.

Autoriteti i Punëve Publike i **Italisë** (PWA) është i ndarë në tre njësi kryesore. Sekretariati Teknik përgatit të gjitha aktivitetet e PWA-së përmes përgatitjes së dokumenteve interpretuese ose të rregulloreve. Shërbimi i Inspektimit përfaqëson krahun operacional të PWA-së dhe kryen kontrollin dhe hetimet në fushën e punëve publike. Observatori i Punëve Publike grumbullon elektronikisht të dhëna dhe informacion në lidhje me punët publike. Përveç kësaj, ai formulon kostot e standardizuara dhe nxjerr statistika dhe ofron analizën e kostos përkundrejt përfitimeve në mbështetje të aktivitetit të PWA-së. CONSIP është i ndarë në shtatë drejtori. Drejtoria e Kontrollit dhe e Financave është përgjegjëse për menaxhimin e llogarive, për përpunimin e bilancit dhe të buxhetit, për transaksionet me thesarin, për përpunimin e deklarimeve tremujore, për kontrollin e menaxhimit, për menaxhimin e fitimit, për menaxhimin e llogarive të nënkontraktuara, për pronat e patundshme, për menaxhimin e shërbimeve mbështetëse, për menaxhimin e administratës nënkontraktuese dhe sigurinë në industri. Njësia Juridike dhe Drejtoria për Çështjet e Korporatave mbulon menaxhimin e dhënies dhe menaxhimin ligjor të tenderave të dhënës, menaxhimin e bazës së të dhënave për tenderat, menaxhimin e administratës nënkontraktuese dhe mbështetjen ligjore të aktiviteteve të kompanive. Drejtoria e Përgjithshme është përgjegjës për drejtimin e teknologjisë së informacionit dhe për drejtimin e DARPA. Aktivitetet e Drejtorit të Përgjithshëm mbështeten nga Drejtoria e Operacioneve. Drejtoria e Operacioneve ka për detyrë të merret me menaxhimin e projektit, me menaxhimin dhe kontrollin e kontratave, me mbështetjen për sigurinë e projektit, me studimin e standardeve të cilësisë për mallrat dhe shërbimet, me përcaktimin e udhëzimeve në

strategjitë për ankanDET dhe me mjetet dhe metodat për planifikimin e aktiviteteve. Drejtoria e Financave Publike ka përgjegjësinë të nxisë dhe të menaxhojë të gjitha projektet dhe shërbimet e Departamentit të Thesarit, të Departamentit të Llogarive të Përgjithshme të Shteteti, dhe të Zyrës së Përgjithshme të Llogarive. Drejtoria e Sistemeve të Informacionit është përgjegjëse për nxitjen dhe menaxhimin e të gjitha projekteve dhe shërbimeve të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe të Zyrës së Ministrisë. DARPA nxit programin e racionalizimit të shpenzimeve publike.

Zyra e Monitorimit të Prokurimeve e **Letonisë** (PMB) përmban tre departamente dhe Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave (CRC). Departamenti Juridik shqyrton ankesat e tenderuesve dhe përfaqëson PMB-në në gjykatë në rastet kur vendimet e CRC-së apeloohen. Departamenti i Metodologjisë përbëhet nga një drejtor dhe tre seksione: Metodologjia, Legjislacioni dhe Çështjet europiane dhe Kontrolli. Departamenti i Informacionit përbëhet nga një drejtor dhe dy seksione: Seksioni i Njoftimit të Prokurimeve dhe i Statistikave dhe Seksioni i Zhvillimit të Sistemit të Prokurimit. CRC merret me ankesat e tenderuesve dhe vendos në lidhje me lejimin ose ndalimin për të hyrë në një kontratë prokurimi.

Zyra e Prokurimeve Publike e **Polonisë** (PPO) ka katër departamente. Departamenti Juridik ofron shërbime ligjore të jashtme e të brendshme për PPO-në përmes katër njësive: Legjislacionit, Mendimet Ligjore, Vendimet Administrative dhe e Drejta Europiane. Departamenti i Kontrollit kryen detyra në lidhje me kontrollin e kompetencave të kryetarit të PPO-së të cilat përcaktohen në PPL dhe organizon bashkëpunimin e PPO-së me institucione të tjera kontrolli, të tilla si Dhoma e Lartë e Kontrollit dhe dhomat rajonale të auditimit. Departamenti është ndarë në katër njësi: Kontrolli i Kontratave për Furnizimet dhe Shërbimet (*ex ante*), Kontrolli i Kontratave për Punët (*ex ante*), Kontrolli i Kontratave për Shërbimet në Infrastrukturë (*ex ante*) dhe Kontrolli *Ex post*. Departamenti i Trajnimit dhe i Publikimeve përgjigjet për trajnimet, përhapjen e materialeve të trajnimit, dhe botimin e *Buletinit të Prokurimeve Publike (PPB)*. Detyrat e departamentit janë ndarë midis dy njësive: Njesisë së Trajnimeve dhe të Publikimit të materialeve Edukative dhe Njesisë PPB. Departamenti i Bashkëpunimit, i Studimeve dhe i Analizave Ndërkombëtare përgjigjet për kontratat ndërkombëtare të PPO-së dhe për bashkëpunimin e saj me autoritetet përkatëse në vende të tjera dhe në organizata ndërkombëtare që merren me çështjet e prokurimit publik. Departamenti grumbullon dhe shpërndan informacion për ligjet dhe procedurat e huaja dhe ndërkombëtare të prokurimit publik. Departamenti analizon edhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik të Polonisë, tregun e prokurimit dhe zhvillimin e tij të ardhshëm. Ai përgatit raporte vjetore mbi funksionimin e sistemit të prokurimit publik të cilat pastaj i dërgon në Këshillin e Ministrave (dy punonjës). Departamenti përgatit edhe raporte statistikore të cilat i dërgohen Komisionit European sipas dispozitave përkatëse të Direktivave të BE-së. Departamenti grumbullon të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera. Zyra e Apelimeve kryen detyra që kanë lidhje me procedurat e apelimeve nën kujdesin e PPL-së dhe ofron shërbime për juritë e apelimeve. Ankesat ndaj vendimeve të prokurimeve duhet të bëhen në entet përkatëse kontraktuese (të shkallës së parë) përpara se rasti të analizohet në shkallë të dytë në panelet e pavarura të apelimeve të PPO-së.

Zyra për Prokurimet Publike e **Slovakisë** (OPP) ndahet në Zyrën e Kryetarit, në Zyrën e Nënkryetarit, në Seksionin e Legjislacionit dhe të Metodologjisë, në Seksionin e Gazetës dhe të Listave, në Seksionin e Rregullave të Brendshme dhe të Vendimeve në lidhje me Ankesat, në Seksionin e Inspektimit, në Departamentin e Integritit European dhe të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në Zyrën e Shërbimeve për Shtetin, në Seksionin e Ekonomisë dhe të Teknologjisë së Informacionit, në Komisionet e Përmirësim/Korregjimit dhe në Bordin e Apelit të Zyrës së Nënkryetarit.

## **7. Kapaciteti administrativ i strukturave qendrore të prokurimit publik**

### **7.1 Përkufizimi i konceptit të kapacitetit administrativ**

Një nga objektivat kryesore të këtij studimi është trajtimi i çështjes së kapacitetit administrativ brenda strukturave qendrore të prokurimit publik. Shtetet e reja anëtare të BE-sw dhe vendet candidate të BE-sw janë ndeshur ose po ndeshen me këtë çështje që përbën një kriter kyç të kapitullit të prokurimeve publike

për anëtarësimin në BE. Për një vend kandidat nuk mjafton thjesht pranimi i *acquis*, por për më tepër, pritet të ndërtohet një sistem plotësisht i sigurt dhe eficient i prokurimit publik në kuptimin më të gjerë. Vendet që hyjnë në BE duhet të dëshmojnë se në nivelin e qeverisë qendrore e kanë në një shkallë të kënaqshme kapacitetin administrativ për të zbatuar legjislacionin kombëtar i cili mbart Direktivat e KE-së, për të monitoruar me efektivitet operacionet e prokurimeve publike dhe për të plotësuar të gjitha detyrimet që burojnë nga Direktivat e BE-së dhe nga Traktati i KE-së. Këto detyrime nënkuptojnë ngritjen e institucioneve dhe të mekanizmave të përshtatshme, përfshirë këtu edhe të atyre që kanë të bëjnë me masat korrigjuese, dhe garantimin se këto institucione janë të pajisura si duhet me staf dhe e kanë kapacitetin të ushtrorin të gjitha funksionet e tyre në mënyrë eficiente, funksione që mund të mbulojnë një gamë të gjerë të funksioneve bazë dhe të atyre plotësuese, siç edhe është trajtuar më lart. Megjithatë, kapaciteti administrativ nuk duhet të përcaktohet vetëm në këtë kuptim të ngushtë, por duhet të shihet përtej kapacitetit të ushtruar nga organet qendrore të prokurimeve publike në mënyrë që të përfshijë edhe **kapacitetin e akumuluar administrativ** i cili është organizuar dhe i pranishëm brenda administratës publike për të mbështetur operacionet e prokurimeve publike në një shtet anëtar. Sipas këtij përkufizimi të gjerë, kapaciteti administrativ është i disponueshëm dhe ofrohet nga aktorë të shumtë në shoqëri, përfshirë këtu edhe aktorë në sektorin privat. Në mënyrë të veçantë, ushtrimi i disa prej funksioneve plotësuese, të tilla si profesionalizimi dhe forcimi i kapaciteteve, bëhet nga shumë aktorë në një shtet anëtar, ndërsa funksionet bazë janë zakonisht përgjegjësi e organeve kryesore të prokurimeve. Ky studim nuk e analizon kapacitetin administrativ në kuptimin e gjerë, por e ngushton vëmendjen e tij në trajtimin e kapacitetit në nivelin e qeverisë qendrore. Megjithatë, duhet të vihet në dukje se studimi nuk bën asnjë përpjekje për të vlerësuar kapacitetin e shteteve anëtare të veçanta, por përpiqet të ofrojë një tablo të përgjithshme se si shtetet anëtare kanë zgjedhur të organizojnë dhe plotësojnë me personel organet e tyre qendrore të prokurimit. Nevoja dhe disponueshmëria e kapacitetit brenda këtyre organeve kryesore varet nga një numër faktorësh, të tillë si madhësia e ekonomisë, numri i enteve kontraktuese dhe e kontratave të prokurimit, struktura administrative e shtetit anëtar, si edhe nga shkalla e përparësisë që i ka dhënë qeveria qendrore prokurimit publik.

Koncepti i kapacitetit administrativ në nivel qendror e bën të nevojshme të trajtohet edhe çështja nëse organet qendrore të prokurimeve publike të një shteti anëtar i kanë burimet e nevojshme njerëzore, financiare dhe të tjera për të kryer funksionet kyç të prokurimeve publike që u skicuan në hyrjen e këtij kapitulli. Kjo çështje ka të bëjë me faktin se si i kryejnë organet qendrore të prokurimeve publike këto funksione. Kapaciteti administrativ i shteteve anëtare ndryshon ndjeshëm, duke filluar nga njësitë e vogla të vendosura në ministrinë kombëtare deri në zyrat e prokurimeve publike me disa qindra punonjës ose nëpunës civilë. Formimi arsimor i stafit që punon në institucionet qendrore të prokurimeve ka rëndësi të veçantë në kushtet e politikave të përcaktuara në mënyrë të detajuar e të ndikuara edhe nga politikat e KE-së.

Siç u trajtua në pjesët e mëparshme të këtij studimi, organet qendrore të prokurimit publik të një shteti anëtar duhet të kryejnë një numër të madh funksionesh. Shumë prej këtyre funksioneve janë të lidhura drejtpërdrejt me anëtarësimin në BE. Legjislacioni parësor e dytësor duhet të përgatitet në një mjedis rregullator pothuajse për çdo reformë të vazhdueshme, siç e kërkon edhe legjislatori dhe ligji i veçantë i Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Për më tepër, organi qendror i prokurimeve publike duhet të koordinojë kontributin kombëtar me këtë proces legjislativ përmes komisioneve këshilluese dhe këshillave të specializuara për qeverinë kombëtare. Materiali statistikor duhet të grumbullohet dhe të komunikohet. Komisioni European dhe organizatat qendrore të prokurimeve publike të shteteve të tjera anëtare kanë nevojë të kenë pika kontakti kombëtare të qëndrueshme. Për pasojë, një strukturë qendrore kombëtare e prokurimeve publike me kapacitetin e përshtatshëm administrativ është themelore për të kryer funksionet bazë dhe për të plotësuar kërkesat e anëtarësimin në BE në fushën e prokurimeve publike. Megjithatë, shtetet anëtare kanë nevojë që kapacitetet administrative të kryejnë edhe një numër funksionesh të tjera plotësuese për të bërë të mundur të zbatohet në praktikë legjislacioni për prokurimet publike dhe për të mbështetur zhvillimin e sistemit kombëtar të prokurimeve publike në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, por shumë të rëndësishme.



## 7.2 Kapaciteti administrativ i organeve qendrore të prokurimeve

Kapaciteti administrativ i organizatave të prokurimeve publike në shtetet anëtare ka të bëjë me burimet njerëzore, përfshirë madhësinë e stafit, përbërjen e stafit dhe formimin e tij arsimor; me burimet financiare dhe me statusin menaxherial.

### 7.2.1 Madhësia e stafit dhe formimi arsimor

Burimet njerëzore të një organizate qendrore të prokurimeve publike janë një çështje themelore në kontekstin e kapacitetit administrativ. Madhësia e stafit-numri i njerëzve që punojnë për organin qendror të prokurimeve dhe për institucione të tjera të rëndësishme-është pikënisja sasiore. Nëse institucionet nuk kanë vazhdimisht stafin e nevojshëm në numër, atëherë edhe kapaciteti i burimeve të tyre njerëzore nuk është i mjaftueshëm për të kryer me efektivitet funksionet e shumta. Për më tepër, formimi arsimor i stafit është i rëndësishëm. Numri i juristëve, i ekonomistëve, i shkencëtarëve politikë, i ishpraktikantëve, i inxhinierëve ose i llogaritarëve është po aq i rëndësishëm sa edhe trajnimi i stafit mbështetës. Përveç kësaj, roli i arsimimit të vazhdueshëm, ose brenda organit, ose jashtë tij, do të luajë një rol të caktuar. Po ashtu si edhe burimet financiare që do të trajtohen më poshtë, marrëdhënia midis madhësisë së tregut kombëtar të prokurimeve publike dhe kompleksitetit të detyrave që i janë ngarkuar një organizate qendrore të prokurimeve dhe madhësisë së stafit të saj përbëjnë një konsideratë tjetër të rëndësishme. Madhësia e stafit të organeve qendrore të prokurimeve publike ndryshon nga njëri shtet anëtar në tjetrin. Për më tepër, përderisa shumë prej organeve kryesore merren me shumë çështjetë tjera përveç funksioneve të prokurimit publik të përmendura më sipër, nuk është gjithmonë e qartë se sa njerëz punojnë në fakt për funksionet bazë dhe në ato plotësuese të organeve qendrore të prokurimeve publike.

Seksioni për Ligjin e Prokurimeve i Shërbimit të Kushtetutës së Kancelarisë Federale të **Austrisë** ka një staf prej katër nëpunësish civilë që punojnë me kohë të plotë dhe që kanë diplomë në drejtësi. *Bundesbeschaffungs GmbH* që është në pronësi publike, ka 58 punonjës: një nëpunës civil dhe 57 punonjës. Pesë personat që punojnë në Departamentin Juridik të këtij institucioni kanë një diplomë universitare në drejtësi. Në Departamentin e Shitjeve, stafi ka ose një formim arsimor teknik ose tregtar ose një diplomë universitare. Numri I përgjithshëm i stafit në Agjencinë e Prokurimeve Publike të **Bullgarisë** është 38, dhe ky përbëhet nga nëpunës civilë dhe punonjës, prej të cilëve 34 persona kanë diploma të nivelit master (19 në ekonomi, 9 në drejtësi dhe 6 në teknologji informacioni). Në të ardhmen e afërt, stafi do të rritet deri në 50 persona. Departamenti i Prokurimeve Publike i **Qipros** ka të punësuar 14 persona, pa përmendur stafin e sekretarëve. Këtu janë pesë ekspertë kontabël profesionistë, gjashtë të diplomuar për ekonomik dhe inxhinieri, dhe 3 të diplomuar në LÇI.

Departamenti Juridik i Zyrës **Çeke** për Mbrojtjen e Konkurrencës ka gjashtë punonjës, Seksioni i Prokurimeve Publike ka tridhjetë punonjës, Komisioni i Apelimeve ka gjashtë punonjës dhe rreth njëzetë specialistë, Departamenti i Organizimit dhe Financës ka dhjetë punonjës dhe Departamenti i Integritit European dhe i Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka gjithashtu dhjetë punonjës. Shumica e punonjësve kanë një diplomë universitare në ekonomik ose juridik. Katër nëpunës civilë në Ministrinë e Financave të **Estonisë** merren posaçërisht me çështjet e prokurimeve publike dhe tetëmbëdhjetë punonjës punojnë në Zyrën e Prokurimeve Publike. Në **Finlandë**, merren me çështjet e prokurimeve publike rreth katër nëpunës civilë në Ministrinë e Financave të Finlandës dhe pesëdhjetë punonjës të kompanisë private Hansel Ltd.

Në **Francë**, rreth 40 persona punojnë për Drejtorinë e Prokurimeve Publike dhe 18 për Komisionin Shtetëror. Në seksionin e prokurimeve të Departamentit të Çështjeve Gjyqësore në Ministrinë e Ekonomisë, të Financave dhe të Industrisë 30 nëpunës civilë kanë diploma universitare. Në vitin 2005, Këshilli i Prokurimeve Publike i **Hungarisë** kishte në Sekretariat 23 anëtarë dhe 33 punonjës. Shumica e anëtarëve të stafit janë nëpunës civilë, por disa janë punësuar me kohë të pjesshme me detyra pune të përgjithshme ose të veçanta. Sipas Ligjit për Nëpunësit Civilë të Hungarisë, kërkohet edhe një diplomë e dytë dhe në rastin e postit të administratorit kërkohet edhe një diplomë profesionale e nivelit të mesëm. Nëpunësi civil duhet të kalojë në një provim profesional në administratë publike, ndërsa një jurist duhet të

kalojë një provim profesional të fushës juridike brenda tre viteve të punësimit të tij. Komisionerët e prokurimeve publike duhet të kenë një diplomë të arsimit të lartë dhe tre vjet përvojë profesionale si edhe të kalojnë një provim në fushën juridike ose në administrim publik. Në vitin 2005, numri i përgjithshëm i stafit që punonte në Bordin e Arbitrazhit të Prokurimeve Publike të Hungarisë dhe në Sekretariatit e tij ishte 79 persona. Njësia Kombëtare për Politikën e Prokurimeve Publike e **Irlandës** ka 10-12 punëonjës: një shef njësie, një këshilltar profesional për ndërtimin, 5 punonjës të nivelit të mesëm të menaxhimit dhe 4 -5 punonjës për punë sekretarie.

Në vitin 2006, Autoriteti i Punëve Publike i **Italisë** kishte një staf prej 237 nëpunësish civilë, shumica e të cilëve kishte diplomë në inxhinieri, në juridik ose në ekonomik. 70% e stafit e njihin ligjin e BE-së. CONSIP ka rreth 500 punonjës, 355 prej të cilëve kanë një diplomë universitare. 32 punonjësit e Zyrës së Monitorimit të Prokurimeve të **Letonisë** përbëhen nga 18 nëpunës civilë dhe 14 punonjës, ndërsa Agjencia Shtetërore e Prokurimeve Elektronike ka një staf prej 32 personash nga të cilët 18 janë nëpunës civilë dhe 14 punonjës. Afërsisht, gjysma e tyre kanë formim juridik dhe rreth ¼ kanë formimin ekonomik. Përveç personelit për biznes, atij administrativ dhe eksperitve kontabël, edhe të gjithë të tjerët i njohin prokurimet publike. Dy nëpunës civilë në Ministrinë e Punëve Publike të **Luksemburgut** merren vetëm me prokurimet publike.

Kryetari i Zyrës së Prokurimeve Publike të **Polonisë** mbështetet nga një staf prej 115 personash. Të gjithë nëpunësit civilë dhe pothuaj të gjithë punonjësit e PPO-së kanë diploma universitare dhe shumë prej tyre janë juristë. Në veçanti, tre anëtarë të stafit të Njesisë së të Drejtës Europiane dhe katër anëtarë të stafit të Departamentit të Bashkëpunimit, të Studimeve dhe të Analizave Ndërkombëtar e njohin ligjin e KE-së. I gjithë stafi i Departamentit Juridik, i Departamentit të Kontrollit, i Departamentit të Publikimeve dhe Trajnimeve e njohin me Ligjin e Prokurimit Publik. Aspektet financiare dhe teknike të prokurimit njihen prej disa personave të stafit me përvojë në autoritetet kontraktuese. Nëntë nëpunës civilë punojnë për *Direcção Geral do Património* të **Portugalisë**.

Në **Rumani**, Autoriteti Kombëtar për Rregullimin dhe Monitorimin e Prokurimeve Publike (NARMPP) aktualisht ka 70 persona me kohë të plotë, por numri i përgjithshëm i vendeve të punës është 125. 90% e stafit kanë diplomë universitare në fusha të ndryshme, dhe këta janë ekonomistë, juristë dhe inxhinierë. Rregullat e administratës publike për ngritjen në detyrë kanë fuqi edhe për NARMPP-in. I gjithë stafi i NARMPP-it njihet me dispozitat e legjislacionit për prokurimet publike. Rreth 130 persona të stafit në Ministrinë e Financave punojnë për kontrollin *ex ante* në fushën e prokurimeve publike. Zyra e Prokurimeve Publike e **Slovakisë** ka një staf prej 110 personash, prej të cilëve 90 janë nëpunës civilë dhe 20 janë punonjës. Afërsisht, të gjithë kanë mbaruar kolegjin ose universitetin. Në **Sloveni**, tetë nëpunës civilë me formim akademik punojnë në Departamentin për Prokurimet Publike, për Shërbimet në Infrastrukturë dhe Koncesionet.

Sekretariati i NOU-t i **Suedisë** ka nëntë deri në dhjetë punonjës (juristë dhe ekonomistë me diploma universitare), dhe dy nëpunës civilë në Ministrinë e Financave punojnë vetëm me çështjet e prokurimeve publike. Zyra e Tregtisë e Qeverisë e **Mbretërisë së Bashkuar** aktualisht ka punësuar rreth 500 veta, shumica e të cilëve nëpunës civilë, por edhe konsulentë. Nga këta, vetëm një numër i vogël merret me çështjet e politikave themelore të prokurimeve dhe janë rreth 25 veta gjithsej. Formimi i tyre arsimor është i ndryshëm. Shumica e stafit morri trajnim profesional për prokurimet dhe shumica e njohin ligjin e KE-së dhe ligjin për prokurimet. Një përqindje e madhe e anëtarëve të stafit është i njeh aspektet financiare dhe teknike të prokurimit.

### 7.2.2 Mjetet e të ardhurave financiare

**Burimet financiare** kanë të bëjnë jo vetëm me buxhetin e institucioneve qendrore të prokurimeve publike, por edhe me burimet e të ardhurave të tyre. Shumë institucione i nxjerrin të ardhurat e tyre nga buxheti i përgjithshëm, për shembull, alokimet nga buxheti i Ministrisë tek e cila ata janë të atashuar. Zyra të tjera mund të kenë burimet e veta të të ardhurave, për shembull, përmes tarifave që paguhet për publikimin e

kontratave ose edhe përmes disa formave të ngjashme me “taksat” për çdo kontratë. Madhësia e buxhetit nuk është çështja e vetme kryesore këtu. Madhësia e tregut kombëtar të prokurimeve publike dhe kompleksiteti i detyrave të caktuara për organizatën qendrore të prokurimeve janë çështje gjithashtu të rëndësishme.

Në vitin 2005, buxheti i Agjencisë së Prokurimeve Publike të **Bullgarisë** u hartua dhe pastaj u dërgua në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Energjisë për miratin. Buxheti i Zyrës për Mbrojtjen e Konkurrencës i **Çekisë** është kryesisht pjesë e buxhetit të qeverisë, por personi që bën një ankesë duhet të ketë një depozitë dhe në të njëjtën kohë të paguajë një shumë e cila tani nuk paguhet më. Buxheti vjetor i Zyrës së Prokurimeve Publike të **Estonisë** është pjesë e buxhetit të përgjithshëm të shtetit. Buxheti vjetor i nëndrejtorisë së prokurimeve publike i DAJ-it të **Francës** është pjesë e buxhetit të shtetit.

Në vitin 2005, buxheti i Këshillit të Prokurimeve Publike të **Hungarisë** ishte pjesë e ligjit për buxhetin vjetor. Buxheti përgatitej përmes konsultimeve midis staffit të sekretariatit të PPC-së dhe Ministrisë së Financave dhe pastaj miratohej nga parlamenti. Megjithatë, të ardhurat nuk e kanë burimin vetëm nga buxheti i ministrisë, por edhe nga tarifat për publikimet dhe gjobat (50% e të ardhurave). Tarifat e shërbimeve të administratës publike që kishin të bënin me administrimin e listave të ndryshme (lista e konsulentëve zyrtarë të prokurimeve publike, lista zyrtare e kontraktorëve të miratuar, lista e punonjësve të pajtimit) dhe tarifat që paguheshin për fillimin e procedurave të shqyrtimeve janë burime të tjera për të ardhurat e PPC-së. Përveç kësaj, në Këshill shkojnë edhe të ardhurat nga shitjet e buletinit (megjithëse këto të ardhura janë shumë më të pakta se kostot e publikimeve).

Në **Itali**, buxheti që i caktohet CONSIP është pjesë e buxhetit të përgjithshëm të ministrisë dhe del nga kuotat fikse që mbulojnë kostot fikse të programit (për shembull, të personelit) dhe të një kuote të ndryshueshme që mbulon kostot e projekteve novatore strategjike. Buxheti i Zyrës së Monitorimit të Prokurimeve i **Letonisë** është pjesë e buxhetit të shtetit. Buxheti për shpenzimet e Departamentit të Kontratave i **Maltës** financohet nga buxheti i përgjithshëm i qeverisë. Përlllogaritjet e buxhetit përgatiten aty nga shtatori i çdo viti dhe i dërgohen Ministrisë së Financave. Buxheti përshtatet sipas përparësive të vendit. Buxheti i rishikuar miratohet në parlament në fund të vitit kalendarik.

Buxheti fillestar për Zyrën e Prokurimeve Publike të **Polonisë** është pjesë e buxhetit të shtetit dhe përgatitet në përputhje me ligjin për buxhetin. Kostot e procedurave të apelimit mbulohen nga tarifat e detyrueshme të regjistrimit. Buxhetet e institucioneve të ndryshme prokuruese të **Portugalisë** janë pjesë e buxhetit të shtetit. Buxheti i Autoritetit Kombëtar për Rregullimin dhe Monitorimin e Prokurimeve Publike të **Rumanisë** është pjesë e buxhetit të përgjithshëm shtetit. Buxheti i Zyrës së Prokurimeve Publike të **Slovakisë** përbën një pjesë të veçantë të buxhetit të shtetit. Tarifat, gjobat dhe garancia financiare janë të ardhura për buxhetin e shtetit.

Financat e Departamentit për Prokurimet Publike, Shërbimet në Infrastrukturë dhe Koncesionet në **Sloveni** janë pjesë e buxhetit të përgjithshëm të Ministrisë dhe qeverisë. Operacionet e NOU-t të **Suedisë** financohen përmes buxhetit të përgjithshëm të qeverisë. Drejtoria e Prokurimeve Publike (PPD) e Zyrës së **Mbretërisë së Bashkuar** për Tregtinë e Qeverisë (OGC) i financon veprimtaritë e veta përmes buxhetit të shtetit, i cili mbulon të gjitha kostot administrative dhe vetëm një pjesë e financimit merret nga burime të jashtme, nga mallrat e shërbimet. Buxheti vjetor i korporatës OGC-ë përcaktohet me marrëveshje me Thesarin e Madhërisë së Saj (Ministrinë e Financave) pas diskutimesh mbi përlllogaritjen e niveleve të burimeve të kërkuara për planin e tij të biznesit, i cili përbëhet nga planet e biznesit të njësisë të veçanta organizative. Planet e veçanta të biznesit dhe buxhetet merren parasysh nga Bordi i Investimeve dhe i Zbatimit i OGC-së, i cili garanton që burimet e alokuara për elementë të ndryshëm të organizatës të jenë të përputhura me përparësitë e korporatës. Buxheti i PPD-së miratohet në të njëjtën mënyrë si edhe për njësitë e tjera organizacionale të OGC-së.

Siç është përmendur më sipër, institucionet qendrore të prokurimeve publike në shumicën e shteteve anëtare financohen përmes buxhetit të përgjithshëm të qeverisë ose të ministrisë. Në të gjitha shtetet anëtare, pjesa më e madhe e financimeve të tyre sigurohet përmes buxhetit të përgjithshëm të qeverisë ose

të ministrisë. Në Hungari dhe në Poloni, të ardhurat shtesë sigurohen përmes tarifave dhe depozitave që duhet të paguhet për procedurat e shqyrtimeve. Megjithatë, të ardhurat shtesë nënkupton që institucioni që kryen funksionet qendrore të prokurimeve publike, siç janë përcaktuar ato në këtë studim, duhet të kryejë edhe funksionin e lidhur me to të shqyrtimit apo analizës. Tarifat gjithashtu mund të sjellin të ardhura kur institucioni qendror i prokurimeve publike është përgjegjës për mbajtjen e listave të të kualifikuarve ose për botimin e njoftimeve të kontratave.

## **8. Mjedisi që ndryshon i prokurimit publik**

Në këtë pjesë bëhet një panoramë e gjerë e faktorëve që mund të ndikojnë mbi sistemet e prokurimeve publike në shtetet anëtare dhe trajtohen pasojat e mundshme të këtij procesi ndryshimi.

Siç u trajtua dhe më lart, studimi zbulon ekzistencën e një vije ndarëse krejt të qartë midis tipit të strukturës së organizimit në grupin e shteteve të reja anëtare krahasuar me atë që është në fuqi në shtetet “e vjetra” anëtare. Në përgjithësi, shumica e vendeve që kohët e fundit iu bashkuan BE-së kanë ndërtuar organe qendrore me një organizim relativisht të fortë brenda strukturave të tyre qeveritare. Këtyre organeve u janë dhënë një shkallë e gjerë përgjegjësie dhe role koordinuese që mbulojnë funksione bazë si edhe një gamë të gjerë të funksioneve plotësuese. Në shtetet “e vjetra” anëtare, funksionet plotësuese dhe, në veçanti, detyrat mbështetëse, organizohen shpesh në një mënyrë të decentralizuar.

Pikënisje për diskutimin e mëtejshëm mund të jetë pyetja se pse sistemet e prokurimeve publike janë zhvilluar, nga pikëpamja institucionale, kaq ndryshëm në dy grupet e shteteve anëtare. Një shpjegim i arsyeshëm mund të jetë ai i rrethanave dhe kushteve të ndryshme në të cilat sistemet e prokurimeve publike janë formuar dhe zhvilluar brenda shteteve të reja anëtare krahasuar me procesin më evolutiv që ka karakterizuar zhvillimin institucional në shtetet “e vjetra” anëtare. Fillimisht, zbatimi i legjislacionit të ri mbi prokurimin publik të bazuar mbi tregun, shpesh brenda një afati shumë të shkurtër kohe, kërkoi një mobilizim efektiv dhe të shpejtë të mbështetjes dhe të përpjekjeve nga ana e qeverisë me qëllim që të ishte i suksesshëm. Për këtë arsye, qeveritë përgjithësisht e kuptuan se një parakusht për një proces efektiv të reformës ligjore ishte përdorimi i një zgjidhjeje të centralizuar institucionale e cila do të kishte autoritetin dhe detyrat e caktuara të koordinimit, menaxhimit dhe të mbështetjes së zbatimit të legjislacionit për prokurimet publike. Nevoja për një pikë qendrore të fortë brenda strukturës së qeverisë u theksua më shumë në momentin që ky grup vendesh e morën statusin e vendit kandidat të BE-së, duke shtuar në këtë mënyrë një numër të ri detyrimesh. Vendet që ishin në procesin e anëtarësimit në BE kishin detyrimin të transpozicionit të drejtën komunitare edhe në fushën e prokurimeve publike. Po kaq e rëndësishme është edhe fakti se ato kishin nevojë të forconin kapacitetin e administratave të tyre qendrore për të garantuar që *acquis* jo vetëm të transpozohet si duhet, por edhe që legjislacioni për prokurimin publik të zbatohet në mënyrë eficiente. Në kontrast me këtë ndryshim të shpejtë dhe radikal të sistemeve, që çoi kryesisht në modele institucionale tipikisht të centralizuara, prokurimi publik në shtetet “e vjetra” anëtare është zhvilluar gradualisht për më shumë se një shekull, gjë që patjetër ka çuar në formimin e një larmie të modeleve të organizimit. Pjesa më e madhe e tyre kanë ruajtur një strukturë dhe organizim shumë të centralizuar të prokurimeve publike. Në nivelin e qeverisë qendrore, shtetet “e vjetra” anëtare kanë tentuar të mbështeten në funksione të vogla ligjore dhe të politikës së prokurimiyr, ndërsa funksionet plotësuese, si këshillimi për prokurimet dhe forcimi i kapaciteteve, kanë qenë shpesh një përgjegjësi e përbashkët e tyre dhe e autoriteteve rajonale e vendore si edhe e shumë aktorëve të tjerë, përfshirë këtu edhe sektorin privat.

Me këtë ndryshim midis shteteve anëtare “të reja” dhe “të vjetra” si bazë për vazhdimin e mëtejshëm të diskutimit, kanë ndodhur ose po ndodhin një numër ngjarjesh të rëndësishme brenda fushës së prokurimeve publike. Ky proces ndryshimesh duhet të mendohet mirë dhe të trajtohet me efikasitet nga qeveritë, përderisa këto ndryshime do të kenë pasojat në lidhje me organizimin sa më të mirë të strukturës institucionale të sistemit të prokurimit publik. Në veçanti, zhvillimet kryesore të mëposhtme duhet të merren parasysh nga shtetet anëtare.

### ***Zhvillimet legislative dhe rregullatore të kohëve të fundit në Bashkimin Europian***

Me miratimin e Direktivave të Komisionit Europian 2004/17 dhe 18, shtetet anëtare kishin detyrimin të miratonin legjislacion kombëtar për prokurimin publik duke transpozuar Direktivat e reja deri në 1 shkurt 2006. Direktivat e reja sollën një numër instrumentesh dhe mekanizmash të reja që pasqyronin nevojën në rritje për më shumë qartësi, modernizim dhe thjeshtim të kuadrit legjislativ europian për prokurimin publik. Megjithatë shteteve anëtare u është lënë në dorë në disa raste të vendosin vetë për të futur ose jo një dispozitë të caktuar në Direktivat, të tillë si dialogu konkurrues, përshtypja e përgjithshme është se për shumicën e shteteve anëtare Direktivat e reja mund të kërkojnë një ndryshim të konsiderueshëm përse i përket mënyrës se si do të organizohen dhe kryhen prokurimet publike. Këto nuk do të ndikojnë patjetër në mënyrën me të cilën janë organizuar brenda strukturës së prokurimeve publike funksionet tipike rregullatore dhe monitoruese, por më shumë tek gama e funksioneve të larmishme mbështetëse dhe koordinuese. Një nga objektivat kryesore të kuadrit të ri legjislativ ishte të ofronte një shkallë më të lartë thjeshtimi në procesin e prokurimit dhe në praninë e alternativave më të shumta për zgjedhjen e metodave të prokurimit dhe kjo përfundimisht është arritur, por efektet e këtyre ndryshimeve do të prodhojnë njëkohësisht një ndërlikim në rritje në shumicën e sektorëve të sistemit të prokurimeve publike. Ndryshimet më të dukshme janë futja e marrëveshjeve kuadër, e organeve qendrore të prokurimeve, e prokurimit elektronik, e dialogut kompetitiv, e specifikimeve teknike të mbështetura në performancën, dhe e marrjes parasysh të aspekteve mjedisore. Disa shtete anëtare i kanë futur tashmë disa nga procedurat e reja në dispozitat kombëtare, të tilla si marrëveshjet kuadër dhe organet qendrore të prokurimeve, por kjo kategori e shteteve anëtare nuk do të mbetet pa u prekur përse i përket rishikimit të legjislacionit për prokurimin, përfshirë këtu rregullat për zbatimin dhe vendimet për mënyrën e organizimit më efektiv të këtyre mekanizmave.

### ***Zhvillimi teknologjik***

Përdorimi i mjeteve dhe i metodave elektronike në shkallë të gjerë në faza të ndryshme të procesit të prokurimeve publike do të futet dhe praktikohet gradualisht në prokurimin publik duke zëvendësuar metodat aktuale të bazuara në letra. Ekzistojnë gjithashtu edhe disa ndryshime të tjera përse i përket zhvillimeve të shpejta në sektorin e teknologjisë së informacionit të cilat kanë ndikim në tregun e prokurimeve publike dhe për pasojë, prodhojnë nevojën që të gjitha shtetet anëtare ta mendojnë me kujdes se si do të përballohet sa më mirë kjo sfidë dhe se çfarë përgatitjesh duhen bërë për t'i përshtatur në mënyrën më efektive sistemet e tyre të prokurimit me kushtet e reja të tregut. Zhvillimet teknologjike do të bëjnë të mundur një ndryshim themelor të praktikave dhe të modeleve të mënyrës në të cilën do të kryhen prokurimet publike në të ardhmen, por sigurisht që nuk është e mundur të parashikohen që në këtë fazë të gjitha pasojat praktike dhe operationale. Megjithatë, janë parashikuar disa efekte të mundshme si nevoja në rritje për të zhvilluar funksione qendrore mbështetëse me sistemet drejtuese të bazuara në internet, krijimi i sistemeve të standardizuara për dokumentacionin e tenderave dhe të kontratave, zhvillimi i sistemeve të publikimit dhe nformimit të përmirësuar dhe të lehta për t'u përdorur dhe zhvillimi i sistemeve për koordinimin dhe bashkëpunimin midis enteve kontraktuese.

### ***Forcimi i theksit tek efijenca***

Operationet e prokurimeve publike dhe për pasojë edhe strukturat mbështetëse të prokurimeve, ndikohen fuqimisht nga përpjekjet e vazhdueshme në shumë vende për të ripërkufizuar rolin e sektorit publik duke vënë në përdorim iniciativa dhe masa të reja për reformimin e ekonomisë për të marrë zgjidhje më të efektshme nga pikëpamja e kostos për kryerjen e shërbimeve të sektorit publik, të tilla si çlirimi nga rregullat, privatizimi i operationeve publike, përdorimi i marrëveshjeve të koncesionit dhe partneritetet midis sektorit publik dhe atij privat.

Bashkë me instrumentet e reja të përcaktuara në Direktivat e KE-së dhe me rritjen e përpjekjeve për të rritur efijençën dhe për të siguruar vlerën më të mirën të parave të shpenzuara në të gjitha nivelet e sektorit publik do të theksohet më fort nevoja për të krijuar sisteme për blerjet e koordinuara dhe për përdorimin më të gjerë të marrëveshjeve kuadër kur ka vend për këtë gjë. Kjo do të bëhet me qëllim që të shfrytëzohen

kompetencën për blerje kolektive dhe për të siguruar çmime më të mira, kosto më të ulëta, si edhe standardizimin teknik dhe funksional të produkteve dhe të shërbimeve të ofruara sektorit publik.

### ***Profesionalizimi i vazhdueshëm i funksionit të prokurimit***

Efektet e kombinuara të zhvillimeve rregullatore, teknologjike dhe tregtare duhet të krijojnë një kërkesë për rritjen e profesionalizimit të funksionit të prokurimit në nivelin operacional (si në entet kontraktuese ashtu edhe në sektorin privat). Entet kontraktuese me siguri do të përballen me një mjedis gjithnjë e më kompleks të prokurimeve, i cili do të përmbajë një gamë më të gjerë funksionesh dhe përgjegjësish ose të paktën një situatë ndjeshëm të ndryshme krahasuar me detyrat tradicionale të prokurimit, gjë që nga ana e vet ndikon në aftësitë e kërkuara dhe në zgjedhjen e zgjidhjes së organizimit dhe bashkëpunimit. Po ashtu do të ketë edhe një kërkesë të vazhdueshme për arsimin e lartë dhe për trajnimet e specializuara në fushën e prokurimit publik në disiplina dhe profesione të ndryshme.

Strukturat e prokurimeve publike që të jenë efçente duhet të jenë të ndjeshme ndaj mjedisit në ndryshim të prokurimeve si edhe të hedhin hapat e duhur për gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme institucionale për prokurimet publike. Në veçanti, do të kërkohet një strukturë më të fortë mbështetëse e cila të ofrojë këshillim profesional dhe forcim të kapaciteteve.

Funksionet rregullatore dhe monitoruese bazë do të mbeten brenda administratës të qeverisë qendrore ashtu si mund të qëndrojnë edhe detyrat këshillimore të lidhura ngushtë me funksionet legjislative dhe rregullatore. Megjithatë, funksionet e këshillimit profesional dhe të mbështetjes së operacioneve mund të organizohen po ashtu në nivel qendror, por ato përveç kësaj do të jenë një përgjegjësi e përbashkët dhe do të kryhen nga shumë aktorë, përfshirë dhe sektorin privat. Funksionet e teknologjisë së informacionit dhe të publikimeve mund të kryheshin me lehtësi edhe jashtë nivelit qendror nga organe të specializuara, përfshirë edhe ato të sektorit privat. Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve mund të jenë një përgjegjësi në nivel qendror përsa i përket drejtimit të politikave dhe strategjive, por ato do të kryhen nga shumë organe dhe aktorë.

## **9. Përmbledhje e përfundimeve kryesore**

Studimi tregon se ka edhe ngjashmëri, edhe ndryshime në mënyrën me të cilën shtetet anëtare i kanë organizuar funksionet e tyre qendrore të prokurimeve publike.

Së pari, për qëllimet e studimit këto funksione janë nënndarë në dy ***tipe funksionesh***, përkatësisht në funksione bazë dhe funksione plotësuese. Të gjitha shtetet anëtare kanë zgjedhur të organizojnë funksionet bazë - kryesisht detyrat në lidhje me politikën dhe ato rregullatore - në mënyrë qendrore në një nivel të lartë qeveritar, ndërsa situata është më e përzier përsa i përket funksioneve plotësuese ose atyre mbështetëse. Duket se grupi i shteteve anëtare që u pranuan në BE tani së fundi ka preferuar t'i organizojë strukturat e prokurimeve të tyre në një mënyrë më të centralizuar, ndërsa një grup shtetesh anëtare "të vjetra" tregojnë një tablo më të larmishme, ku spikat shpërndarja më e gjerë e funksioneve në organe të ndryshme të niveleve të ndryshme të administratës.

Së dyti, studimi trajton çështjen e **kapacitetit administrativ** brenda strukturës së prokurimit publik për të përmbushur në mënyrë efektive dhe efçente të gjitha përgjegjësitë që lidhen me menaxhimin e sistemit të prokurimit publik në nivel qendror. Studimi del në përfundimin se kapaciteti administrativ nuk është i lidhur vetëm me nivelin e stafit dhe burimet financiare të disponueshme brenda institucioneve qendrore të prokurimeve, por ka nevojë të përcaktohet edhe më gjerë. Kapaciteti i përgjithshëm i shteteve anëtare për të mbështetur operacionet e prokurimeve publike mbi një bazë të grumbulluar mund të jetë i fortë nëse përfshihen të gjithë aktorët e shoqërisë, në mënyrë që ky kapacitet të mos kufizohet në nivelin e institucioneve qendrore. Ndërsa studimi jep një informacion interesant mbi sasinë e burimeve të alokuara në nivel qendror, në të njëjtën kohë nuk duhet harruar se madhësia e institucioneve qendrore të prokurimeve varet nga një numër faktorësh, si për shembull, madhësia e ekonomisë dhe numri i enteve kontraktuese dhe i kontratave të prokurimeve, dhe nuk pasqyron patjetër përparësitë e qeverisë.

Së treti, studimi trajton çështjen e organizimit, të varësive, të statusit dhe të bazës ligjore të organeve qendrore të prokurimit. Cilatdo modele të organizimit janë zgjedhur, duket se prokurimi publik është zakonisht përgjegjësi e Ministrisë së Financave, e Ministrisë së Ekonomisë, ose e Ministrisë së Punëve Publike. Baza ligjore është shpesh ligji për prokurimet publike ose ligji administrativ. Disa shtete anëtare kanë ngritur zyra ose agjenci të prokurimeve publike të cilave u kanë dhënë një status më të pavarur duke i vendosur drejtpërdrejt në varësi të parlamentit ose të qeverisë, ndërsa zyra të tjera veprojnë si departamente brenda strukturave të ministrisë përkatëse. Disa funksione të një natyre operacionale janë të organizuara në kompani në pronësi publike.

Së katërti, zhvillimi i funksioneve kyçe të prokurimeve është trajtuar shkurt në dritën e një mjedisi prokurimesh publike i cili po ndryshon. Ky mjedis është duke u rritur gradualisht në kompleksitet si pasojë e vënies në përdorim të instrumenteve dhe mekanizmave të reja të prokurimeve, të zhvillimeve teknologjike dhe të theksit më të fortë në efikasitetin e kryerjes së shërbimeve publike. Çdo strukturë prokurimi ka nevojë të mendojë si të rrisë më mirë profesionalizimin e funksionit të prokurimit dhe si të plotësojë nevojën që lind për të zhvilluar, në veçanti, strukturën mbështetëse të prokurimit. Prandaj, është shumë e rëndësishme të gjendet modeli i përshtatshëm global i organizimit i cili vendos një ekuilibër efektiv dhe të natyrshëm midis specifikave të funksioneve në fjalë dhe kërkesave të tyre përsa i përket pavarësisë dhe bashkëveprimit, duke shmangur në të njëjtën kohë konfliktin e interesit.

**SHTOJCË. TABLO KRAHASUESE E STRUKTURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK NË SHTETET ANËTARE TË BE**

<b>Shteti anëtar</b>	<b>Institucionet kryesore</b>	<b>Numri i stafit</b>	<b>Varësia</b>	<b>Funksionet kryesore</b>
1. Austria (Strukturë gjysmë e centralizuar)	Seksioni për Ligjin e Prokurimeve	4	Zyra Federale e Kancelarit	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet këshilluese Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e informimit
	Prokurimi Federal Shpk.	58	Ministria e Financave	Zhvillimi dhe koordinimi i biznesit Funksioni i blerjeve qendrore
2. Bullgaria (Strukturë e centralizuar)	Agjencia e Prokurimeve Publike	38	Ministria e Ekonomisë dhe e Energjetikës	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e publikimit dhe të informimit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve
3. Qiproja (Strukturë e centralizuar)	Drejtorja e Prokurimeve Publike	14	Thesari	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve
4. Republika Çeke (Strukturë e centralizuar)	Departamenti i Investimeve Publike	17	Ministria për Zhvillim Rajonal	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksionet këshilluese Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit



				Funksionet e publikimit dhe informimit (pjesërisht)
5. Estonia (Strukturë e centralizuar)	Zyra e Prokurimeve Publike	19	Ministria e Financave	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e publikimit dhe të informimit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve
	Njësia e Ndhmës Shtetërore dhe e Prokurimeve Publike, Departamenti i Qeverisjes Publike	4	Ministria e Financave	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor
6. Finlanda (Strukturë e decentralizuar)	Departamenti i Tregtisë	4	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksioni i koordinimit ndërkombëtar (ndahet me të tjerë) Funksionet këshilluese (ndahet me të tjerë) Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e informimit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve (ndahet me të tjerë)
	Departamenti i Buxhetit	2	Ministria e Financave	Funksionet e politikave të përgjithshme
	Haus Shpk	2	Ministria e Financave	Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve (ndahet me të tjerë)
	Hansel Shpk	50	Ministria e Financave	Zhvillimi dhe koordinimi i biznesit Funksioni i blerjeve qendrore
7. Franca (Strukturë gjysmë e centralizuar)	Departamenti i Prokurimeve Publike, Drejtoria për Çështjet	40	Ministria Ekonomisë, Financave dhe e Industrisë	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve Funksioni i koordinimit

	Ligjore			ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e informimit
8. Gjermania (Strukturë gjysmë e centralizuar)	BMW i	10	Ministria Federale e Ekonomisë dhe e Teknologjisë	Hartimi i legjislacionit parësor Hartimi i legjislacionit dytësor (ndahet me të tjerë) Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet këshilluese Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e informimit
	Bundesverwalt ungsamt (Zyra Federale për Administrimin )	9	Ministria Federale e Brendshme	Funksionet e publikimit
	Ministria e Transportit, Ndërtimit dhe Çështjeve Urbane			Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve (ndahet me të tjerë)
9. Hungaria (Strukturë e centralizuar)	Këshilli i Prokurimeve Publike	35	Parlamenti	Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e publikimit dhe të informimit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve
	Departamenti i të Drejtës Civile, i Kodifikimit dhe të Drejtës Private Ndërkombëtare	4	Ministria e Drejtësisë dhe e Zbatimit të Ligjit	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor (ndahet me të tjerë) Funksioni i koordinimit ndërkombëtar
10. Irlanda (Strukturë gjysmë e centralizuar)	Njësia e Politikave Kombëtare të	12	Departamenti i Financave	Hartimi i legjislacionit parësor Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve

	Prokurimeve Publike			Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve
11. Italia (Strukturë gjysmë e centralizuar)	Autoriteti i Punëve Publike	237	Parlamenti	Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit
	CONSIP (kompani publike e kufizuar)	500	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave (pronare)	Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve Zhvillimi i biznesit dhe koordinimi Funksioni i blerjeve qendrore
	Këshilli i Ministrave			Hartimi i legjislacionit parësor
12. Letonia (Strukturë e centralizuar)	Byroja e Monitorimit të Prokurimeve	32	Ministria e Financave	Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e publikimit dhe të informimit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve Shqyrtimi i ankesave dhe korrigjimi
	Ministria e Financave	3		Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksioni i koordinimit ndërkombëtar
13. Lituania (Strukturë e centralizuar)	Zyra e Prokurimeve Publike	60	Zyra e Kryeministrit	Hartimi i legjislacionit dytësor Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e publikimit dhe të informimit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve
	Ministria e Ekonomisë	3		Hartimi i legjislacionit parësor Funksioni i koordinimit

				ndërkombëtar
14. Luksemburgu (Strukturë gjysmë e centralizuar)	Ministria e Punëve Publike	1		Hartimi i legjislacionit parësor Funksionet këshilluese Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit Funksionet e informimit
15. Malta (Strukturë e centralizuar)	Departamenti i Kontratave	40	Ministria e Financave	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e publikimit dhe të informimit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve Zhvillimi i biznesit dhe koordinimi Funksioni i blerjeve qendrore Shqyrtimi i ankesave dhe korrigjimi (Bordi i Apelineve)
16. Polonia (Strukturë e centralizuar)	Zyra e Prokurimeve Publike	116	Zyra e Kryeministrit	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e publikimit dhe të informimit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve Shqyrtimi i ankesave dhe korrigjimi (Bordi i Apelineve)– PPO administron sistemin.
17. Portugalia (Strukturë e decentralizuar)	Drejtoria e Përgjithshme për Pronën Shtetërore, Drejtoria për Çështjet	9	Këshilli Ministrave	i Funksionet e politikave dhe të hartimit të legjislacionit parësor (qeveria) Funksioni i koordinimit ndërkombëtar

	Europiane; Departamenti i Prokurimeve Publike; Instituti për Punët Publike			Koordinimi i biznesit Funksioni i blerjeve qendrore Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksioni i forcimit të kapaciteteve
18. Rumania (Strukturë e centralizuar)	Autoriteti Kombëtar për Rregullimin dhe Monitorimin e Prokurimeve Publike	70	Zyra e Kryeministrit	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e informimit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve
19. Republika Sllovaqe (Strukturë e centralizuar)	Zyra për Prokurimet Publike	110	Këshilli Ministrave	i Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksionet e këshillimit dhe të mbështetjes së operacioneve Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e publikimit dhe të informimit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve Shqyrtimi i ankesave dhe korrigjimi
20. Sllovenia (Strukturë gjysmë e centralizuar)	Departamenti i Prokurimeve Publike, Shërbimet në Infrastrukturë dhe Koncesionet	8	Ministria e Financave	Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksionet këshilluese Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit dhe të kontrollit Funksionet e informimit
21. Suedia (Strukturë gjysmë e centralizuar)	Bordi për Prokurimet Publike	10	Ministria e Financave	Funksionet këshilluese Funksioni i koordinimit ndërkombëtar (ndahet me të tjerë) Funksionet e monitorimit

				Funksionet e informimit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve
	Ministria e Financave	3		Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor Funksioni i koordinimit ndërkombëtar
22. Mbretëria e Bashkuar (Strukturë gjysmë e centralizuar)	Zyra e Tregtisë e Qeverisë	25 (500)	Thesari i Madhërisë së Saj (Ministria e Financave)	Hartimi i legjislacionit dytësor Funksionet këshilluese dhe mbështetëse të operacioneve Funksioni i koordinimit ndërkombëtar Funksionet e monitorimit Funksionet e informimit Funksionet e profesionalizimit dhe të forcimit të kapaciteteve (ndahet me të tjerë) Zhvillimi i biznesit dhe koordinimi (ndahet me të tjerë)

## SHTOJCA: RAPORTET E VENDEVE TË VEÇANTA, SHTETE ANETARE TE BE

### Strukturat qendrore të prokurimeve publike dhe kapaciteti në shtetet anëtare të BE-së

#### 1. Austria

Austria ka një strukturë **gjysmë të centralizuar** të prokurimeve publike, por ende me një institucion drejtues në nivel federal. Ky është **Bundeskanzleramt-Verfassungsdienst (BKA-VD)**, Referat für Vergaberecht (Zyra Federale e Kancelarit - Shërbimi Kushtetues, Sektori për Ligjin e Prokurimeve), të cilit i janë dhënë shumë prej funksioneve të rëndësishme të prokurimit publik. Megjithatë, funksionet qendrore të blerjeve dhe të ato që lidhen me to si reklama, kryhen nga një organizatë tjetër. Shqyrtimi gjyqësor dhe kontrolli kryhen dhe këto nga institucione të tjera. Së fundi, kërkimi dhe trajnimi kryhen nga universitetet dhe ofrues të ndryshëm privatë.

Funksionet e **BKA-VD** përfshijnë hartimin e **legjislacionit** parësor e dytësor, formulimin e një politike federale për prokurimet dhe përgatitjen e udhëzimeve dhe të instruksioneve. Kjo zyrë këshillon qeverinë federale në lidhje me politikën e prokurimit publik dhe u jep këshilla ligjore e këshilla të tjera agjencive kontraktuese, shërbimeve publike, dhe tenderuesve. Megjithatë, “funksioni i ndihmës në tavolinë” është i kufizuar për shkak të stafit të vogël në numër prej katër nëpunësish civilë me kohë pune të plotë të cilët kanë diplomim juridik. BKA-VD është **pika e kontaktit për Komisionin**, është kontribuesi kombëtar për komisionet e këshillimit të BE-së, për UNCITRAL dhe GPA. Ajo merr pjesë në PPN dhe në rrjete të tjera ndërkombëtare. Gjatë **hartimit të legjislacionit** i dërgohet informacion me shkrim të gjithë aktorëve të interesuar dhe pastaj ai publikohet në internet. Procesi i konsultimeve është i hapur për komente nga çdokush përmes internetit. Përfaqësuesit e nivelit federal dhe të shteteve të Austrisë (Länder) takohen rregullisht përmes Bund-Länder Arbeitsgruppe (Grupi i Punës i Shteteve të Federuara) për të diskutuar çështjet legjislative të prokurimit publik.

**Bundesvergabeamt (BVA, ose Autoriteti Federal i Vlerësimit të Prokurimeve)** përgatit një **raport vjetor** për qeverinë mbi organizimin e prokurimeve publike përsa i përket sistemit të korregjimit, përmirësimit në nivelin federal. Të dhënat statistikore dhe të dhëna të tjera i grumbullon një person në Departamentin për Politikën e Tregtisë Shumëpalëshe në **Ministrinë Federale të Ekonomisë dhe Punës**. Për procedura më pak konkurruese nuk ekziston as një listë me parakushte dhe as një sistem lelesh. Një listë e zezë mbi punësimin e paligjshëm mbahet nga Seksioni qendror i të dhënave penale administrative në **Ministrinë Federale të Financave**. Megjithatë, funksioni më i rëndësishëm i BVA është ai i një **organi vlerësues** i vendimeve për prokurimet publike në nivel federal. Vendimet që vlerëson BVA i nënshtrohen apelimeve në Verwaltungsgerichtshof (Gjykatën Administrative).

Kompania publike **Bundesbeschaffung GmbH (BBG, Prokurimi Federal me përgjegjësi të Kufizuara)** është një **agjenci qendrore blerjesh** për 18 ministri dhe 450 ente të tjera (kompani publike, qeveri rajonale, bashki, universitete, institucione shëndetësore) me një buxhet të përgjithshëm blerjesh prej 661 milion eurosh në vitin 2005. Kjo kompani është themeluar në nivel federal në vitin 2001 me një ligj federal (BGB1 I 39/2001 dhe i amenduar nga BGB1 I 99/2002). Ajo raporton në **Ministrinë e Financave**. BBG-ë është e ngarkuar me prokurimet e të gjitha tipeve të mallrave dhe të shërbimeve, që nga materiali kancelarik e deri te teknologjia e informacionit, ushqimet dhe menaxhimi i mjediseve. Ajo lehtëson marrëveshjet kuadër, por jo koncesionet ose PPP-të. Në vitin 2004, BBG ndërtoi një procedurë për prokurimet elektronike dhe është duke shqyrtuar mundësinë e shtrirjes së saj. **Të ardhurat** e BBG-së janë pjesë e buxhetit të Ministrisë së Financave dhe ekzistojnë tarifa për shërbime të caktuara. Në vitin 2005, buxheti i BBG-së ishte 5 milion euro. BBG ka një staf prej 58 personash: një nëpunës civil dhe 57 punonjës. Ata punojnë si Drejtorë Ekzekutivë (2 persona) ose në Departamentin e Blerjeve (28 persona), në Departamentin Juridik (5 punonjës), në Departamentin e Kontrollit (2 punonjës), në Departamentin e Marketingut (2 punonjës), në Departamentin e Burimeve Njerëzore (1 punonjës), në Departamentin e Menaxhimit të Operacioneve (3 punonjës), në Departamentin e Kompetencës së Klientit (4 punonjës) dhe

në Departamentin e Prokurimeve Elektronike (5 punonjës). 5 personat që punojnë në Departamentin Juridik kanë ndjekur kolegje juridike dhe kanë diplomë universitare për juridik. Në Departamentin e Blerjeve stafi ka ose formim teknik, tregtar ose një diplomë tjetër universitare.

Në vitin 2005, u publikuan 5000 njoftime në **buletin kombëtar të prokurimeve publike Lieferanzeiger**. Sipas Ligjit Federal të Prokurimeve Publike të vitit 2002 (BVergG), publikimet janë të detyruara të kryhen në nivel federal. Në ligjin BVergG të vitit 2006 kjo nuk kërkohet. Ekzistojnë plane për ta bërë publikimin të detyruar në *Amtlicher Lieferanzeiger* ([www.lieferanzeiger.at](http://www.lieferanzeiger.at)) që në momentin që *Lieferanzeiger* të regjistrohet si një dërgues elektronik i Gazetës Zyrtare.

**Program zyrtar trajnimi** nuk ka. Institucionet private i mbulojnë trajnimet në bashkëpunim me universitetet. Qendra për Menaxhimin e Administratës (Zentrum für Veräaltungsmanagement) është duke hartuar një program të posaçëm trajnimesh për punonjësit publikë.

Për shkak të sistemit federal ka **10 organe të ndryshme vlerësimi**: një në nivel federal dhe nëntë në nivel të shteteve. Për autoritetet kontraktuese që shkelin rregullat e prokurimit publik nuk vendosen gjopa. Në disa nga shtetet e Austrisë nuk ekzistojnë përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis enteve kontraktuese dhe kontraktorëve. Gjykatat e auditimit në nivel federal dhe të shtetit janë të ngarkuara me **auditimin** e aktiviteteve të prokurimeve publike të enteve kontraktuese.

**Institucinet rajonale të prokurimit** përfshijnë zyrat shtetërore të prokurimeve publike, njësitë e prokurimeve publike në ministritë shtetërore, zyrat e prokurimit në qarqe dhe zyrat e prokurimeve publike të bashkive. Prokurimi publik është “kompetencë e natyrshme” e të gjitha autoriteteve vendore. Prandaj edhe funksionet e prokurimeve ekzistojnë në të gjitha nivelet e aktiviteteve shtetërore dhe kryhen nga nëpunësit civilë. Në bazë të ligjit BVergG të vitit 2006, autoritetet në nivel qarku dhe bashkie kanë të drejtë të krijojnë organe qendrore për blerjet. Përveç BBG, edhe entet prokuruese në nivel federal dhe në nivel të shtetit kanë punonjë pa ndonjë formim të veçantë. Në entet prokuruese të bashkive, punonjësit kanë arsim teknik dhe zakonisht nuk janë të diplomuar.

## 2. Bullgaria

Bullgaria ka një strukturë të **centralizuar** të prokurimeve publike me një institucion kyç në nivel qendror, Agjencinë e Prokurimeve Publike (PPA), e cila është pjesë e një departamenti të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Energjetikës. Kjo është një agjenci ekzekutive që u krijua mbi bazën e Ligjit të Prokurimeve Publike (PPL) në vitin 2004.

Funksionet e Agjencisë së Prokurimeve Publike (PPA) janë **këshillimi** i qeverisë për hartimin e politikës së prokurimit publik; hartimi dhe komentimi i **legjislacionit** parësor e dytësor, përfshirë projektet e marrëveshjeve ndërkombëtare; hartimi i procedurave dhe rutinës standard, hartimi i njoftimeve standarde dhe i formularëve të kontratave për kontratat e prokurimeve publike; përgatitja e udhëzimeve dhe e instruksioneve. Kjo agjenci boton Manualin e Prokurimeve Publike i cili përbëhet prej 1131 **udhëzimesh** ligjore mbi prokurimet publike. Për të dhënë **këshilla** ligjore dhe teknike ekziston një linjë e hapur telefonike. Ministri i Ekonomisë dhe Energjetikës ndihmohet nga Agjencia e Prokurimeve Publike për zbatimin e politikës kombëtare për prokurimet publike. Agjencia e Prokurimeve Publike është **pika e kontaktit** për Komisionin dhe kontributori kombëtar për komisionet këshillimore të BE-së. Ajo merr pjesë në PPN. Ajo përgatit një **raport vjetor** për qeverinë në të cilin përshkruhet funksionimi i sistemit të prokurimeve publike, bazuar në bazën e të dhënave të saj të prokurimeve publike (statistikore, por jo vetëm). Raporti vjetor dërgohet për të marrë miratimin e Këshillit të Ministrave dhe pastaj ai publikohet në uebsajtin e Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe në faqen e Gazetës së Shtetit pasi PPA e ka kontrolluar për përputhjen e tij me kërkesat e ligjit për prokurimet publike. Nuk ruhet asnjë version në letër. Në vitin 2005 u publikuan 24,700 njoftime për 8,396 procedura të prokurimeve publike. Prokurimi elektronik dhe njoftimi elektronik janë tani të disponueshme dhe kërkojnë përdorimin e firmës elektronike. Agjencia e Prokurimeve Publike publikon dhe shpërndan informacion për legjislacionin dhe politikën. Në vitin 2005, ajo publikoi një manual praktik të printuar dhe dymbëdhejtë udhëzues metodikë, katër udhëzues praktikë dhe pesë praktika gjyqësore në uebsajtin e saj. Ajo mban një **Regjistër të Prokurimeve Publike** i cili



publikon një informacion të tillë si vendimet për hapjen e procedurës për dhënien e kontaktave publike, njoftimet që duhen publikuar dhe informacione të tjera të kërkuara nga Rregullat për Zbatimin e Ligjit. Versioni elektronik i njoftimeve standarde publikohet edhe në Gazetën e Shtetit. Agjencia e Prokurimeve Publike organizon një **program kombëtar trajnimi** për sektorët e shërbimeve publike dhe tenderuesit. Në vitin 2005, ekspertët e Agjencisë së Prokurimeve Publike morën pjesë në 23 seminare. Seminaret u organizuan nga institucione të tjera për të shpjeguar zbatimin e legjislacionit mbi prokurimin publik. Ekspertët e Agjencisë së Prokurimeve Publike morën pjesë në 48 seminare kombëtare të specializuara dhe në pesë seminare ndërkombëtare. Agjencia e Prokurimeve Publike nuk mban një listë të specifikuar me parakushte, një listë të zezë ose një listë të nëpunësve të çertifikuar për prokurime. Lejet për procedura më pak konkurruese nuk parashikohen në ligj, por ekziston një detyrim për të shpjeguar shkakun për tipin e zgjedhur të procedurës së posaçme. Në uebsajtin e Agjencisë së Prokurimeve Publike ekziston një listë me individë të cilët mund të rekrutohen nga autoritetet kontraktuese si ekspertë të jashtëm. Lista është hartuar me ndihmën e shoqatave dhe të organizatave profesionale.

Agjencia e Prokurimeve Publike drejtohet nga një **Drejtor Ekzekutiv**, kontrata e të cilit, firmoset, amendohet dhe mbyllet nga Ministri i Ekonomisë dhe Energjetikës në bashkëpunim me Kryeministrin. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Prokurimeve Publike emëron **Sekretarin e Përgjithshëm** i cili drejton, koordinon dhe kontrollon funksionimin e agjencisë në përputhje me legjislacionin dytësor dhe kërkesat e caktuara nga Drejtori Ekzekutiv. Numri i përgjithshëm i **stafit** të Agjencisë është 38, dhe në të përfshihen si nëpunësit civilë ashtu edhe punonjësit (megjithëse është rritur në 53 në mars të vitit 2006). 34 anëtarë të stafit kanë diplomë masteri (19 në ekonomi, 9 në juridik dhe 6 në teknologji informacioni). Agjencia e Prokurimeve Publike ndahet në tre seksione kryesore: Drejtoria Financiare dhe Juridike (10 punonjës); Seksioni i Monitorimit, Analizës dhe Metodologjisë (12 punonjës) dhe Seksioni i Bazës Elektronike të të Dhënave (13 punonjës). Në vitin 2005, **buxheti** i Agjencisë ishte 286.000 euro. Buxheti hartohet nga vetë agjencia dhe pastaj dërgohet për miratim në Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjetikës.

Ligji i Prokurimeve Publike, i cili hyri në fuqi i amenduar në qershor të vitit 2006, krijoi **Komisionin për Mbrotjen e Konkurrencës** dhe një **Gjykatë Arbitrazhi**, e cila dëgjon dhe zgjidh mosmarrëveshjet për prokurimet publike. Deri në qershor të vitit 2006, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Prokurimeve Publike mund të fillonte një procedurë apelimi kundër një vendimi të autoritetit kontraktues i cili sipas tij shkelte dispozitat e ligjit, si edhe mund të anulonte kontratat që shkelnin ligjin. Megjithatë, Ligji aktual i prokurimeve publike zbatohet nga **Zyra Kombëtare e Auditimit** dhe nga **Agjencia e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike**.

Për të hartuar legjislacionin, Ministria e Ekonomisë dhe e Energjetikës ngre një **grup të brendshëm pune** me ekspertë ligjorë. Pasi ata e kanë hartuar projektligjin, fillon një proces koordinimi midis të gjitha institucioneve dhe organizatave. Komentet e tyre mund të çojnë pastaj në amendamente të projektligjit.

Fakti se e Agjencia e Prokurimeve Publike funksionon si një shtab i prokurimeve publike është konsideruar si **pika më e fortë** e organizatës qendrore të prokurimeve të Bullgarisë. Agjencia është duke punuar vazhdimisht për t'u zhvilluar dhe për të përmirësuar kapacitetin e saj administrativ.

### 3. Qipro

Qipro ka një strukturë të **centralizuar** të prokurimeve publike me një institucion kyç në nivel qendror, në veçanti përsa i përket politikave dhe legjislacionit, kontakteve me BE-në dhe kontakteve në nivel ndërkombëtar, dhe kontrollit dhe monitorimit. Praktikisht të gjitha këto funksione kryhen nga **Drejtoria e Prokurimeve Publike (PPD)**.

Drejtoria Prokurimeve Publike (PPD) është një drejtori brenda Thesarit të Republikës. Thesari është i pavarur nga Ministria dhe drejtohet nga Kontabilisti i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Presidenti dhe nuk mund të largohet nga detyra deri në moshën e pensionit. Thesari është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Financave, por nuk është pjesë e Ministrisë së Financave. PPD në tërësi këshillon qeverinë në lidhje me çështjet e prokurimit publik. Ajo nxjerr udhëzime në formën e qarkoreve (në vitin 2005 u nxorën katër të tilla). **Njësia për Politikën dhe Zhvillimin (PDU)** e PPD-së është përgjegjëse për hartimin e

legjislacionit parësor e dytësor, të dokumenteve standarde të tenderave, të dokumenteve standarde të kontratave, dhe për hartimin e udhëzimeve të përgjithshme për politikën e prokurimeve që duhet të hartohen nga çdo autoritet kontraktues. Ajo shërben si pikë kontakti për Komisionin, garanton kontributin kombëtar në komisionet këshillimore të BE-së, pjesëmarrjen në PPN dhe në përfaqësime të tjera ndërkombëtare. PDU aktualisht po strukturon dhe lehtëson futjen e prokurimit elektronik si edhe të marrëveshjeve kuadër në Qipro. Po ashtu, ajo ka përgjegjësinë të organizojë një program kombëtar trajnimesh për sektorin publik dhe sektorin e shërbimeve. Në vitin 2005 u organizuan dy kurse të cilat u ndoqën nga rreth 300 persona. PDU ka përfaqësuar Qipron në konferencat e nivelit të BE-së. **Njësia e Monitorimit dhe e Kontrollit (MCU)** e PPD ka përgjegjësinë të përgatisë udhëzime dhe instruksione, të ndihmojë dhe monitorojë autoritetet kontraktuese dhe të grumbullojë të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera. MCU monitoron edhe zbatimin korrekt të ligjit qipriot për prokurimet publike. Ai këshillon autoritetet kontraktuese kur kjo gjë kërkohet, si në rastin e vështirësive të hasura në lidhje me vendimin për formën e konkurrimit për të prokuruar (për shembull, përjashtimet nga ligji, zgjatjen e afatit përfundimtar, përdorimin e procedurave të përshpejtuara, etj.). Funkcioni i ndihmës në tavolinë kryhet nga MCU, e cila ofron mbështetjen e parë për autoritetet kontraktuese duke shpjeguar legjislacionin për prokurimin publik. Kontrolli *ex ante* i kontratave të prokurimeve publike ushtrohet për të gjitha kontratat që financohen me fonde të BE-së, por një kontroll i tillë nuk kryhet për kontratat e financuara me fonde të Qipros. PPD kryesohet nga Zëvendësi i Kontabilistit të Përgjithshëm, i cili është një ekspert kontabël profesionist. Ai ka punësuar 14 persona, përjashtuar punonjësit që kryejnë punë sekretarie.

**Sekretari i Komisionit Qendror për Devijimet dhe Pretendimet** mban një listë të zezë. Në vitin 2005, në këtë listë figuronin dy kompani. **Blerjet në nivel qendror** kryhen për 79 autoritete kontraktuese në nivelin e qeverisë qendrore, kryesisht nga Departamenti i Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, nga Departamenti i Punëve Publike, nga Departamenti i Shërbimeve Elektromekanike dhe Departamenti i Blerjeve dhe i Furnizimeve të Qeverisë. Një vlerësim i përafërt i tregut të blerjeve në nivel qendror është rreth 200 milion euro, ose 25% e tregut të prokurimeve të Qipros. Qiproja ka pasur një bord për blerjet në nivel qendror të vendosur në Thesarin e Republikës, por ky bord u shfuqizua nga ligji i ri që futi Direktivat e BE-së. Prirja aktuale është decentralizimi i vendimmarrjes dhe i dhënies së kontratave për të bërë të mundur që çdo autoritet kontraktues të përdorë përvojën e vet në fushat specifike të interesit. Kjo e nxit kapacitetin blerës të republikës dhe përshpejton procedurën duke rritur kështu elasticitetin e sektorit publik. Dy vjet pas decentralizimit të prokurimit publik do të shqyrtohen përfitimet e centralizimit të disa funksioneve që kërkojnë shkathtësi dhe specializim specifik. Autoritetet kontraktuese i komunikojnë vetë **njoftimet** e tyre për kontrata mbi kufirin monetar në Gazetën Zyrtare, rreth 300 të tilla në vitin 2005. Kontratat nën kufijtë monetarë nuk publikohen në Gazetën Zyrtare, por botohen në **Gazetën Zyrtare të Republikës** për sasi që e kalojnë 80000 euro, dhe nën këtë sasi nëse nuk janë përdorur procedurat e thjeshtuara nga autoritetet kontraktuese. **Zyra Juridike e Republikës** ofron këshillim ligjor dhe këshillim tjetër për entet kontraktuese, për shërbimet kontraktuese dhe tenderuesit.

Organi i vlerësimit të prokurimeve publike në kuptimin që i jep kësaj Neni 2 (8) i Direktivës 89/665/EEC është **Autoriteti i Vlerësimit të Tenderave**.

#### **4. Republika Çeke**

Republika Çeke ka një strukturë të **centralizuar** të prokurimeve publike të dominuar nga dy institucione: **Ministria për Zhvillimin Rajonal** dhe **Zyra për Mbrojtjen e Konkurrencës**. Nuk ka asnjë plan për ta ndryshuar këtë strukturë kryesore.

**Ministria për Zhvillimin Rajonal**, e cila është tërësisht një organ qeveritar, është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit parësor e dytësor dhe për zbatimin e rregulloreve. Pjesa e procesit legjislativ ka të bëjë me konsultimin, në rastin kur një projektligj i ri u dërgohet aktorëve për të marrë komente me shkrim. Ministria këshillon qeverinë në lidhje me politikën e prokurimeve publike dhe ka detyrën të grumbullojë të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera. Ajo mban një listë të furnizuesve të kualifikuar në të cilën në vitin 2005 ishin regjistruar 807 kompani. Ekziston edhe një sistem kombëtar i kualifikimit dhe klasifikimit të kontraktorëve në fushën e kontratave të punës. Ministria përgatit një udhëzues të plotë dhe përdor një listë

të trajnerëve të kualifikuar për trajnime në fushën e prokurimit, të clët janë vlerësuar nga ministria. Ajo administron gjithashtu edhe një sistem informacioni për dhënien e kontratave publike; 7242 kontrata të tilla u publikuan në vitin 2005. Të 1600 njoftimet çeke të publikuara në Gazetën Zyrtare në vitin 2005 u komunikuan nga vetë entet kontraktuese. Në vitin 2005, Ministria lehtësoi procesin për rreth katër koncesione.

**Zyra për Mbrojtjen e Konkurrencës** është përgjegjëse për përgatitjen e një raporti vjetor për qeverinë në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimit publik (shih [www.compet.cz](http://www.compet.cz), për versionin anglisht të vitit 2005). Kjo zyrë shërben edhe si organ i vlerësimit të prokurimeve publike në kuptimin që i jep kësaj Neni 2 (8) i Direktivës 89/665/EEC. Prej 105 ankesave të bëra në zyrë, 10 u apeluan në Gjykatën e Lartë Administrative. **Baza ligjore** e zyrës mbështetet në:

- Kushtetutë;
- Ligjin e Parlamentit Nr. 2/1969 të Koleksionit të Ligjeve, i cili është një ligj i përgjithshëm për strukturën e ministrive dhe të organeve të tjera të administratës qendrore;
- Ligjin Nr. 273/1996 të Koleksionit (që merret me kompetencat e Zyrës për Mbrojtjen e Konkurrencës, veçanërisht në fushën e prokurimeve publike);
- Ligjin Nr. 40/2004 të Koleksionit (nga 1 korriku 2006 Ligji Nr. 137/2006 mbi Kontratat Publike dhe Ligji Nr. 139/2006 mbi Koncesionet), i cili rregullon mbikëqyrjen e Zyrës për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Zyra është një **organ i pavarur** që kontrollohet nga parlamenti. Ajo kryesohet nga një **kryetar** i cili emërohet nga presidenti me propozim të qeverisë, për një afat kohor gjashtëvjeçar në detyrë. Ai nuk mund të jetë anëtar i ndonjë partie politike. Zyra ndahet në tre seksione: Seksioni Antitrust, Seksioni i Prokurimeve Publike dhe Seksioni i Ndihmës Shtetërore. Seksioni i Prokurimeve Publike kryesohet nga një drejtor i cili merr vendimet në shkallë të parë. Drejtorët e seksioneve emërohen nga kryetari. Pas vendimeve në shkallë të parë ekziston një **komision apelimi** (bord apelimi) që përbëhet nga punonjës të zyrës dhe specialistë të jashtëm, i cili merr vendime të cilat firmosen nga kryetari i komisionit. Departamenti Juridik ka një staf prej gjashtë personash, **seksioni i prokurimeve publike** ka rreth 30 punonjës, komisioni i apelimit ka rreth gjashtë punonjës dhe rreth 20 specialistë të jashtëm, departamenti i financës ka gjithsej 10 punonjës dhe zyra e departamentit të integritetit evropian dhe marrëdhënieve ndërkombëtare ka rreth 10 punonjës. Shumica e punonjësve kanë **arsim** universitar, në drejtësi ose në ekonomik. Ata marrin pjesë në seminare që organizohen nga zyra ose nga ministria, ose në seminare të posaçme që ofrohen nga institucione të tjera (për shembull nga agjenci private arsimore, etj.), në projekte binjakëzimi, në takime dhe konferenca ndërkombëtare. Kryetari i zyrës ose një zyrtar i departamentit të integritetit evropian dhe marrëdhënieve ndërkombëtare përfaqëson Republikën Çeke në komisionet këshillimore të BE-së, në PPN, dhe në konferenca të tjera ndërkombëtare. Zyra financohet nga buxheti i qeverisë. Sipas Ligjit Nr. 40/2004 të Koleksionit, çdokush që bën një propozim duhet të paguajë një tarifë prej 1% të çmimit të tenderit, si edhe një tarifë administrative prej rreth 1000 eurosh. Megjithatë, kjo pagesë administrative është hequr nga Ligji 13/2006, i cili hyri në fuqi në 1 korrik 2006. Nëse organi mbikëqyrës vërteton, pas përfundimit të një marrëveshjeje, që një ent kontraktues nuk ka arritur të plotësojë detyrimet ose ka shkelur një nen të ligjit të mësipërm me një veprim të kryer gjatë kohës që ka qenë i kontraktuar, dhe nëse, një veprim i tillë ndikon shumë ose mund të ndikojë në formimin e një renditjeje të tenderuesve sipas rangut, atëherë organi mbikëqyrës ka të drejtë, pas një vendimi me shkrim të marrë me procedurë të përbashkët, të imponojë një ndërprerje të kryerjes së kontratës dhe të caktojë një gjobë për entin kontraktues. Sasia e gjobës varet nga shkelja, por ajo mund të jetë deri në 5% të vlerës së kontratës, deri në një maksimum prej 10 milion CZK (rreth 333.333 euro).

Disa funksione kryhen edhe nga Ministria, edhe nga zyra. Këto janë: përgatitja e udhëzimeve dhe instruksioneve, dhënia përgjigje për pyetjet e drejtuara nga autoritetet kontraktuese dhe organizimi i kurseve në lidhje me prokurimin publik. Në vitin 2005, dy kurse u ofruan nga zyra (me rreth 120

pjesëmarrës secili) dhe rreth 5 kurse u ofruan nga ministria (me 80-100 pjesëmarrës secili). Të dyja organet marrin pjesë në konferenca akademike kombëtare e ndërkombëtare, në seminare ndërkombëtare dhe në projekte binjakëzimi.

Aktualisht nuk ka një organ qendror për blerjet, por ky mendohet të ngrihet që nga 1 korriku i vitit 2006.

## 5. Estonia

Estonia ka një strukturë të **centralizuar** të prokurimeve publike të dominuar kryesisht nga dy organizata: Zyra e Prokurimeve Publike (PPO) dhe Ministria e Financave. PPO varet nga kjo ministri.

**Ministria e Financave** është përgjegjëse për hartimin e **legjislacionit** parësor e dytësor; për përgatitjen e udhëzimeve dhe të instruksioneve. Ajo vepron si **pikë kontakti** për Komisionin; është përgjegjëse për kontributin kombëtar në **komisionet këshillimore** të BE-së, në PPN dhe në përfaqësime të tjera ndërkombëtare dhe për përgatitjen e **udhëzimeve**. Në vitin 2005, ajo përgatiti një libër të vetëm me udhëzime të përgjithshme. Hartimi i legjislacionit përfshin konsultimet përmes grupeve të posaçme të punës të formuara nga përfaqësues të aktorëve të ndryshëm. Përgjegjësitë e ministrisë janë parashikuar në Ligjin e Qeverisë për Republikën. **Njësia e Ndhmës Shtetërore dhe e Prokurimeve Publike e Departamentit të Qeverisjes Publike në Ministrinë e Financave** (katër nëpunës civilë që merren posaçërisht me prokurimet) është përgjegjëse për legjislacionin dhe politikën, për realizimin e funksionit të kontaktit me ndërkombëtarët dhe me BE-në si edhe për zhvillimin e kapaciteteve.

**Zyra e Prokurimeve Publike (PPO)** është përgjegjëse për përgatitjen e **raportit vjetor** për qeverinë në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimeve publike; për **grumbullimin e të dhënave statistikore dhe të të dhënave të tjera**; për dhënien e **lejes** për procedura më pak konkurruese; për përdorimin e procedurave përjashtimore dhe të atyre të përshpejtuara, etj.; për administrimin e **buletinit** kombëtar të prokurimeve publike, përfshirë edhe publikimin dhe kontrollin nëse njoftimet janë në përputhje me kërkesat. Ky buletin ka publikuar 7539 kontrata në vitin 2005. PPO kujdeset edhe për komunikimin e njoftimeve të enteve kontraktuese dhe të enteve të shërbimeve në **Gazetën Zyrtare**. Në vitin 2005, u komunikuan afërsisht 300 njoftime në Gazetën Zyrtare. PPO ofron **këshillim** ligjor dhe këshillimi tjetër për entet kontraktuese dhe shërbimet, ndërsa për këshillimi ligjor për tenderuesit ofrohet nga firma ligjore dhe firma konsulente. **Kontrolli ex ante** i kontratave të prokurimeve publike është një funksion tjetër. Në vitin 2005, këtij kontrolli iu nënshtruan 10 kontrata të tilla. PPO mund të **gjobisë** autoritetet kontraktuese që shkelin rregullat e prokurimeve publike. Në vitin 2005, u shqyrtuan 18 raste të tilla dhe 12 prej tyre u gjobitën. PPO ka ndihmuar në zgjidhjen e 281 **mosmarrëveshjeve** midis enteve kontraktuese dhe kontraktorëve në vitin 2005. **Kontrolli ex post** i enteve kontraktuese në lidhje me aktivitetet e tyre të prokurimeve publike është gjithashtu një funksion i PPO-së. Në vitin 2005 u vlerësuan 78 autoritete kontraktuese.

Përgjegjësitë e PPO-së rregullohen me Ligjin e Prokurimeve Publike dhe Statutin e PPO-së, i cili është një dekret i Ministrisë së Financave. PPO është e pavarur në vendimet e saj, por është në varësi të Ministrisë së Financave dhe për këtë shkak është pjesërisht e varur prej saj në disa aspekte administrative. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës së Prokurimeve Publike firmos vendimet për ankesat dhe organizon punën e zyrës. Ai/ajo emërohet nga Ministri i Financave. Departamenti i Mbikëqyrjes (11 punonjës) kryen funksionin e zbatimit dhe të korrigjimit si edhe funksionin e kontrollit dhe të monitorimit. Departamenti i Arkivës (7 punonjës) është i ngarkuar me publikimet dhe informimin. Staf i PPO-së përbëhet prej nëpunës civilë me diplomë universitare, me përjashtim të stafit sekretarial. Ata të gjithë e njohin ligjin e prokurimeve publike. Buxheti vjetor i PPO-së është afërsisht 7.5 milion EEK (0.5 milion euro). Ai është pjesë e buxhetit të përgjithshëm të shtetit. Ekzistenca e një organi qendror të mbikëqyrjes, vlerësimit, monitorimit dhe informimit që përqendron informacionin dhe përvojën shihet si pika më e fortë e organizatës së prokurimeve publike të Estonisë.

Disa prej detyrave janë **përgjegjësi të përbashkëta** të Ministrisë së Financave dhe të PPO-së. Këto përfshijnë **politikën** kombëtare të prokurimeve, publikimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi

legjislacionin dhe politikat, këshillimin e qeverisë për politikat e prokurimeve publike dhe organizimin e një programi kombëtar trajnimesh për sektorët publikë, të shërbimeve dhe për tenderuesit.

PPO dhe Zyra e Prokurorit kanë detyrën e përbashkët të nisjes së procedimit për shqyrtimin gjyqësor në gjykata të rasteve që përbëjnë shkelje të ligjit të prokurimit publik. Megjithatë, Zyra e Prokurorit është e vetmja përgjegjëse për dërgimin në prokurori të rasteve të korrupsionit dhe të veprave të tjera penale në fushën e prokurimeve publike. Kontributi kombëtar në UNCITRAL dhe në GPA është gjithashtu përgjegjësi e përbashkët e Ministrisë së Financave dhe e **Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministria e Ekonomisë dhe e Komunikimit** administron një listë të të kualifikuarve. Në vitin 2005, një listë e tillë përmbante rreth 20 kompani të regjistruara.

Organet e vlerësimit të prokurimeve publike sipas kuptimit të Nenit 2 (8) të Direktivës 89/665/EEC janë **PPO** dhe në shkallë të fundit gjykatat. Ekziston një **plan për ta hequr funksionin e vlerësimit** nga PPO duke emëruar një organ të posaçëm shqyrtimi i cili do të kishte të përbashkët me PPO-në vetëm stafin teknik mbështetës.

Në Estoni nuk ka një organ qendror për blerjet.

## 6. Finlanda

Finlanda ka një strukturë të **decentralizuar** të prokurimeve publike ku përfshihen shumë aktorë. Ministria e Financave dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (Departamenti i Tregtisë) janë operatorët kryesorë administrativë për shumicën e çështjeve të prokurimeve publike në nivel kombëtar. Tregu i prokurimeve publike i Finlandës zë rreth 15% të PPB (rreth 22 miliard euro).

**Departamenti i Buxhetit i Ministrisë së Financave** ka përgjegjësinë e drejtimit të përgjithshëm, e cila përfshin hartimin dhe nxjerrjen e politikave të prokurimit. Hartimi i dokumenteve të kontratave standarde është gjithashtu përgjegjësi e kësaj ministrie (më parë kjo bëhej nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë). Drejtimi ka të bëjë edhe me ndërtimin e proceseve dhe të rutinave prokuroese, të tilla si prokurimi dhe blerjet qendrore në bazë të legjislacionit parësor e dytësor. Ndërtimi i procedurave dhe rutinave të prokurimit publik është pjesë e Programit për Produktivitetin e Qeverisë së Shtetit, program i cili është filluar nga Këshilli i Shtetit në fund të vitit 2003 (Ministria e Financave koordinon dhe udhëheq këtë program). Objektivi i këtij programi është rritja e përgjithshme e produktivitetit të qeverisë së shtetit të Finlandës. Ministria e Financave i ka deleguar disa nga përgjegjësitë e saj zhvillimore Thesarit të Shtetit, veçanërisht për administrimin e financave dhe të personelit. Brenda Ministrisë së Financave, drejtimi dhe zhvillimi janë përgjegjësi si të Departamentit të Buxhetit (një ose dy persona), ashtu edhe të Departamentit të Menaxhimit Publik (dy ose tre persona). Ministria e Financave përgatit dokumente me udhëzime të përgjithshme dhe dokumente me modele të prokurimeve si edhe kushtet e përgjithshme të kontratave për qeverinë.

Legjislacioni parësor e dytësor, si edhe dokumentet standarde të tenderave hartohen nga **Departamenti i Tregtisë i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë**, i cili është gjithashtu përgjegjës për kontributin kombëtar në komisionet këshillimore të BE-së, në UNCITRAL dhe në GPA. Të dhënat statistikore dhe të dhëna të tjera grumbullohen nga 3-4 nëpunës civilë që punojnë në Departamentin e Tregtisë/në Drejtorinë e Tregut të Brendshëm të kësaj ministrie. Të dyja ministritë marrin pjesë në PPN. Në vitin 2005/2006 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë hartoi **bashkë me Edita Plc**, një shërbim të ri për njoftimin për prokurimet në internet ([www.hankintailmoitukset.fi](http://www.hankintailmoitukset.fi)) për prokurimet nën dhe mbi kufirin monetar të BE-së. Aplikimet e tij të para u bënë në gjysmën e parë të vitit 2006, por disa tipare janë ende në zhvillim. Disa zyra të mëdha (për shembull, Forcat e Mbrojtjes së Finlandës) po përdorin prokurimin elektronik i cili është ndërtuar përshtat nevojave të tyre. (vini re: prokurimi qendror elektronik në Finlandë-tenderimi dhe kryerja e porosive-është duke u shqyrtuar, por vendimet për përdorimin e këtyre sistemeve gjerësisht nuk janë marrë ende).

**Ministria e Punëve të Jashtme** është pika e kontaktit me Komisionin. **Ministritë e tjera** dhe zyrat/agjencitë e tjera të larta të shtetit (të tilla si Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Mbrojtjes Finlandeze,

Ministria e Brendshme, Autoriteti Finlandez i Rrugëve) formulojnë dhe zbatojnë politikat e tyre të prokurimeve, si edhe procedurat dhe rutinat për prokurimin e mallrave, shërbimeve apo punëve të tyre.

**Bordi Qeveritar i Prokurimeve**, i emëruar nga Ministria e Financave, është i ngarkuar me disa projekte për hartimin e prokurimeve publike (procedura, dokumente standarde dhe prokurimin elektronik). Ai ka nxjerrë edhe *Strategjinë e Qeverisë për Prokurimet për vitin 2004*. Ky bord përbëhet nga anëtarë nga disa ministri dhe zyra të shtetit. Ministrinë janë përgjegjëse për të parë nëse strategjia është marrë parasysh në strategjitë e tyre të prokurimeve dhe nëse është zbatuar në fushën e tyre të administrimit. Ministria e Financave dhe Bordi i Qeverisë për Prokurimet kanë përgatitur së bashku disa udhëzime të përgjithshme (si manuali i përgjithshëm i prokurimeve), por përgjegjësia më e madhe për përgatitjen e udhëzimeve dhe të instruksioneve të prokurimit është e Ministrisë ose zyrës/agjencisë në fjalë.

**Njësia Këshilluese e Prokurimeve Publike** është një projekt i përbashkët i pavarur i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe i Shoqatës së Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Finlandës. Ajo e filloi veprimtarinë e saj në vitin 2004 dhe u shërben autoriteteve të bashkive dhe atyre të shtetit, njësive të tjera të prokurimeve publike, ndërmarrjeve dhe sipërmarrësve. Ajo u jep atyre **këshillim** falas në lidhje me ligjin mbi prokurimin publik, zbatimin e tij, praktikën e mira në prokurim dhe rëndësinë e drejtimit strategjik për ofrimin dhe marrjen e shërbimeve.

**Oranizatrat komerciale të trajnimeve**, sidomos HAUS Ltd. e cila kontrollohet nga qeveria (60% është në pronësi të shtetit) ofrojnë kurse trajnimi të zgjedhura për publikun, sektorët e shërbimeve dhe tenderuesit. HAUS Ltd. ([www.haus.fi](http://www.haus.fi)) varet nga Ministria e Financave dhe përdoret gjerësisht nga sektori publik. Për shembull, në vitin 2005, HAUS Ltd. organizoi rreth 20 kurse trajnimi (që kanë zgjatur nga një deri në dy ditë) në lidhje me prokurimet publike. Bashkitë e Finlandës kanë një kompani të ngjashme trajnimesh që quhet Efeko Ltd., [www.feko.fi](http://www.feko.fi).

Projektet që kanë të bëjnë me politikat dhe që kanë një rëndësi më të gjerë e të përgjithshme përgatiten në **komisionet** të cilat përbëhen nga përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të qeverisë, të partive politike dhe të grupeve të tjera të interesit. Këto grupe interesi ftohen gjithashtu të komentojnë për projektligjet.

Struktura e prokurimeve publike e Finlandës është në thelb e decentralizuar dhe kjo për shkak të natyrës së pavarur të **bashkive** të saj. Tregu lokal i prokurimeve publike vlen rreth 10 miliard euro në vit. Shoqata e Autoriteteve Vendore dhe Rajonale e Finlandës bashkëpunon ngushtë me bashkitë e saj për shumë çështje të rëndësishme të prokurimeve publike. Për shembull, ajo ofron shërbimin e ndihmës në tavolinë për çështje ligjore dhe ka **publikuar** disa manuale dhe udhëzues për prokurimet publike dhe dokumente për politikat e bashkive.

**Organi i vlerësimit** të prokurimeve publike në kuptim të Nenit 2 (8) të Direktivës 89/665/EEC është **Gjykata e Tregut**. Në vitin 2005, u përballuan afërsisht 250 raste prokurimesh publike nga kjo gjykatë. Në 10% të rasteve, gjykata mori në konsideratë dhënien një kompensimi të pagueshëm dhe vendosi për 5% të rasteve (rreth 15). Gjykata e Tregut dëgjoi 508 ankesa kundër vendimeve për prokurime publike.

Aktivitetet e prokurimeve publike auditohen çdo vit si pjesë e auditimeve financiare dhe auditimeve të tipit VFM të kryera nga **Zyra e Auditimit e Shtetit**. Në vitin 2005, Zyra e Auditimit të Shtetit kreu 115 auditime financiare dhe 25 auditime VFM. Në auditimin financiar, aktivitetet e prokurimeve publike të enteve kontraktuese të audituara përbënin rreth 30% të auditimeve të kryera. Rreth 10 raporte të auditimeve VFM vlerësuan aktivitetet e prokurimeve publike të enteve të veçanta kontraktuese. Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë dhe Zyra e Auditimit e Shtetit përgatisin një **raport vjetor** për qeverinë në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimit publik.

Shteti i Finlandës ka një **Njësi Qendrore të Prokurimeve** (Hansel Ltd., shih [www.hansel.fi](http://www.hansel.fi)). Hansel është një kompani jofitimprurëse në pronësi shtetërore dhe vepron si një organ qendror blerjesh që harton marrëveshjet kuadër për prokurimin e produkteve dhe të shërbimeve. Këto marrëveshje kuadër mund të përdoren nga autoritetet e prokurimeve publike, të tilla si ministrinë dhe zyrat e ministrive si edhe nga agjencitë shtetërore dhe ndërmarrjet në pronësi publike. Hansel administron edhe ato **marrëveshje kuadër**

të cilat i ka përfunduar dhe ua shet ato klientëve të sektorit publik. Aktualisht, Hansel Ltd. ka të punësuar rreth 50 persona. Ajo vepron tërësisht si një njësi e qeverisjes qendrore të prokurimit dhe nuk prokuron për bashkitë. Hansel është pjesë e krahut administrativ në varësi të Ministrisë së Financave. Ajo ofron shërbime për 13 ministri, 117 zyra të llogarive të shtetit (me rreth 1000 departamente/njësi kontraktuese), për 10-20 agjenci dhe kompani në pronësi të shtetit. Në vitin 2005, prokurimet publike që u kryen përmes marrëveshjeve kuadër të Hansel vlenin 211 milion euro (në vitin 2004 ato vlenin 154 milion euro). Në vitin 2005, Hansel Ltd. kishte aktive 53 marrëveshje kuadër. Disa ministri veprojnë mbi bazën e marrëveshjeve të veçanta kuadër.

Ministria e Transportit dhe e Komunikacioneve kanë lehtësuar nja dy **PPP**. Në Finlandë, PPP-të janë përdorur vetëm (të paktën në qeverisjen qendrore) për projekte të mëdha të ndërtimit të rrugëve.

## 7. Franca

Franca ka një strukturë **gjysmë të centralizuar** të prokurimeve publike, por me një institucion në nivel qendror - Departamentin e Prokurimeve Publike të Drejtorisë për Çështjet Juridike (DAJ- Direction des Affaires Juridiques). Kjo drejtori vepron në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Financave dhe të Industrisë. Disa funksione të saj kryhen nga institucione të tjera, sidomos funksionet e shqyrtimit gjyqësor dhe të blerjeve qendrore.

Departamenti i Prokurimeve Publike është përgjegjës për hartimin e legjislacionit parësor e dytësor, për dokumentet standarde të tenderave (në mënyrë të kufizuar), dhe për dokumentet standarde të kontratave (në mënyrë të kufizuar). Ai merret gjithashtu edhe me formulimin e politikave të prokurimit dhe përgatitjen e udhëzimeve dhe instruksioneve. Ministri ose institucione të tjera mund të hartojnë dokumente për përdorim vetjak ose për kontratat me çdo ent që janë brenda fushës së veprimit të aktiviteteve të tyre. Për shembull, Ministria e Kulturës nxorri një model kontrate për shërbimet arkitekturore. Përsa i përket konsultimeve, zakonisht DAJ-i përgatit një projekt të parë të vendimit, i cili pastaj u dërgohet administratave të tjera të përfshira në prokurim (Ministrisë së Brendshme, të Mbrojtjes, të Shëndetësisë, të Punëve Publike) dhe e publikon atë edhe në faqen e internetit për konsultim publik. Pastaj, ai përgatit një projekt të ndryshuar duke marrë parasysh, kur e sheh të mundshme, komentet që ka marrë. Pasi miratohet në qeveri, ky draft i dërgohet Këshillit të Shtetit, i cili mund të propozojë amendamente. Qeveria nuk është e detyruar të zbatojë mendimin e Këshillit të Shtetit, por ajo zakonisht e merr parasysh mendimin e tij. DAJ-i është **pika e kontaktit** për Komisionin, organizon kontributin kombëtar për komisionet këshillimore të BE-së, UNCITRAL dhe të GPA, dhe merr pjesë në PPN. Një detyrë tjetër e DAJ-it është **këshillimi** i qeverisë për politikën e prokurimeve publike. Në këtë drejtim, ai ofron këshilla ligjore dhe këshilla të tjera për autoritetet kontraktuese dhe për ofruesit e shërbimeve. Këshillimin dhe informacionin për çdo ent e ofron një “qelizë informacioni” e lidhur me Drejtorinë për Llogaritë Publike (brenda Ministrisë së Ekonomisë, Financës dhe Industrisë). Një nga pikat e forta të sistemit të prokurimeve qendrore të Francës është se çdo punonjës publik i ngarkuar me hartimin ose dhënien e një kontrate publike mund të marrë informacion me lehtësi nga DAJ-i ose qeliza e informacionit mbi legjislacionin për prokurimin publik. DAJ-i nuk organizon aktivitete trajnimi dhe as aktivitete kërkimore të vazhdueshme, por mund të organizojë seminare nëse ndryshohet kodi për prokurimet publike.

DAJ-i u krijua në vitin 1998 me anë të një **dekreti të Kryeministrit**. Sipas Kushtetutës, rregullat që duhet të zbatohen administratat shtetërore mund të hyjnë në fuqi përmes një dekreti. Qeveria ka fuqinë që me një “dekret-ligj” të detyrojë (pa pasur nevojë të pyesë parlamentin për miratimin e një ligji) autoritetet vendore të zbatojnë të njëjtat rregulla dhe procedura si edhe shteti. **Drejtori i DAJ-it** emërohet me vendim të ministrit dhe i raporton ministrit. DAJ-i përfshin katër nëndrejtori: prokurimin publik, të drejtën private, të drejtën publike dhe ndërkombëtare, të drejtën ekonomike dhe zhvillimin. Vetëm nëndrejtorja e parë merret me çështjet e prokurimeve publike dhe përfshin **tri njësi**: legjislacionin e përgjithshëm dhe çështjet ndërkombëtare, këshillimin e blerësve publike dhe çështjet teknike dhe ato që i takojnë së ardhmes. Buxheti i tij vjetor është rreth 3.6 milion euro dhe ky buxhet është pjesë e buxhetit të përgjithshëm të qeverisë ose të ministrisë. Për vitin 2006, buxheti do të përcaktohet mbi bazën e një programi objektivash. Komisioni Shtetëror i Kontratave Publike është i lidhur edhe me DAJ-in. Rreth 40 persona punojnë për

drejtorinë e prokurimeve publike dhe 18 për Komisionin Shtetëror. 30 **nëpunës civilë** në nëndrejtorinë e prokurimeve në DAJ kanë diplomë universitare.

Në nëntor të vitit 2005 u formua një organ **mbikëqyrës i prokurimeve publike** (Observatoire économique des marchés publics). Ky do të punojë duke bashkëpunuar ngushtësisht me DAJ-in. Misioni për mbështetjen e kontratave PPP (kontratat e partneritetit sektor public-sektor privat) u ngrit në vitin 2004. Aty nga fundi i vitit 2005, 40 projekte ishin nën shqyrtim. Njoftimet e kontratave mund të dërgohen në Gazetwn Zyrtare nëpërmjet enteve kontraktuese ose drejtpërdrejt ose përmes Buletinit zyrtar të Njoftimeve të tregjeve publike (*Bulletin officiel des Annonces de marchés publics*). Në vitin 2004, në Gazetwn Zyrtare u publikuan 38.921 njoftime për tendera. Disa ente publike ose private organizojnë **kurse** për legjislacionin për prokurimet publike ose për aspekte edhe më praktike. Bashkitë dhe në përgjithësi të gjitha organet që qeverisen nga e drejta publike mund të grupohen bashkë me qëllim që të japin kontrata ose marrëveshje kuadër.

Franca ka vetëm një organ qendror blerjesh (UGAP: Union des Groupements d'achat publics), i cili mund t'i ofrojë mallra çdo autoriteti publik. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe disa qindra grupime në nivel vendor të cilat kryejnë aktivitete të ngjashme. Në vitin 2004, të ardhurat e UGAP-it ishin 668 milion euro, dhe ai kishte 33.000 klientë të cilët përfshinin 8500 bashki (me më pak se 5000 banorë) dhe 6300 shkolla të mesme.

Vendimet e prokurimeve publike shqyrtohen e vlerësohen përmes sistemit të gjykatave.

## 8. Gjermania

Gjermania ka një strukturë **gjysmë të centralizuar** të prokurimeve publike, por me një institucion prokurimi në nivel federal, i cili është Ministria Federale e Ekonomisë dhe e Teknologjisë (Bundesministerium für Wirtschaft und Technologie ose **BMW**i). Kjo ministri bashkëpunon me organe të tjera për kryerjen e disa funksioneve.

BMW*i* harton **legjislacionin** parësor dhe formulon politikën federale të prokurimeve. Kjo është njëherësh edhe pika e kontaktit për Komisionin dhe është përgjegjëse për kontributin kombëtar në komisionet këshillimore të BE-së dhe pjesëmarrjen në PPN, kontributin kombëtar në UNCITRAL, në GPA dhe për **përfaqësimet e tjera ndërkombëtare**. Ajo publikon dhe shpërndan **informacion** për legjislacionin dhe politikën; këshillon qeverinë federale në lidhje me **politikën** e prokurimeve publike; dhe grumbullon të dhënat statistikore dhe të **dhëna** të tjera, veçanërisht për procedurat e rishqyrtimeve/vlerësimeve.

Hartimi i legjislacionit dytësor kryhet nga BMW*i* në bashkëpunim me **Komisionet e Prokurimeve Publike** (Verdingungsausschüsse), të cilat përbëhen nga përfaqësues të ministrive federale dhe të ministrive të shteteve si edhe nga përfaqësues të bashkive dhe organizatavë të biznesit. Qëllimi i kësaj procedure që është vetëm në Gjermani, të praktikuar që në vitet 1930, është të marrë parasysh mendimin e aktorëve të ndryshëm dhe të arrijë një ekuilibër midis interesit publik dhe interesave të sektorit privat. Megjithatë, disa pretendojnë se kjo procedurë favorizon interesat e sektorit privat dhe dëmton interesat e sektorit publik. Procesi i konsultimit në përgjithësi është i organizuar si një procedurë me shkrim, e cila plotësohet edhe me seancë dëgjimore, nëse kjo është e nevojshme. Procesi hapet me shpërndarjen e projektit në shtetet federale, në bashki dhe në organizatat e biznesit. Kjo u jep atyre shansin të plotësojnë dhe dërgojnë një deklaratë me shkrim. Pas kësaj mund të organizohet edhe një seancë dëgjimore për motive sqarimi.

Procedurat dhe rutinat standarde hartohen nga BMW*i* në bashkëpunim me Ministrinë Federale të Transportit, Ndërtimit dhe Çështjeve Urbane (Bundesministerium für Verkehr, Bau und Stadtentwicklung ose **BMVBS**); Agjencinë Federale Qeveritare të Koordinimit dhe Këshillimit (Koordinierungs und Beratungsstelle der Bundesregierung für Informationstechnik in der Bundesverwaltung); dhe Zyrën e Prokurimit të Ministrisë Federale të Punëve të Brendshme (Beschaffungsamt des Bundesministerium des Innern, ose BeschA). Hartimi i dokumenteve standarde të tenderave dhe i dokumenteve standarde të kontratave është detyrë e BMW*i*, BMVBS, KBSt dhe BeschA, ndërsa udhëzimet dhe instruksionet



përgatiten nga BMWi, BMVBS dhe BeschA. Këshillat ligjore dhe këshilla të tjera për entet kontraktuese, shërbimet dhe tenderuesit ofrohen nga BMWi; ministritë e shteteve federale; dhe nga agjencitë e përbashkëta të tenderimit dhe këshillimit (Auftragsberatungsstellen) të Dhomave të Industrisë dhe Tregtisë dhe të Dhomave të Artizanatit. Përfaqësuesit e BMWi dhe të Ministrisë Federale të Punëve të Brendshme (Bundesministerium des Innern, ose BMI), përfshirë edhe zyrat në varësi të tyre, marrin pjesë në ngjarjet akademike kombëtare e ndërkombëtare si edhe në veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me ligjin mbi prokurimin publik, me ekonominë dhe politikat.

**Çdo ent kontraktues** vendos vetë mbi përdorimin e procedurave më pak konkurruese, mbi përdorimin e përjashtimeve, të zgjatjeve të afateve kohore ose të përdorimit të procedurave të përshtajtura, etj. Megjithatë, ekziston edhe mbikëqyrja e shtetit për ligjshmërinë ose e përshtatshmërinë e akteve administrative, përmes nivelit përkatës të administratës së lartë.

**Listat e të kualifikuarve** administrohen për kontratat e punëve publike nga ana e Verein für die Präqualifikation von Bauunternehmen, e cila është një shoqatë e enteve kontraktuese, e tenderuesve dhe e organizatave të biznesit për parakualifikimin e kompanive të ndërtimit. Aktualisht, ekzistojnë 33 kompani në këtë listë. Kjo listë ka filluar të mbahet në vitin 2006.

Legjislacioni federal për **listën e zezë** është në shqyrtim e sipër. Ai ekziston në nivel të shtetit në shtetin federal të Northrhine-Westphalia dhe në shumë ministri federale dhe në ministri në nivel të shtetit ekzistojnë lista të zeza në bazë të akteve nënligjore (udhëzime).

Në nivel federal, **blerjet qendrore** kryhen nga BeschA; Zyra Federale për Teknologjinë dhe Prokurimet Ushtarake (Bundesamt für Wehrtechnik und Beschaffung); dhe Zyra e Prokurimit e Administratës Federale të Doganave (Beschaffungsamt der Bundeszollverwaltung). Në nivel më të ulët se niveli kombëtar ekzistojnë disa forma të blerjeve qendrore.

**Bundesverwaltungsamt** administron buletin kombëtar elektronik të prokurimeve publike ([www.bund.de](http://www.bund.de)), i cili bëri publike 4285 kontrata në vitin 2005. Për entet kontraktuese ekziston edhe një numër i madh mundësish shtesë publikimi në nivel kombëtar dhe nënkombëtar. Një shembull i kësaj është Deutsches Ausschreibungsblatt, që dikur quhej “Bundesausschreibungsblatt”, që ka publikuar rreth 35000 kontrata.

**Akademia Federale e Administratës Publike** (Bundesakademie für öffentliche Verwaltung im Bundesministerium des Innern) organizon programe trajnimi për autoritetet kontraktuese. Në nivel të shtetit ekziston një numër i madh i programeve të trajnimit.

**Trajnimi dhe kërkimi shkencor** i pavarur në universitete, në kolegjet e trajnimit dhe ato që ofrohen nga kompanitë private ndihmohen nga organizata të tilla si Auftragsberatungsstellen (Zyrat e Këshillimit për Prokurimet). Këto zyra janë sipërmarrje të përbashkëta të sektorit publik dhe të dhomave të tregtisë dhe punojnë për të plotësuar nevojën e tenderuesve për këshilla në kohët e buxheteve publike të kufizuara. Kjo mundësi pjesërisht private për të kërkuar këshilla konsiderohet e nevojshme sepse përndryshe shumë tenderues rrezikojnë të skualifikohen. Programet specifike të kërkimit shkencor janë të shumta.

**Organet e shqyrtimit/vlerësimit** të prokurimeve publike, në kuptim të Nenit 2 (8) të Direktivës 89/665/EEC, janë **Dhomat e Prokurimeve** (Vergabekammern). Vlerësimi i vendimeve për prokurimet publike kryhet nga **Njësitë e Shqyrtimit të Prokurimeve** (Vergabepflichten) në përputhje me § 103 GWB (Ligji Anti-Kartel). Ato ofrojnë një rrugë shqyrtimi alternative dhe jo të detyrueshme, e cila megjithatë nuk është përdorur shumë shpesh në praktikë. Autoritetet e hetimit publik (Staatsanwaltschaften) kanë për detyrë të hetojnë rastet e korrupsionit si dhe vepra të tjera penale në rastet e prokurimeve publike. Shqyrtimi gjyqësor i vendimeve për prokurimet publike kryhet nga rreth 20 **gjykata të larta** (Oberlandesgerichte). Ndër 1348 vendime të marra nga Dhomat e Prokurimeve (Vergabekammern), 286 iu nënshtruan shqyrtimit gjyqësor nga gjykatat e larta.

Deri tani nuk ekzistojnë plane për ta ndryshuar strukturën e decentralizuar të sistemit të prokurimeve publike në Gjermani. Prokurimi në nivel qendror i mallrave dhe shërbimeve të standardizuara mund të zgjerohet në kuadër të projekteve të prokurimit elektronik përsa i përket marrëveshjeve kuadër.

## 9. Hungaria

Hungaria ka një strukturë të **centralizuar** të prokurimeve publike me një institucion drejtues i cili është Këshilli i Prokurimeve Publike (PPC), i krijuar në vitin 1995. Struktura aktuale mendohet se është e përshtatshme për t'u marrë me detyrat e saj dhe nuk janë planifikuar ndryshime të mëdha në të ardhmen e afërt.

**Këshilli i Prokurimeve Publike** u krijua me anë të Ligjit mbi Prokurimet Publike të vitit 1995 (APP). Baza ligjore e funksionimit të tij aktual është APP-ë e vitit 2003. Këshilli i Prokurimeve Publike është një **organ i pavarur administrativ** i varur vetëm nga parlamenti, siç përcaktohet kjo në Nenin 374 (1). Anëtarët e tij emërohen nga përfaqësuesit e tre aktorëve në raporte të barabarta: të tenderuesve, të enteve kontraktuese dhe të personave që përfaqësojnë interesat publike. Ligji përcakton se cilat janë organizatat apo cilët janë personat që kanë të drejtë të emërojnë anëtarët. Anëtarët zgjedhin një kryetar për një afat kohor pesëvjeçar me mekanizmin e 2/3 të votave dhe një nënkryetar për dy vjet me shumicë të thjeshtë. Buxheti i keshillit alokohet veçantë në buxhetin vjetor me miratimin paraprak të parlamentit. Anëtarët e Keshillit të Prokurimeve Publike, me përjashtim të kryetarit nuk janë të punësuar me kohë të plotë. Keshilli duhet të mbledhet të paktën gjashtë herë në vit dhe organi i tij i punës, PPC-ja, nxjerr **rekomandime** për të sqaruar problemet e dala gjatë zbatimit të ligjit të prokurimeve publike.

Kryetari i keshillit nxjerr **komunikata informative** në lidhje me çështjet praktike. Këto dokumente nuk kanë forcë ligjore detyruese dhe publikohen në *Buletin e Prokurimeve Publike* si edhe në uebsajtin e keshillit. Në vitin 2005, PPC publikoi 21 komunikata informative nga presidenti dhe një rekomandim. Në vitin 2005, PPC dha këshilla juridike me shkrim për rreth 500 raste dhe iu përgjigj mesatarisht 50 telefonatave në ditë. Edhe entet kontraktuese, edhe tenderuesit mund të kërkojnë këshilla nga PPC. PPC mban edhe një **listë të kontraktorëve të miratuar** në përputhje me Nenin 52 të Direktivës 2004/18/EC. Kjo listë kishte 140 kompani të regjistruara në të në vitin 2005. PPC merr pjesë në **aktivitete ndërkombëtare** (për shembull, në Komisionet Këshilluese të BE - ACPC, në Laboratorin e Prokurimeve Publike të BE-së dhe në PPN) përveç kontributit kombëtar në kuadrin rregullator ndërkombëtar (GPA, UNCITRAL). PPC grumbullon të dhëna statistikore dhe **të dhëna** të tjera. Ai gjithashtu administron një listë të konsulentëve zyrtarë të prokurimeve publike, të ndërmjetësve dhe të enteve kontraktuese (8241 zëra në vitin 2005), si edhe një **listë të tenderuesve** të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e dhënies së tenderave përmes një vendimi të formës së prerë që jepet nga organet e vlerësimit. Aktualisht, kjo listë është bosh. PPC ka detyrën **të publikojë njoftimet** në *Buletin*, njoftime që dalin bashkë me njoftimet e kontratave të publikuara nga entet kontraktuese të Hungarisë në *Gazetën Zyrtare*. PPC kontrollon njoftimet për përputhjen e tyre me kërkesat e legjislacionit për prokurimet. Rreth 25.000 njoftime të tilla u publikuan vetëm në vitin 2005. Në **Gazetën Zyrtare** keshilli komunikon gjithashtu edhe njoftimet e tenderave të enteve kontraktuese të Hungarisë (991 në vitin 2005). PPC **publikon** amendamente të rëndësishme për legjislacionin e prokurimeve në *Buletin* dhe në uebsajtin e PPC-së, ndërsa teksti zyrtar i amendamenteve publikohet në *Gazetën Zyrtare të Hungarisë*. Sipas APP-s, PPC-ë duhet të **raportoje** për veprimtarinë e vet në parlament.

Përsa i përket **prokurimit elektronik**, njoftimet dërgohen vetëm përmes sistemit të menaxhimit të njoftimeve që mbahet në përdorim nga PPC-ë. Operacione të tjera elektronike nuk janë porositur ende. Deri tani janë hartuar vetëm rregullat kryesore për ankandin elektronik dhe për sistemet dinamike të prokurimeve, por rregullat e hollësishme nuk janë hartuar ende. Në vitin 2005 rreth 6-8% të njoftimeve u dërguan elektronikisht për publikim nga entet kontraktuese ose nga përfaqësuesit e tyre. Në lidhje me prokurimet publike mbi kufijtë monetarë të KE-së, që në 1 janar të vitit 2005 është e detyrueshme që të përfshihen konsulentë zyrtarë të prokurimeve publike të paktën në përgatitjen dhe hartimin e njoftimeve dhe dokumentacioneve për tendera. PPC administron **një listë** me rreth 500 **konsulentëve zyrtarë të prokurimeve publike** dhe nga këta 357 u futën në sistem në vitin 2005. Kushtet për të fituar statusin e

konsulentit (për shembull, përvoja e certifikuar profesionale, kualifikimet për sigurinë) janë formuluar në dokumente të APP-së dhe në dy vendime të ministrisë. PPC-ë shqyrton plotësimin e këtyre kushteve.

Hartimit të **legjislacionit** i paraprin në të gjitha rastet një proces konsultimi, i cili përfshin përveç ministrive, edhe organet përfaqësuese. Sipas APP-së i gjithë projektlegjislacioni i prokurimeve publike duhet t'i dërgohet PPC-së për mendim. Në përputhje me Nenin 3 të Direktivës 89/665/EEC mbi koordinimin e ligjit, rregullave dhe dispozitave administrative për zbatimin e procedurave të shqyrtimit, PPC shërben edhe si pikë kontakti për Komisionin. Me këtë rast fillon një procedurë ndërmjetësi përmes, por jo nga, PPC-ë.

Organi i përhershëm i PPC-së, **Sekretariati**, mbikëqyret nga Sekretari i Përgjithshëm dhe është i ndarë në njësi të ndryshme. Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga këshilli në vitin 1995 për një kohë të pacaktuar qëndrimi në detyrë. Neni XXIII i Ligjit mbi Pozitën Ligjore të Nëpunësve Civilë i vitit 1992 përcakton se postet e punës të nëpunësve civilë duhet të plotësohen me konkurrim të hapur dhe, në këtë mënyrë zgjidhen edhe punonjësit e sekretariatit. Sekretariati përgatit dhe zbaton vendimet e PPC-së dhe plotëson detyrat që lidhen drejtpërdrejt me Ligjin e sipërpërmendur pa qenë nevoja për udhëzime të drejtpërdrejta nga këshilli. **Njësia Juridike** (6 punonjës) merret me dhënien e ndihmës ligjore, me përgatitjen e draftit të rekomandimeve të këshillit dhe komunikatat informative të kryetarit si dhe me administrimin e listës së ndërmjetësuesve dhe përgatitjen e kontratave. **Njësia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare** (3 punonjës) dhe ajo e **Trajnimeve** (2 punonjës) kryejnë rolet që vijojnë:

- Përfaqëson PPC-në në veprimtaritë ndërkombëtare.
- U përgjigjet pyetjeve që i bëhen nga jashtë vendit.
- Merr pjesë në punën e Komisionit Këshillimor të BE-së (ACPC) dhe në grupet e punës, në PPN dhe në iniciativa të tjera.
- Kontribuon në trajnimet për prokurimet publike, ndihmon në përcaktimin e kriterëve profesionale dhe të kriterëve të shqyrtimit, monitoron cilësinë e trajnimeve dhe publikon informacion për aktivitetet trajnuese.
- Mban listën e konsulentëve zyrtarë për prokurimet publike dhe vlerëson ankesat e konsulentëve.
- Përgatit komunikatat informative në lidhje me trajnimet dhe çështjet ndërkombëtare.

**Bordi Editorial** (13 punonjës) është përgjegjës për: publikimin e njoftimeve në *Buletin* dhe komunikimin e njoftimeve mbi procedurat komunitare në *Gazetën Zyrtare*; shqyrtimin e të gjitha njoftimeve nga pikëpamja e legjislacionit për prokurimet publike; kthimin e njoftimeve mbrapsht për plotësimin e të dhënave të cilat mungojnë; përdorimin e sistemit të menaxhimit të njoftimeve elektronike si edhe faqen e internetit të PPC-ës. **Grupi i Analizës Ekonomike** (2 punonjës) kujdeset për menaxhimin dhe analizën e statistikave të prokurimeve publike. **Njësia Financiare** dhe **Menaxheri i Burimeve Njerëzore** (9 punonjës) planifikon buxhetin e PPC-ës, organizon konsultimet me Ministrinë e Financave, zbaton dhe kontrollon alokimin e buxhetit të miratuar dhe bën faturat, përlllogaritjet e pagesave dhe transfertat e parave. Menaxheri i burimeve njerëzore është përgjegjës edhe për administrimin e listës emërore të nëpunësve civilë, menaxhimin e deklaratave të pasurisë, administrimin e posteve dhe të transfertave, menaxhimin e kundërshtimeve dhe ofrimin e ndihmës për përzgjedhjen e stafit. Së fundi, **Kontrollori i Brendshëm** kryen auditimin financiar brenda organizatës.

Shumica e anëtarëve të stafit janë nëpunës civilë, por disa janë të punësuar me kohë të pjesshme në përputhje me detyra e kushte të përgjithshme ose të posaçme. Sipas ligjit të Hungarisë, nëpunësit civilë duhet të kenë një diplomë të shkollës së mesme, ndërsa për postet administrative kërkohet një diplomë profesionale e nivelit të mesëm. Nëpunësi civil duhet të kalojë një provim profesional në fushën e administratës publike (ndërsa juristët duhet të kalojnë një provim profesional juridik) brenda tre vjetësh që nga dita e punësimit. Komisionerët e prokurimeve publike duhet të kenë një diplomë të arsimit të lartë, tre vjet përvojë profesionale dhe të kalojnë në provimin profesional në fushën e administratës publike ose të

drejtësisë. Në vitin 2005 ishin gjithsej 23 komisionerë, ndërsa 33 punonjës të stafit të sekretarisë zotëronin diploma të shkollës së lartë. Pa diploma të arsimit të lartë janë 23 anëtarë të stafit, të cilët kanë zënë poste sekretariate në sekretariat dhe në Bordin e Arbitrazhit.

**Buxheti** i PPC-së i vitit 2005 ishte 1035.4 milion HYF (forinta hungareze), të barabarta me 4.090.065 euro. Buxheti është pjesë e ligjit të buxhetit vjetor. Ai përgatitet përmes konsultimeve midis stafit të sekretariatit dhe të Ministrisë së Financave dhe miratohet nga parlamenti. Megjithatë, të ardhura shtesë nxirren edhe nga **tarifat** dhe gjobat (50%). Tarifat që sigurojnë të ardhura për PPC-ënë përfshijnë tarifat e publikimeve, tarifat për shërbime të administratës publike të cilat lidhen me administrimin e listave të ndryshme (lista e konsulentëve zyrtarë të prokurimeve publike, lista e kontraktorëve të miratuar, lista e ndërmjetësuesve) dhe tarifat për fillimin e procedurës së shqyrtimit. Përveç kësaj, shitjet e *Buletinit* sigurojnë të ardhura për PPC-në (megjithëse kjo e ardhur është shumë më e vogël sesa kostot e publikimit). Vendimi i Qeverisë 34/2004 përcakton rregulla për tarifat e publikimit: 8000 HUF (afërsisht 28 euro) për një njoftim komunitar; 4000 HUF + VAT për faqe (një faqe me 1500 karaktere) për një njoftim komunitar. Arsyeja për diferencën midis këtyre dy tarifave është se në një procedurë komunitare enti kontraktues paguan vetëm për kontrollin e njoftimit, meqë publikimi në Gazetën Zyrtare është falas. APP-ë përcakton listën e tarifave administrative, e cila është 80000 HUF (afërsisht 280 euro) për të future në listën zyrtare emrat e konsulentëve zyrtarë të prokurimeve publike dhe për të qenë pjesë e listës së emrave të ndërmjetësuesve. Konsulenti zyrtar i prokurimeve publike mund t'i rinovojë dhe t'i çertifikojë çdo vit aktivitetet e kryera gjatë periudhës së fundit duke paguar një tarifë prej 30000 HUF (afërsisht 105 euro). Tarifa për të figuruar në listën e kontraktorëve të miratuar është 150000 (afërsisht 525 euro). Tarifa administrative për kërkimin e një zgjidhjeje ligjore është 150000 HUF (afërsisht 525 euro) ose 900000 HUF (afërsisht 3160 euro), në varësi të vlerës së kontratës dhe të objektit të kërkesës. Përveç këtyre, 50% e gjobave të vëna nga Bordi i Arbitrazhit siguron të ardhura për PPC-në, pjesa e mbetur e gjobave shkon në buxhetin qendror.

Departamenti i së Drejtës Civile, i Kodifikimit dhe i së Drejtës Private Ndërkombëtare i **Ministrisë së Drejtësisë dhe i Zbatimit të Ligjit (MJLE)** harton legjislacionin parësor. Kjo bëhet nga një zëvendës drejtor i departamentit, i cili punon nën drejtimin e një sekretari shteti dhe mbështetet nga tre këshilltarë juridikë (nëpunës civilë). Planet dhe projektligjet publikohen nga organi përgjegjës për atë fushë në faqen e tij të internetit. Kur projektligji ndryshon të paktën 1/5 e dispozitave të ligjit ekzistues, hartuesi duhet ta publikojë në faqen e tij të internetit ligjin që do të amendohet, duke përfshirë në të edhe një afat kohor për dhënien e komenteve. Çdokush mund të shprehë mendimin e vet dhe të bëjë një propozim në lidhje me planet dhe projektet e publikuara të paktën brenda 15 ditëve. Hartuesi i legjislacionit duhet të publikojë në faqen e vet një vlerësim dhe një përmbledhje të pikëpamjeve si edhe një shpjegim në lidhje me refuzimin e disa mendimeve (përveç rasteve kur pikëpamjet duket qartë se nuk janë të mbështetura). Hartuesi nuk është i detyruar të ofrojë përgjigje personale. Pastaj drafti dërgohet drejtpërdrejt te organizatat përkatëse, të cilave u është dhënë edhe një afat kohor për të bërë komente. Hartuesi mund të fillojë edhe konsultime gojore me organizatat e interesuara. Hartimi dhe përgatitja e legjislacionit dytësor është detyrë e Ministrisë specifike, por kjo kryhet në bashkëpunim të ngushtë me punonjësit e MJLE. MJLE është gjithashtu përgjegjës për kontributin kombëtar në UNCITRAL.

**Politika e prokurimeve** është përgjegjësi e MJLE, e PPC-së dhe e ministrive të tjera. Kontributi kombëtar në **komisionet këshillimore të BE-së** organizohet nga MJLE, nga PPC-ë dhe në grupin e punës elektronike të ACPC-së – përveç organeve të sipërpërmendura – nga Drejtoria e Shërbimeve Qendrore dhe Qendra e Qeverisjes Elektronike të Zyrës së Kryeministrit. Edhe MJLE, edhe PPC-ë marrin pjesë në **PPN**. Përsa i përket shkeljes së procedurave, sipas Nenit 226 të Traktatit të KE, Ministria e Punëve të Jashtme (më parë, Zyra e Çështjeve Europiane) është pika e kontaktit për Komisionin. **Kontributi Kombëtar në GPA** është detyrë e Përfaqësisë së Përhershme në OBT (Organizata Botërore e Tregtisë).

**Komisioni i Parlamentit** mund të lejojë moszbatimin e APP-së (ligjit të prokurimeve publike) kur prokurimi ka lidhje me sekretin shtetëror, me shërbimet sekrete dhe me interesat e sigurisë kombëtare. APP-ë i jep kryetarit të **Bordit të Arbitrazhit të Prokurimeve Publike** (shih më poshtë) të drejtën të

veprojë **krahas PPC-së** për të mbikëqyrur procedurat e negociuara dhe të thjeshtuara (për kategorinë e shërbimeve II/B) pa bërë më parë publikimin e njoftimit. Kryetari i PPAB-së ka marrë informacion për 1220 raste që synonin të përdornin një procedurë të negociuar dhe të thjeshtuar pa publikimin më parë të njoftimit përkatës.

Blerjet qendrore për ente të tjera kontraktuese kryhen përmes **Drejtorisë së Shërbimeve Qendrore (CSD)**. Për 1000 institucione është e detyrueshme që ato të prokurojnë mallra dhe shërbime të caktuara përmes kësaj drejtorie. Përveç kësaj, ente të tjera kontraktuese mund t'i bashkohen vullnetarisht sistemit dhe në vitin 2005 e bënë këtë gjë 900 ente. Rreth 12% e enteve kontraktuese të Hungarisë bënë blerje qendrore në vitin 2005 dhe vlera e mallrave dhe e shërbimeve të prokuruar ishte 65 milion HUF (afërsisht 257 milion euro), rreth 5% e vlerës së përgjithshme të prokurimeve në Hungari. Midis 1 majit 2004 dhe 15 janarit 2006 vetëm CSD-ë mundi të përfundonte një **marrëveshje kuadër** brenda fushës së veprimit të autoriteteve kontraktuese klasike mbi pragun e vlerës monetare të BE-së. Çdo ent kontraktues mund të përfundonte një marrëveshje kuadër nën këtë kufi monetar. Që në 1 maj 2004, shërbimet në infrastrukturë (ujësjellësi, elektriciteti, kanalizimet, etj.) gjithashtu mund të përdornin marrëveshjet kuadër për kontrata mbi kufijtë monetarë të BE-së. Që në 15 janar 2006, të gjitha entet kontraktuese mund ta përdornin këtë procedurë.

Për prokurimet publike janë organizuar **programe të ndryshme trajnimi**. Këto janë ofruar kryesisht prej **sektorit privat** dhe janë mbikëqyrur nga organizata specifike. Punonjësit e PPC-së japin leksione në këto kurse dhe kryesojnë komisionet e provimit në kurset e ekspertëve të prokurimeve publike. Trajnimi i punonjësve kryhet nën mbikëqyrjen e PPC-së. Në vitin 2005, institucione të ndryshme trajnimi organizuan 80 kurse për ekspertët e prokurimeve publike (një trajnim i tillë profesional i njohur nga shteti e që zgjat maksimalisht 220 orë). Në vitin 2005, kurset e ekspertëve të prokurimeve publike i ndoqën 1339 persona. Prokurimi publik është në qendër të kurrikulave të **universiteteve dhe kolegjeve** (ose si pjesë e një fushe të rëndësishme, ose si një lëndë e pavarur). Përveç kurseve të ekspertëve të prokurimeve publike, institucionet private organizojnë gjithashtu tipe të tjera kursesh trajnimi. PPC-ë publikon informacion për aktivitetet trajnuese që i raportohen në faqen e vet të internetit. PPC, MJLE dhe ministri e organe të tjera marrin pjesë në aktivitete akademike kombëtare e ndërkombëtare dhe në veprimtari të tjera të tilla që kanë të bëjnë me ligjin e prokurimeve, ekonominë dhe politikën. PPC-ë në vitin 2005 ka ndjekur rreth 20 aktivitete të tilla. Përveç kurseve **private** të trajnimit, ekzistojnë edhe publikime të kryera nga iniciativa private dhe është e mundur të regjistrohesh në internet për të marrë Gazetat e Prokurimeve Publike që nxirren nga disa kompani private: lajme të reja javore të nisura me e-mail për të gjithë përdoruesit e regjistruar.

**Organ i shqyrtimit** të prokurimeve publike, në kuptim të Nenit 2 (8) të Direktivës 89/665/EEC, është **Bordi i Arbitrazhit të Prokurimeve Publike (PPAB)** i cili ka po të njëjtën strukturë si PPC-ë. Ky bord (dhe gjykatat, kur shqyrtojnë vendimet e PPAB) mund të vendosë gjoba duke u mbështetur në APP-në. Gjoba nuk duhet të jetë më e madhe se 30% e vlerës së kontratës në fjalë. Megjithatë, në praktikë ajo kurrë nuk e kalon 5% të vlerës së prokurimit dhe zakonisht vërtitet midis 3500-7000 euro. Nëse procedura e prokurimit publik injorohet në mënyrë të pajustificueshme dhe me keqdashje, gjoba nuk duhet të jetë më e vogël se 7000 euro dhe jo më shumë se 30% e vlerës së kontratës dhe, në rastin e një personi fizik afërsisht 700 euro. Në vitin 2005, PPAB-ë vendosi gjoba në 321 raste (shkeljet e ligjit ishin konstatuar në 452 raste). Në rastin e procedurës së shqyrtimit mund të vihet edhe një tarifë administrative. Mbështetur në Nenin 338 të APP-së, bordi mund të vendosë një gjobë procedurale midis 5000-500000 HUF (afërsisht 198-1975 euro) për atë aktor të prokurimeve publike në rastet kur: a) ai ofron të dhëna false, ose fsheh të dhënat që mund të jenë me rëndësi themelore për gjykimin e rastit, b) nuk jep informacion, ose nuk e jep atë në kohën e caktuar, c) paraqet pengesa për të marrë dokumente që lidhen me aktivitetin ekonomik, profesional, ose për prokurimet publike, d) bën një deklaram dukshëm të pabazuar në lidhje me përjashtimin, ose në të njëjtën procedurë bën një deklaram të pajustificuar në mënyrë të përsëritur kundër të njëjtit komisioner të arbitrazhit. Gjoba mund të vendoset edhe në mënyrë të përsëritur. Në vitin 2005 u kryen 9 procedura ndërmjetësimi.

PPAB vepron krahas me PPC-në. Komisionerët e arbitrazhit kanë statusin e **nëpunësve civilë** që punojnë me kohë të plotë. Paneli prej tre anëtarësh që gjykon në procedurat e shqyrtimit emërohet nga kryetari i bordit të arbitrazhit. Në vitin 2005, në PPAB-ë dhe në Sekretariat punonin gjithsej 79 persona. Staf i PPAB-it përzgjidhet përmes një konkurrimi publik. Punësimi i tyre zgjat për një kohë të pacaktuar. Komisionerët e arbitrazhit emërohen dhe shkarkohen nga PPC-ë. Kryetari dhe zëvendëskryetari i PPAB-së zgjidhen nga mesi i komisionerëve të arbitrazhit prej PPC-së, mbi bazën e një konkursi për një periudhë kohore prej pesë vjetësh.

Sipas ligjit për procedurën penale, çdo njeri që merr vesh për një shkelje mund të dërgojë një ankesë. Sipas ligjit të APP-së, kur PPAB-ë dyshon se është kryer një krim, ata duhet të informojnë agjencinë përkatëse të hetimit. Organizatat përgjegjëse për auditimin e enteve kontraktuese për aktivitetet e tyre të prokurimeve publike janë **Zyra e Auditimit të Shtetit, Zyra e Kontrollit Qeveritar**, institucionet që ofrojnë fonde të BE-së dhe/ose mbështetje buxhetore si edhe zyrat e administratës qendrore në rrethe.

**Gjykata e Bashkisë** është përgjegjëse për **shqyrtimin gjyqësor** të vendimeve të prokurimeve publike të shkallës së parë. Në shkallën e dytë funksionojnë **Gjykatat e Apelit të Bashkisë**. Në vitin 2005 u nënshtruan shqyrtimit gjyqësor 244 vendime.

## 10. Irlanda

Irlanda ka një strukturë **gjysmë të centralizuar** të prokurimeve publike, por me një institucion kyç në nivel qendror, **Njësia e Politikave Kombëtare të Prokurimeve Publike (NPPPU)**, e cila është pjesë e Departamentit të Financave.

**NPPPU** merret me hartimin e legjislacionit parësor e dytësor, me formulimin e procedurave dhe rutinave standarde, me hartimin e dokumenteve standarde të tenderave (kur kjo bëhet në qendër), me hartimin e dokumenteve standarde të kontratave, me hartimin e politikës së prokurimeve dhe me përgatitjen e udhëzimeve dhe të instruksioneve. Aktorët përfshihen në procesin legjislativ përmes komisioneve të personelit/punonjësve të prokurimeve publike, përmes **Komisionit Qeveritar të Kontratave, rrjeteve të prokurimeve elektronike** dhe një organi përfaqësues, **Forumi për Prokurimet Publike në Irlandë**. NPPPU është pika e kontaktit për Komisionin, përgatit kontributin kombëtar për komisionet këshillimore të BE-së, dhe merr pjesë në PPN. NPPPU ka gjithashtu detyrën të grumbullojë të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera dhe të përgatisë udhëzime. Në vitin 2005 u përgatitën dy të tilla. Përveç kësaj, ajo administron një listë të punonjësve të certifikuar të prokurimeve, dhe këshillon qeverinë për politikën e prokurimeve publike, ofron këshillim ligjor dhe këshillim tjetër për entet dhe shërbimet kontraktuese (Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm për këshillim zyrtar ligjor). NPPPU sponsorizon edhe një kurs pasuniversitar të nivelit të tretë në fushën e prokurimeve publike i cili fillon në shtator 2006. Njësia financohet nga buxheti i përgjithshëm të qeverisë i cili miratohet në parlament. Ajo aktualisht ka një personel prej 10-12 punonjësish, të cilët janë: drejtuesi i njësisë, një këshilltar profesionist për ndërtimin, pesë punonjës të nivelit të mesëm të menaxhimit dhe katër ose pesë punonjës sekretarie.

**Shërbimi Ekzekutiv i Shëndetësië** në nivel kombëtar ka një **Agjenci Prokurimesh** e cila kryen për sektorin e shëndetësisë shumë prej funksioneve të NPPPU-së të përshkruara më sipër. **Departamenti i Sipërmarrjes, i Tregtisë dhe i Punësimit** ka detyrën e kontributit kombëtar në GPA. Kjo është një detyrë e vogël dhe kontributi i vendit pasqyrohet më mirë në Komisionin e BE-së. **Instituti i Administratës Publike (IPA)** organizon një program kombëtar trajnimesh për sektorët publikë dhe të shërbimeve në infrastrukturë. Në vitin 2005, ky program u realizua me anë të një kursi 20 ditor për 20 persona, të cilët kaluan të gjithë në provim. Në të njëjtin vit, **Njësia e Trajnimeve e Shërbimit Civil** organizoi katër kurse dyditore me nga 60 pjesëmarrës secili. **Konsulenca e sektorit privat** dhe firmat ligjore ofrojnë kurse të shumta afatshkurtra. **Departamenti i Financës i Agjencisë ICT dhe Bordi i Shërbimeve Kompjuterike për Qeverisjen Vendore** lehtëson disa marrëveshje kuadër: tre të tilla në vitin 2005. Për më tepër, u prokuruan ose janë në proces e sipër rreth 20 projekte (të financuara privatisht me vlerën prej mbi 20 milion eurosh). Në vitin 2005 u mbikëqyrën tre projekte të prokurimeve elektronike.

**Zyra e Agjencisë për Punët Publike dhe Furnizimin e Qeverisë** prokuron nga qendra për rreth 30 departamente dhe zyra, afërsisht 3% të të gjithë tregut. Një sasi e vogël e blerjeve qendrore kryhet në rajonin lindor nga **Ekzekutivi i Shërbimit të Shëndetësisë**.

**Gjykata e Lartë** është një organ për shqyrtimin e prokurimeve në kuptim të Nenit 2 (8) të Direktivës 89/665/EEC dhe në këtë rol ajo shqyrton rreth tre ose katër raste çdo vit.

Struktura e prokurimeve e Irlandës historikisht ka qenë kryesisht e decentralizuar. Megjithatë, që prej krijimit të saj në vitin 2002, NPPPU ka nxitur një qasje kombëtare më strategjike ndaj prokurimeve publike. Kjo arrihet duke kryer funksionin në mënyrë më profesionale, duke grupuar kërkesat ku është e përshtatshme dhe duke diskutuar për krijimin e mundshëm të një **njësie kombëtare operative**. Kjo mund të kërkojë një agregim dhe një bashkëpunim më të madh në nivel kombëtar. Strategjia përfshin edhe krijimin e një strukture që do të lehtësonte përdorimin e përshtatshëm të tenderimeve dhe blerjeve elektronike.

## 11. Italia

Italia ka një strukturë **gjysmë të centralizuar** të prokurimeve publike, por ende të dominuar nga dy institucione: Autoriteti i Punëve Publike (PWA) dhe Consip (fillimisht shkurtimi i Concessionaria Servizi Informatici Pubblici – shih më poshtë). Funksione të rëndësishme i janë caktuar Parlamentit, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Infrastrukturës, rajoneve dhe provincave vetëqeverisëse, Autoritetit Antitrust, Departamentit për Politikën Komunitare, Qendrës Italiane të Statistikave (ISTAT) dhe Institutit të Studimeve dhe Kërkimeve Ekonomike (ISAE). Për më tepër, vendi ka një strukturë prokurimesh të **organizuar vertikalisht** në të cilën rajonet, provincat dhe bashkitë kryejnë prokurimet në nivel vendor.

**Autoriteti i Punëve Publike (PWA)** është një autoritet i pavarur që përgjigjet para parlamentit. Ai u institucionalizua me Ligjin Nr. 109 të 11 janarit 1994 dhe është ngritur në janar 1999. PWA është një organ kolegjal i përbërë prej pesë anëtarësh të cilët marrin vendime me shumicë votash. Ligji i jep PWA-së kontroll dhe mbikëqyrje mbi procedurat e prokurimeve publike. Qëllimi i tij është të garantojë kryerjen në kohë, saktësinë dhe transparencën e procedurave të administratës publike dhe VFM (value for Money) e menaxhimit të prokurimit publik. Një qëllim tjetër është të përcaktojë fushat të cilat mund të kërkojnë përmirësime përsa i përket efikasitetit dhe efektivitetit. Ligji i ri Nr. 62/2005 i ka shtuar funksioneve të PWA-së edhe funksionin e mbikëqyrjes së kontratave të shërbimeve, mallrave dhe të shërbimeve infrastrukturore në përputhje me Direktivën 18/2004/EC dhe të Direktivës 17/2004/EC. PWA mund t'u kërkojë autoriteteve kontraktuese dhe kompanive private të japin të dhëna dhe informacion për prokurimet në proces dhe për dhënien e kontratave për prokurime publike. Ai mbikëqyr edhe sistemet e kualifikimeve për tendera dhe ka detyrën të arbitrojë mosmarrëveshjet (përmes Gjykatës së Arbitrazhit e cila është një gjykatë e pavarur).

Sipas Nenit 4 të Ligjit 109/94, aktivitetet kryesore të PWA-së janë:

- a) mbikëqyrja e aftësisë ekonomike dhe financiare në kryerjen e prokurimeve publike;
- b) mbikëqyrja e pajtueshmërisë me rregullat parësore dhe dytësore përmes auditimit dhe kontrollit të kampioneve për të garantuar saktësinë dhe korrektesinë e procedurave të dhënies së prokurimeve;
- c) auditimi i humbjeve të ndodhura për Thesarin;
- d) informimi i parlamentit dhe i qeverisë për raste veçanërisht serioze në lidhje me përputhshmërinë ose mungesën e zbatimit të rregullave përkatëse;
- e) dërgimi i sugjerimeve për amendimin e rregulloreve në administratën publike;
- f) raportimi vjetor në parlament dhe në qeveri për parregullsitë kryesore, veçanërisht në lidhje me:
  - aplikimin e dhënies së kontratave pa konkurrim

- reklamën e pamjaftueshme
  - shpeshtësinë e vonesave dhe të deviacioneve të prokurimit
  - shkeljen e kontratave të operatorëve dhe koncesionarëve
  - zvarristet jonormale në procedurat gjyqësore
- g) mbikëqyrja e Observatorit;
- h) vendosja e sanksioneve;
- i) mbikëqyrja e përzgjedhjes cilësore.

Observatori i PWA-së administron një **listë të zezë** në të cilën në vitin 2005 janë futur 2993 tenderues. PWA mund t'i **gjobisë** autoritetet kontraktuese që shkelin rregullat e prokurimeve publike: gjoba më e lartë e mundshme është rreth 50.000 euro. Deri më sot janë marrë në shqyrtim për një gjobë të tillë 151 raste dhe janë gjobitur 36 autoritete kontraktuese. PWA ka marrë **masa disiplinore** edhe ndaj 27 individëve-punonjës për kontraktimet gjatë po të njëjtit vit.

PWA ka një **kryetar** dhe katër anëtarë të emëruar bashkarisht nga kryetarët e Senatit dhe të Dhomës së Deputetëve. Kryetari i bordit zgjidhet nga vetë anëtarët. Çdo anëtar qëndron në detyrë për pesë vjet pa të drejtë rinovimi të qëndrimit. PWA ndahet në **tre njësi kryesore**: A) **Sekretariati Teknik** mbështet PWA-në në të gjitha aktivitetet e tij duke përgatitur dokumente interpretuese ose rregulla. B) **Shërbimi i Inspektimit** është krahu operacional i PWA-së dhe kryen kontrolle dhe hetime në fushën e punëve publike. C) **Observatori** mbledh të dhëna dhe informacion në mënyrë elektronike për prokurimet publike. Ai formulon kosto të standardizuara dhe jep statistika si edhe analiza për kostot dhe përfitimet për të mbështetur aktivitetin e PWA-së. Ai është i organizuar në një njësi qendrore me degë në rajone, dhe kështu ka edhe një shkallë të caktuar të decentralizimit vertikal. Në vitin 2006, PWA kishte një staf prej 237 nëpunësish civilë, shumica e të cilëve kishin diplomë në inxhinieri, në drejtësi ose ekonomi. Rreth 70% e stafit e njej mirë të drejtën komunitare. PWA u financua nga buxheti i përgjithshëm i qeverisë, por kjo ka ndodhur deri në vitin buxhetor 2005. Duke filluar që nga viti 2006, PWA do të duhet t'i nxjerrë fondet e saj nga autoritetet kontraktuese, tenderat dhe përzgjedhja cilësore që çertifikon kompanitë. Buxheti i PWA-së për vitin 2005 ishte rreth 20 milion euro.

#### **CONSIP: DETYRAT DHE STRUKTURA**

Consip është një kompani me përgjegjësi të kufizuara, në pronësi totale dhe të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF). Ai operon vetëm për t'i shërbyer dy degëve kryesore të administratës publike: ICT-së (Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë) dhe Drejtoria e Blerjeve Online të Autoritetit Publik (DARPA).

Detyrat kryesore të Consip janë:

- mbështet strukturimin e proceseve organizacionale të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, duke përdorur teknologjitë e informacionit (kjo buron nga Dekreti Legjislativ i vitit 1997);
- mbështet administratën publike në programin e racionalizimit të shpenzimeve publike mbi mallrat dhe shërbimet (kjo buron nga dy dekrete ministrore të shkurtit 2000 dhe majit 2001).

Në Consip punojnë rreth **500 punonjës**, 355 prej të cilëve kanë një diplomë universitare. Bordi i drejtorëve emërohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe është i përbërë nga nëntë anëtarë, përfshirë Kryetarin dhe CEO. Consip është i ndarë në dhjetë njësi: Kontrolli dhe financa, Çështjet juridike dhe të korporatave, Burimet njerëzore dhe organizimi, Identiteti i korporatave, Drejtoria e përgjithshme, Operacionet, Kërkimi shkencor dhe projektet e veçanta, Drejtoria e financave publike, Drejtoria e sistemeve të informacionit dhe Drejtoria e blerjeve online e PA-së.

Me interes të posaçëm ka qenë krijimi i **Njësisë për Kërkime**, e cila në vitin 2003 përbëhej nga ekonomistë. Aktivitetet kryesore të kësaj njësie janë:



- të analizojë strategjitë e prokurimeve të Consip (ICT + DARPA);
- të studiojë formate dhe kontrata novatore të ankandëve që synojnë rritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve përmes kontratave kuadër;
- të publikojë dokumente pune (publikimi më i fundit është *Manuali i Prokurimeve*, i cili është redaktuar nga Cambridge University Press);
- të organizojë seminare nga profesorë të njohur ndërkombëtarë të specializuar në kryerjen e prokurimeve publike dhe të ankandëve (objekti i tyre kanë qenë: menaxhimi i rrezikut në prokurime, konkurrenca midis platformave elektronike, privasia ekonomike dhe e prokurimit, prokurimi publik në Suedi, aspektet ekonomike dhe pasojat e politikave, rregullat e pikavarazhit).

### CONSIP: PROGRAMI I RACIONALIZIMIT

Ky program ka për qëllim të racionalizojë shpenzimet publike dhe për këtë ka dy objektiva kryesore:

1. administratën publike: të ndërtojë një agjenci qendrore për blerjet për të përmirësuar efikasitetin e prokurimeve publike, për të pakësuar shpenzimet publike dhe për të dhënë mbështetje konsulente për projekte të posaçme të PA-së. Rezultati i pritshëm është të garantohen një numër mallrash dhe shërbimesh për PA-në të cilat maksimalizojnë marrëdhënien e cilësisë me koston;
2. tregun e furnizimit: të bëjë të disponueshme instrumentet e prokurimeve elektronike për të ulur kostot tregtare duke rritur aksesin në një treg me potencial më të madh.

Qëllimi dhe strategjitë e programit kanë tre nivele kryesore:

1. Eficienca dhe cilësia e shërbimit, me fokus në cilësinë duke garantuar një gamë të gjerë alternativash brenda kontratave dhe vlerësimin sistematik të nivelit të shërbimit;
2. Thjeshtësimi i procesit, përmes një procesi të shkurtuar tenderimi, sa më afër kohës zero për tregun dhe porositë online;
3. Kursimi i kostove, përmes ekonomive të shkallës duke grumbulluar kërkesën dhe duke bërë standardizimin e blerjeve dhe konkurrueshmërinë.

Rezultatet e synuara janë “transparenca dhe gjurmimi në kohën e duhur i shpenzimeve të PA-së” dhe “rritja e dinamikave të tregut”.

Prandaj, zhvillimi i programit mbështetet mbi tre linja kryesore veprimi: (1) kontratat kuadër, (2) mbështetja për nevojat e posaçme të PA-së, (3) tregu, i mbështetur nga një platformë e përparuar e teknologjisë së informacionit duke përdorur Teknologjinë Orakull.

Autoritetet kontraktuese duhet të marrin parasysh kontratat kuadër si një standard. Nëse nuk gjejnë në treg çmime më të mira sesa ato të kontratave kuadër, atyre u kërkohet të përdorin kontratat kuadër të dhëna nga Consip.

Rezultatet kryesore të arritura në vitin 2005 ishin si më poshtë:

- Rreth 45.000 “pika shitjeje” brenda të gjithë administratës publike patën mundësinë të prokuronin përmes Consip-it.
- Kontratat kuadër mbuluan 13.688 miliard euro të shpenzimeve publike dhe vlera blerëse e kontratave kuadër aktive ishte 945 milion euro.
- Tregu elektronik arriti një vlerë të përgjithshme blerëse prej 29.8 milion eurosh duke përfshirë 9667 transaksione.

Aktivitetet e rezultate të tjera përfshinin dhënien e një çmimi për universitetet italiane që dëshironin të kishin **kurse universitare të nivelit master në fushën e prokurimit elektronik**. Ky aktivitet synon

studentët pasuniversitarë, nëpunësit civilë dhe tenderuesit e sektorit privat. Në vitin 2005, dy universite e filluan një program të tillë dhe në to u regjistruan 30 studentë.

**Iniciativa Info Gate** përbën një bashkëpunim të gjerë me shoqatat kombëtare dhe vendore të sipërmarrësve. Ajo synon në sigurimin e mbështetjes së vazhdueshme për ndërmarrjet, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla e të mesme në gjithë vendin, për aspekte të ndryshme të Programit të Racionalizimit të Shpenzimeve Publike për Mallra dhe Shërbime. Aktorët e përfshirë (Consip, shoqatat e sipërmarrjeve kombëtare e vendore) ndërtojnë struktura që mbështesnin pjesëmarrjen e ndërmarrjeve në program. Në vitin 2005, rreth u ngritën rreth 100 Info Gate dhe u organizuan 12 aktivitete nismëtare. Consip jep ndihmë të vazhdueshme për Info Gate-t përmes një adrese të postës elektronike, një qendre telefonatash, një gazete për njoftimin e lajmeve të reja, një CD-je, dhe një video konference.

Consip i dërgon Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave një **raport** mujor, një raport tremujor dhe një raport vjetor me të dhëna mbi programin e racionalizimit për mallrat dhe shërbimet. Në vitin 2005, **buxheti** që i ishte caktuar Consip-it për programin e racionalizimit ishte 49.2 milion euro (TVSH përjashtohet). Buxheti është pjesë e buxhetit të përgjithshëm të ministrisë dhe buron nga një kuotë fikse që mbulon kostot fikse të programit (do me thënë personelin) dhe një kuote të ndryshueshme që mbulon kostot e projekteve novatore strategjike.

Hartimi i legjislacionit parësor është përgjegjësi e **Parlamentit dhe e Këshillit të Ministrave**, ndërsa hartimi i legjislacionit dytësor bëhet nga **Ministria e Infrastrukturës, e rajoneve dhe e provincave vetëqeverisëse**. Ministria e Infrastrukturës, PWA dhe **Autoriteti Antitrust** hartojnë procedurat dhe rutinat standarde. Ministria e Infrastrukturës, PWA dhe rajonet kanë detyrë të hartojnë dokumentet standarde të tenderave. Hartimi i politikës së prokurimeve është detyrë e qeverisjeve kombëtare dhe rajonale. Ministria e Infrastrukturës dhe PWA përgatisin udhëzime dhe instruksione. Pika e kontaktit për Komisionin është **Departamenti për Politikat Komunitare**, i cili kujdeset edhe për kontributin kombëtar në komisionet këshillimore të BE-së. Autoriteti Antitrust, Departamenti për Politikat Komunitare, Consip dhe PWA (secili duke kryer detyrat e veta) të gjithë marrin pjesë në miratimin e PPN-së (Rrjeti i Prokurimeve Publike) dhe në zbatimin e drejtë të direktivave të BE-së, të udhëzimeve dhe të sugjerimeve për prokurimet publike. **Qendra Italiane e Statistikave (ISTAT)** dhe **Instituti i Studimeve dhe Kërkimeve Ekonomike (ISAE)** janë ndër organizatat që grumbullojnë të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera. PWA dhe Autoriteti Antitrust këshillojnë qeverinë në lidhje me politikat e prokurimeve publike. Ministria e Infrastrukturës dhe PWA ofrojnë këshilla ligjore dhe këshilla të tjera për entet kontraktuese, për shërbimet infrastrukturore dhe tenderuesit. Përveç kontratave të punëve, ku PWA është edhe autoriteti që vendos gjoha, gjoha mund të vendosë edhe Autoriteti Antitrust.

Në ministrinë rajonale, në provinca dhe në distrikte ekzistojnë njësi të prokurimeve publike dhe ka zyra bashkiake të prokurimeve publike ose zyra të grupeve të bashkive. Çdo ent vendor ka një zyrë prokurimi, madhësia e së cilës varet nga vëllimi i prokurimeve të kryera.

## 12. Letonia

Letonia ka një strukturë të **centralizuar** të prokurimeve publike me Byronë e Monitorimit të Prokurimeve si institucioni kryesor dhe Ministrinë e Financave e cila është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit. Megjithatë, detyra të rëndësishme kryhen edhe nga institucione të tjera, të tilla si Byroja për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit, Zyra e Auditimit të Shtetit, Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia Qendrore e Financave dhe e Kontraktimeve. Në vitin 2006, qeveria ngriti edhe Agjencinë për Prokurimin Elektronik.

**Zyra e Monitorimit të Prokurimeve (PMB)** është një institucion administrativ në varësi të Ministrisë së Financave. Ajo vepron në përputhje me PPL-në, me rregullat e Zyrës së Monitorimit të Prokurimeve dhe me çdo legjislacionit tjetër. PMB-ë është përgjegjëse për monitorimin e **përputhjes së prokurimeve** me kërkesat ligjore. Ajo harton **procedurat dhe rutinat standarde** dhe harton projekt dokumentet e tenderave dhe të kontratave. Ajo formulon **politikën** kombëtare të prokurimeve dhe përgatit udhëzimet dhe instruksionet. Ajo shqyrton ankesat në lidhje me procedurat e prokurimeve. Ajo shërben si **pikë kontakti** për Komisionin, organizon kontributin kombëtar në komisionet këshillimore të BE-së, merr pjesë në PPN-

ë, jep kontributin kombëtar në UNCITRAL dhe në GPA (me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave) dhe në përfaqësime të tjera ndërkombëtare. Detyra të tjera përfshijnë përgatitjen e **raportit vjetor** për qeverinë në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimeve publike (me Ministrinë e Financave); grumbullimin e të dhënave statistikore dhe të **dhënave** të tjera; dhënien e lejes për procedura më pak konkurruese, përdorimin e përjashtimeve, të zgjatjes së afateve; përdorimin e procedurave të përsheptuara, etj. (me Kabinetin e Ministrave dhe autoritetet kontraktuese) dhe përgatitjen e udhëzimeve (nëntë të tilla u përgatitën në vitin 2005). PMB është gjithashtu përgjegjëse për administrimin e **buletinit** kombëtar të prokurimeve publike, përfshirë këtu edhe publikimin dhe kontrollin e reklamave të cilat nuk i përmbushin kërkesat (9884 të tilla në vitin 2005); komunikimin e njoftimeve për entet kontraktuese dhe shërbimet infrastrukturore në Gazetën Zyrtare (1592 të tilla në vitin 2005); publikimin dhe shpërndarjen e informacionit për legjislacionin dhe politikat (të publikuara gjithashtu edhe në gazetën zyrtare të Ministrisë së Financave, *Latvijas Vēstnesis*). PMB **këshillon** qeverinë në lidhje me politikat e prokurimeve publike. Ajo ofron këshilla në lidhje me marrëveshjet kuadër. Për më tepër, ajo ofron këshilla juridike dhe këshilla të tjera për entet kontraktuese, për shërbimet në infrastrukturë dhe tenderuesit dhe organizon për to një **program** kombëtar trajnimesh. Në vitin 2005 u organizuan 59 seminare të tilla në të cilat morën pjesë 2025 persona. PMB merr gjithashtu pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter akademik dhe në veprimtari të tjera në lidhje me ligjin e prokurimeve publike, me ekonominë, dhe politikat (në vitin 2005 u ndoqën 24 aktivitete të tilla).

**Drejtuesi** i PMB-së përfaqëson zyrën, vendos në lidhje me shpenzimet, nxjerr udhëzime të brendshme, dhe emëron dhe shkarkon punonjësit. **Zëvendësdrejtuesi** përfaqëson PMB-në në mungesë të drejtuesit. **Drejtorët e departamenteve** janë përgjegjës për punën e departamenteve të tyre. Drejtuesi i PMB-së emërohet nga Ministri i Financave pas konfirmimit që merr nga Kabineti i Ministrave. Zëvendësdrejtori dhe drejtorët emërohen nga drejtuesi. **Komisioni i shqyrtimit të Ankesave (CRC)** ngrihet me urdhër të drejtuesit për çdo ankesë të veçantë. Krahas CRC-së ekzistojnë edhe tre departamente:

1. Departamenti Juridik (8 punonjës) shqyrton ankesat e tenderuesve dhe përfaqëson PMB-në në gjykatë në rastet kur vendimet e CRC-së apelojnë.
2. Departamenti i Metodologjisë përbëhet nga një drejtor dhe tre seksione:
  - Seksioni i Metodologjisë (2 punonjës) i cili përgatit shpjegimet e zbatimit të PPL-së dhe këshillon entet kontraktuese dhe tenderuesit rreth zbatimit të PPL-së dhe të rregullave të tjera përkatëse.
  - Seksioni i Legjislacionit dhe i Çështjeve Europiane (3 punonjës), i cili përgatit projektligjet dhe rregulloret.
  - Seksioni i Kontrollit (2 punonjës), i cili monitoron zbatimin e PPL-së dhe shqyrton përputhshmërinë e procedurave të prokurimit me PPL-në për aplikimet e tenderuesve të cilat nuk mund të trajtohen në CRC-ë. Ai jep edhe mendimin e tij në lidhje me përputhshmërinë e procedurave të prokurimit me PPL-në me kërkesën e institucioneve të ndryshme të shtetit.
3. **Departamenti i Informacionit** (10 punonjës) përbëhet nga një drejtor dhe dy seksione: Seksioni i Njoftimit të Prokurimeve dhe i Statistikës (7 punonjës) dhe Seksioni i Zhvillimit të Sistemeve të Prokurimit (2 punonjës). I pari publikon njoftimet e kontratave dhe të vendimeve dhe grumbullon e shqyrton raportet statistikore të autoriteteve kontraktuese. I dyti merret me çështjet e zhvillimit të sistemit të prokurimeve.

**CRC-ë** trajton ankesat e tenderuesve dhe merr vendim për lejimin ose ndalimin nga hyrja në një kontratë prokurimi (të paktën 3 punonjës). **32 punonjësit** e zyrës përbëhen nga 18 nëpunës civilë dhe 14 punonjës. Afërsisht 50% kanë arsim juridik dhe rreth 25% kanë arsim ekonomik. Të gjithë i njohin prokurimet publike, përveç personelit që merret me çështje biznesi e administrate dhe llogaritarët. **Buxheti** i vitit 2006 prej 1362006 LVL (afërsisht 1.963.386 euro është pjesë e buxhetit të shtetit, me ndihmë të jashtme financiare prej 2 milion LVL (afërsisht 2.883.080 euro).

Disa funksione të caktuara kryhen nga disa institucione të tjera. **Agjencia Shtetërore e Prokurimit Elektronik** (10 punonjës) u ngrit në 2 janar 2006 me një dekret të Kabinetit dhe është përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e sistemeve elektronike të prokurimeve. Ajo është pjesërisht e varur nga **Ministri për Detyra Speciale për Çështjet e Qeverisjes Elektronike**. Drejtori drejton punën e agjencisë, menaxhon funksionimin e saj të përditshëm, përgatit një strategji, përfaqëson agjencinë, rekruton dhe shkarkon punonjësit dhe ka përgjegjësinë për shpenzimin e burimeve financiare. Drejtori emërohet nga ministri përmes një konkurrimi të hapur të njoftuar në gazetën zyrtare. Me çështjet juridike të sistemeve të reja të prokurimit elektronik merret një Drejtori e Prokurimeve i cili ka në përbërje një Seksion për Prokurimet dhe një Seksion të Marrëdhënieve me Publikun. Drejtorja e Mështetjes Teknike mbulon çështjet e teknologjisë së informacionit dhe mirëmban sistemin e prokurimit elektronik. Agjencia financohet pjesërisht përmes buxhetit të shtetit dhe pjesërisht përmes të ardhurave nga shërbimet e pagueshme të agjencisë dhe nga ndihma e huaj financiare. Për autoritetet kontraktuese, përdorimi i sistemeve të prokurimit elektronik është falas.

**Zyra për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit** është përgjegjëse për vlerësimin e konflikteve të interesit dhe të korrupsionit në procedurat e prokurimeve publike dhe për hetimin e rasteve të korrupsionit dhe të veprave të tjera penale në rastet e prokurimeve publike. PMB-ë dhe kjo zyrë bashkëpunojnë në fushën e prokurimit publik. Ato mund të auditojnë entet prokuruese.

**Zyra e Auditimit të Shtetit e Republikës së Letonisë** është një institucion i auditimit të lartë kolegjial dhe i pavarur. Ajo është një element themelor i sistemit të financiar të shtetit, që u shërben interesave të shoqërisë duke siguruar garanci në mënyrë të pavarur për përdorimin efektiv dhe të dobishëm të burimeve të qeverisjes qendrore e vendore. Zyra e Auditimit të Shtetit është një nga gjashtë institucionet shtetërore kushtetuese në Letoni. Një nga detyrat e saj është të auditojë aktivitetet e prokurimeve publike të enteve kontraktuese.

**Ministria e Ekonomisë** është përgjegjëse për koncesionet dhe PPP-në.

Kontrolli *ex ante* i kontratave të prokurimeve publike është një funksion i **Agjencisë Qendrore të Financave dhe Kontraktimit**, e cila në vitin 2005 kontrolloi 263 kontrata.

**Hartimi i legjislacionit parësor e dytësor** është përgjegjësi e **Ministrit të Financave**. Disa grupe interesi (si për shembull, Shoqata e Ndërtimit të Letonisë, Shoqata e Qeverisjes Vendore dhe Rajonale të Letonisë, Shoqata e Tregtarëve të Autorizuar të Automobilitëve të Letonisë, Shoqata e Siguruesve të Letonisë, dhe Organizata Liria e Blertë) kontribuojnë në zhvillimin e sistemit të prokurimeve publike duke përgatitur dokumente prokurimi ose duke marrë pjesë në procesin e hartimit të legjislacionit.

Në Letoni nuk ekziston një organizatë e vetme për **blerjet në nivel qendror**. Në vitin 2004, ekzistonin 20 autoritete kontraktuese të cilat kryen 128 procedura të centralizuara blerjesh për 134 ente kontraktuese. Në vitin 2004, një vlerë prej 21.7 LVL (31.3 milion euro), e cila përbënte 4% të tregut të prokurimeve, u shpenzua për të bërë blerje në nivel qendror.

**Shqyrtimi gjyqësor** i vendimeve të prokurimeve publike kryhet përmes gjykatave administrative.

### 13. Lituania

Lituania ka një strukturë të **centralizuar** të prokurimeve publike në të cilën Zyra e Prokurimeve Publike (PPO) kryen shumicën e funksioneve kryesore. Megjithatë, disa funksione kryhen nga institucione të tjera, ndër të cilët dallon Ministria e Ekonomisë, shpesh në bashkëpunim me PPO-në.

**Zyra e Prokurimeve Publike** është përgjegjëse për përgatitjen e udhëzimeve dhe të instruksioneve duke përgatitur një raport vjetor për qeverinë mbi funksionimin e sistemit të prokurimeve publike dhe duke grumbulluar të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera. Nga viti 2007, ajo do të administrojë listat e kualifikimit të PPO-së. Detyra të tjera përfshijnë dhënie të këshillave juridike dhe këshillave të tjera për entet kontraktuese, për shërbimet në infrastrukturë dhe tenderuesit dhe organizimin e një programi kombëtar trajnimit për sektorët publikë dhe ato të shërbimeve infrastrukturore dhe tenderuesit. Megjithatë,

konsulentët privatë janë gjithashtu aktivë në fushë. Në vitin 2005, PPO organizoi 11 seminare për 225 pjesëmarrës nga autoritetet kontraktuese dhe ofruesit, duke shpenzuar rreth 78.000 euro për këtë aktivitet. Përfaqësuesit e PPO-së morën pjesë në pesë aktivitete akademike kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në aktivitete të tjera për ligjin e prokurimeve publike, ekonominë dhe politikën.

**Ministria e Ekonomisë** është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit parësor, hartimin e politikës së prokurimeve dhe këshillimin e qeverisë mbi politikën e prokurimit publik. Kjo ministri është pika e kontaktit për Komisionin dhe e ngarkuar për të dhënë kontributin kombëtar në GPA. **Ministria dhe PPO** së bashku janë përgjegjëse për kontributin kombëtar në komisionet këshillimore të BE-së, për pjesëmarrjen në PPN-ë dhe për kontributin kombëtar në UNCITRAL. Draftet e legjislacionit janë të disponueshme në internet. Draftet e legjislacionit iu dërgohen edhe ministrive përkatëse, institucioneve bashkiake dhe shoqatave të sipërmarrësve të cilët kanë mundësinë të bëjnë komente. Ky proces parashikohet në Rregulloren mbi Aktivitetin e Qeverisë.

Hartimi i legjislacionit dytësor është përgjegjësi e PPO-së dhe e ministrive përkatëse. Hartimi i procedurave dhe i rutinave standarde dhe hartimi i dokumenteve standarde të tenderave dhe i dokumenteve të kontratave kryhet nga PPO në bashkëpunim me institucione të tjera, për shembull, **Agjencia Qendrore e Menaxhimit të Projekteve**.

Aktualisht nuk ekziston një **organ qendror blerjesh**, por qeveria është duke planifikuar të miratojë vendimet e përshtatshme.

PPO kryen një nivel të kufizuar kontrolli mbi procedurat e prokurimeve publike. Pas një ankese ndaj një enti kontraktues, PPO vepron si një **bord apeli**. Kjo kryhet në kontekstin e një shqyrtimi administrativ të vendimeve të prokurimeve publike duke filluar që nga shkurti i vitit 2006, por vetëm për aspekte të veçanta të procedurave. Megjithatë, organet shqyrtuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis tenderuesve dhe enteve kontraktuese janë **gjykatat civile**. Në vitin 2005, shqyrtimit gjyqësor iu nënshtruan dy kontrata. Gjoha mund të vendosen për ata zyrtarë të përfshirë drejtpërdrejt në procedurat e prokurimeve dhe jo mbi autoritetet kontraktuese. Për më tepër, ata zyrtarë mund të përjashtohen nga pjesëmarrja në komisionet e tenderave për një vit. Në vitin 2005, masa të tilla disiplinore u morën për 22 punonjës kontraktimesh. Aktivitetet e prokurimeve publike të enteve kontraktuese i auditon PPO dhe përmes kontrollit të shtetit.

#### **14. Luksemburgu**

Luksemburgu ka një strukturë **gjysmë të centralizuar** të prokurimeve publike ku drejton një ministri e cila kryen shumë prej aktiviteteve të rëndësishme si edhe disa funksione në bashkëpunim me institucione të tjera.

**Ministria e Punëve Publike** është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit parësor, për hartimin e politikës së prokurimeve, dhe në përgjithësi për këshillimin e qeverisë në lidhje me politikën e prokurimeve. Dhoma e Tregtisë dhe Dhoma e Artizanateve kanë mundësinë të komentojnë për projektligjet për prokurimet publike. Ministria është edhe pikë kontakti për Komisionin, përgjegjëse për kontributin kombëtar në komisionet këshillimore të BE-së, për pjesëmarrjen në PPN-ë, për kontributin kombëtar në GPA dhe për përfaqësimin në nivel ndërkombëtar. Ajo përgatit një raport vjetor për qeverinë dhe lehtëson prokurimet elektronike përmes një portali qendror në internet. Grumbullimi i të dhënave statistikore dhe i të dhënave të tjera nuk është i centralizuar, përveç statistikave që kanë të bëjnë me direktivat e BE-së të cilat i grumbullon Ministria e Punëve Publike. Në ministri, me çështjet e prokurimeve publike merren vetëm nëpunës civilë.

Midis **Ministrisë së Punëve Publike dhe institucioneve të tjera ndahen një numër aktivitete**. Përgatitja e udhëzimeve dhe e instruksioneve kryhet brenda Ministrisë së Punëve Publike, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komisionit të Tenderave. Edhe Ministria e Punëve Publike, edhe Ministria e Punëve të Brendshme japin këshilla juridike dhe këshilla të tjera për entet kontraktuese dhe shërbimet në infrastrukturë. Këshilla juridike dhe këshilla të tjera për tenderuesit jepen nga Ministria e Punëve Publike, nga korporatat tregtare dhe nga Dhoma e Tregtisë.

Hartimi i **dokumenteve standarde të tenderave** për punët kryhet nga Qendra për Kërkime. **Lejet** për procedura më pak konkurruese, për përdorimin e përjashtimeve dhe për zgjatjet kohore, për përdorimin e procedurave të përshpejtuara, etj., mund të merren nga Ministria e Financave, Drejtoria e Kontrollit të Financave (*ex ante*). Lejet për kontratat më të rëndësishme merren nga Komisioni i Tenderave (*ex ante*) dhe nga Gjykata e Llogarive (Cour des Comptes) (*ex post*).

Buletini kombëtar për prokurimet publike nuk ekziston dhe kontratat **publikohen** vetëm në gazetën kombëtare. Vetë entet kontraktuese i komunikojnë njoftimet e tyre në Gazetën Zyrtare. Megjithatë, njoftimet nga të gjitha autoritetet kontraktuese që ekzistojnë në Luksemburg do të publikohen në portalin qendror të internetit të Ministrisë së Punëve Publike.

Instituti Kombëtar i Administratës Publike (Ministria e Funkcionimit Publik dhe e Reformës Administrative) organizon një **program kombëtar trajnimesh** për sektorët publikë dhe të infrastrukturës dhe tenderuesit. Kurset janë me pjesëmarrje të detyrueshme për të trajnuarit dhe janë pjesë e arsimimit të vazhduar.

**Organi shqyrtues** i prokurimeve publike në kuptim të Nenit 2 (8) të Direktivës 89/665/EEC është gjykata administrative (me mundësi për apelim), ndërsa çështjet urgjente i dërgohen kryetarit të gjykatës administrative. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis tenderuesve dhe entit kontraktues ekziston një Ombudsman - Ndërmjetës krahas Komisionit të Tenderave.

Në Luksemburg nuk ekziston një **organ qendror blerjesh**, përveç rastit të furnizimit me materiale të teknologjisë së informacionit dhe pajisjeve të zyrave për organet qeveritare.

## 15. Malta

Malta ka një strukturë të **centralizuar** të prokurimeve publike ku shumicën e funksioneve i ushtron Departamenti i Kontratave (DC) në La Valeta. Institucione të tjera dhe autoritete kontraktuese në nivel vendor kryejnë një numër të vogël detyrash. Roli qendror i DC-së si këshilltar për autoritetet dhe entet e tjera kontraktuese mbi prokurimin publik konsiderohet si pika më e fortë e sistemit të Maltës.

**Departamenti i Kontratave** është i varur, por përbën një pjesë integrale të Ministrisë së Financave. Ai u ngrit mbi bazën e Ligjit për Financat dhe Auditimin (1962) dhe Kapitullit 174 Shënimeve Ligjore 177 dhe 178 (2005). Ai ka një staf prej 40 nëpunësish civilë të punësuar me kohë të plotë dhe një bordi apeli të ndarë e të pavarur të përbërë prej 4 punonjësish me kohë të pjesshme të emëruar nga Kryeministri. DC-ë është përgjegjës për hartimin e **procedurave dhe të rutinave standarde**, për hartimin e **politikës** së prokurimeve, për hartimin e legjislacionit parësor e dytësor, për përgatitjen e udhëzimeve dhe të instruksioneve, për kontributin në komisionet e BE-së dhe në PPN-në e Maltës, për përgatitjen e **raportit vjetor** për qeverinë në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimeve publike, për grumbullimin e të dhënave statistikore dhe të të dhënave të tjera, dhe për dhënien e lejes për përdorimin e procedurave më pak konkurruese dhe për përdorimin e përjashtimeve, të zgjatjeve, të procedurave të përshpejtuara, etj. (megjithëse në vitin 2005 nuk ishin bërë kërkesa të tilla), dhe për **këshillimin** e qeverisë në lidhje me politikën e prokurimeve publike. Për më tepër, në vitin 2005 u shpërndanë 47 zëra të publikuar në lidhje me legjislacionin dhe politikën e prokurimeve publike.

DC-ë është në të njëjtën kohë edhe **njësia qendrore e blerjeve** për të gjitha kontratat mbi 20000MTL (afërsisht 46708 euro) për 133 ente. Ky shërbim ofrohet falas. Për më tepër, DC-ë është përgjegjëse për administrimin e buletinit kombëtar të prokurimeve publike, përfshirë këtu edhe publikimin dhe kontrollin e njoftimeve për kontrata. Megjithatë, vetëm 2.5% e të gjitha kontratave kanë të bëjnë me blerjet qendore, pjesa tjetër kryhen nga autoritetet vendore. Në vitin 2005, nga DC u përpunuan 485 kontratat dhe 112 njoftime të enteve kontraktuese dhe të shërbimeve infrastrukturore u komunikuan në Gazetën Zyrtare përmes DC-së. Futja e prokurimit elektronik në të gjithë qeverinë e Maltës përbën një reformë madhore.

DC-ë është gjithashtu përgjegjëse për **kontrollin** e prokurimeve publike: në vitin 2005, kontrollit *ex ante* iu nënshtruan 452 subjekte dhe DC-ë ndihmoi në zgjidhjen e 36 mosmarrëveshjeve midis enteve kontraktuese dhe kontraktorëve; 34 raste iu nënshtruan procedurës së shqyrtimit përmes **Bordit të Apelit**.

Dhënia e këshillave juridike dhe e këshillave të tjera për entet kontraktuese dhe shërbimet infrastrukturore bëhet bashkarisht midis DC-së dhe **Prokurorit të Përgjithshëm** (Ministria e Drejtësisë), ndërsa këshillimi juridik dhe këshilla të tjera për tenderuesit ofrohet kryesisht nga **Dhoma e Tregtisë. DC-ë bashkë me vetë autoritetet kontraktuese**, është përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderave dhe të kontratave. Bashkë me **Departamentin e Politikës Ekonomike** ai ka për detyrë të japë kontributin kombëtar në GPA: **Ministria e Financave** është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit parësor e dytësor. Pikë kontakti për Komisionin është **Përfaqësimi i Përhershëm i Maltës në BE**.

Malta **nuk** mban lista të zeza, lista të kualifikuarish, lista të tenderuesve të çertifikuar, lista të trajnerëve të certifikuar për prokurimet publike, të organeve ose kompanive të trajnimit. Ajo nuk ka as ndonjë program kërkimi në lidhje me ligjin e prokurimeve publike, me ekonominë ose politikën dhe as nuk merr pjesë në aktivitete akademike kombëtare ose ndërkombëtare dhe në veprimtari të tjera në lidhje me ligjin e prokurimeve publike, ekonominë ose politikën apo të marrë në provim punonjësit e prokurimeve.

Funksioni i **trajnimit** i DC-së është disi i kufizuar. Në vitin 2005 u krye një program kombëtar dyditor trajnimi për 40 zyrtarë. Dy zyrtarëve të Njësisë për BE-në iu dha trajnim specifik nëpërmjet një seminari Hyrës për praktikantët në lidhje me Rregullat, Politikën dhe Praktikat Europiane të Prokurimeve Publike nga ana e Institutit European të Administratave Publike (EIPA) në Maastricht dhe dy zyrtarë të tjerë ndoqën një seminar trajnimi në lidhje me Kushtet e Përgjithshme të Kontratave të FIDIC në Bruksel.

DC-ë është i **nënndarë** në seksionet e mëposhtme: Seksioni i Parakontratave (7 punonjës), Seksioni i Paskontratave (2 punonjës), Sekretariati i Komisionit të Përgjithshëm të Kontratave (2 punonjës), dhe Administrata e Përgjithshme (10 punonjës). **Seksioni i Parakontratave** shërben për të gjitha procedurat administrative, që nga publikimi i njoftimeve për tendera deri tek nxjerrja e letrës së pranimit ose të mbylljes së kontratës. **Seksioni i Paskontratave** shërben për çdo çështje që del gjatë zbatimit të kontratës, përfshirë edhe procedimin ligjor. **Sekretariati** i Komisionit të Përgjithshëm të Kontratave është përgjegjës për inspektimin e raporteve vlerësuese para se ato të dërgohen në Komision si edhe për njoftimin e tenderuesve të pasuksesshëm. **Njësia për BE-në** është përgjegjëse për të gjitha prokurimet që financohen fondeve të BE-së. Administrata e Përgjithshme merret me të gjitha llogaritë dhe burimet njerëzore të DC-së.

Formimi arsimor i 40 **punonjësve** varion midis arsimit të mesëm dhe atij universitar. 16 punonjës njohin prokurimet publike në vend dhe ato të BE-së si edhe shumë aspekte më teknike të prokurimeve. Fakti se zyrtarëve të prokurimeve dhe punonjësve kontraktues nuk u kërkohet të kenë një formim arsimor specifik në prokurimet publike konsiderohet një pikë e dobët e sistemit të Maltës. DC-ë **financohet** nga buxheti i përgjithshëm i qeverisë i cili shkon në 493000 MTL (afërsisht 1.15 milion euro) për vitin financiar 2006. Përlllogaritjet e buxhetit përgatiten aty nga muaji shtator të çdo viti dhe dërgohen pastaj në Ministrinë e Financave. Buxheti miratohet në përputhje me përparësitë e vendit. Buxheti i rishikuar miratohet nga parlamenti diku nga fundi i vitit kalendarik.

## 16. Polonia

Polonia ka një strukturë të **centralizuar** të prokurimeve publike me një institucion kryesor në nivel kombëtar për të gjitha funksionet ose për funksionet më kryesore (Zyra e Prokurimeve Publike).

**Zyra e Prokurimeve Publike e Polonisë (PPO)** u krijua në 1 janar 1995, pas miratimit të Ligjit mbi Prokurimet Publike (PPL) në 10 qershor 1994. PPO luan rolin e politikëbërësit dhe të koordinuesit për të gjithë sistemin e prokurimeve publikë. Detyrat kryesore të PPO-së janë publibikimi i Buletinit zyrtar të Prokurimeve Publike (PPB, Biuletyn Zamówień Publicznych), në të cilin publikohen njoftimet e kontratave (për vlerat mbi kufijtë e përcaktuar në PPL), përgatitja e projektligjeve në fushën e prokurimeve publike, rregullimi i procedurave të apelit në përputhje me PPL-ë, kontrolli i procedurave të tenderave të kryer nga autoritetet kontraktuese, përgatitja e programeve të trajnimit, organizimi dhe nxitja e trajnimeve në fushën e prokurimeve publike dhe këshillimi i qeverisë për politikën e prokurimeve publike.

Sipas PPL-së, **kryetari i PPO-së** duhet të emërohet nga Kryeministri ndërmjet kandidatëve të përzgjedhur me një konkurrim të hapur. Kryetar mund të jetë vetëm një person me arsim dhe njohuri mbi funksionimin e sistemit të prokurimeve publike. Kohëqëndrimi i kryetarit në detyrë është pesë vjet me të drejtë ripërsëritje të tij vetëm një herë tjetër. Ai/ajo mbetet në zyrë deri në emërimin e pasuesit. Kryetari luan rolet e mëposhtme:

- të përgatisë projektet e akteve normative mbi kontratat publike;
- të marrë vendime për çështje të veçanta të parashikuara në PPL-ë;
- të publikojë njoftimet e parashikuara sipas PPL-së në Zyrën e Prokurimeve Publike;
- të mbajë dhe të publikojë një listë të arbitrave që shqyrtojnë apelimet kundër mosmarrjes parasysh ose refuzimit të ankesave, ashtu siç parashikohet në procedurat për dhënien e kontratave në Buletinin e Prokurimeve Publike;
- të mbajë dhe të publikojë një listë të organizatave të autorizuara për të dërguar masa për zbatimin e ligjit në Zyrën e Prokurimeve Publike;
- të garantojë funksionimin e sistemit të masave të mbrojtjes ligjore;
- të përgatisë programet e trajnimit dhe të organizojë e të nxisë trajnimin në fushën e prokurimeve publike dhe të përgatisë e të shpërndajë kritetere standarde për vlerësimin e përmbajtjes së trajnimit;
- të shpërndajë formularët standard të kontratave të prokurimeve publike, rregulloret dhe dokumente të tjera që përdoren në dhënien e kontratave publike;
- të mbikëqyrë rregullat e sistemit të prokurimeve publike dhe në veçanti të kontrollojë procesin e dhënies së kontratave brenda fushës së veprimit të parashikuar në Ligjin për Prokurimet Publike;
- të përhapë parimet e etikës profesionale të personave që kryejnë detyra brenda sistemit të prokurimeve publike;
- të garantojë zbatimin uniform të legjislacionit mbi kontratat publike veçanërisht nëpërmjet përhapjes së vendimeve të gjykatave dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese;
- të ruajë bashkëpunimin ndërkombëtar për çështje që lidhen me prokurimet publike;
- të analizojë funksionimin e sistemit të prokurimeve publike;
- të përgatisë dhe të dorëzojë në Këshillin e Ministrave (të Polonisë) dhe në Komisionin Europian raporte vjetore në lidhje me funksionimin e sistemit të kontratave publike.

**Dy zëvendëskryetarët** aktualë të PPO-së emërohen dhe pezullohen nga Kryeministri me kërkesën e kryetarit të PPO-së. Kryetari mbështetet nga një staf prej 115 vetësh, të organizuar në shtatë departamente.

**Departamenti Juridik** (19 punonjës) ofron shërbime ligjore për brenda dhe jashtë institucionit për PPO-në nëpërmjet 4 njësive: Njesisë për legjislacionin, Njesisë për Opinionet Ligjore, Njesisë për Vendimet Administrative dhe Njesisë për të Drejtën Europiane. Aktivitetet e Njesisë për Legjislacionin (3 punonjës) përfshijnë përgatitjen e projektligjeve dhe pjesëmarrjen në procesin legjislativ për aktet ligjore të përgatitura nga institucione të tjera qeveritare të lidhura me prokurimet publike. Kjo njësi ka detyrimin të **konsultohet për projektligjet** me partnerët socialë, të tillë si OJF-të, sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve. Zakonisht organizohen takime të veçanta konsultative. Projektligjet bëhen të disponueshme edhe në uebsajtin e PPO-së. Njësia e Opinioneve Ligjore (5 punonjës) merret me shpjegimin dhe interpretimin e dispozitave të PPL-së, me shpërndarjen e interpretimeve ligjore dhe përgatitjen e kushteve të përgjithshme të kontratave, të modeleve standarde të kontratave dhe të udhëzimeve në lidhje me procedurat e dhënies së kontratave. Njësia e Vendimeve Administrative (5 punonjës) përgatit vendimet administrative që do të nxirren nga kryetari në përputhje me PPL-në dhe analizon të dhënat përkatëse.



Aktivitetet e Njesisë për të Drejtën Europiane (3 punonjës) përfshijnë monitorimin e përputhshmërisë së PPL-së me direktivat e BE-së, përgatitjen e qëndrimeve të Polonisë në lidhje me rastet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë (ECJ) përsa i përket prokurimeve publike dhe analizën e ndryshimeve dhe zhvillimeve në të drejtën ndërkombëtare dhe në marrëveshjet në fushën e prokurimeve publike. Dokumentet standarde të tenderave dhe të kontratave hartohen nga konsulentë të jashtëm dhe pastaj verifikohen dhe përditësohen nga Departamenti Juridik.

**Departamenti i Kontrollit** (23 punonjës) kryen detyra që lidhen me kompetencat e kontrollit të kryetarit të cilat parashikohen në PPL-ë dhe organizon bashkëpunimin e PPO-së me institucione të tjera të kontrollit, të tilla si Dhoma e Lartë e Kontrollit ose dhomat rajonale të auditimit. Ky departament është përgjegjës për kryerjen e kontrollit *ex ante* dhe të atij *ex post* për procedurat e dhënies së kontratave të veçanta mbi bazën e informacionit dhe të dokumenteve të siguruara nga entet që i japin kontratat dhe nga burime të tjera. Në vitin 2005, kontrollit *ex ante* iu nënshtruan 371 kontrata. Departamenti është i ndarë në katër njësi: Njësia e Kontrollit *ex ante* të Kontratave për Mallrat dhe Shërbimet; Njësia e Kontrollit *ex ante* të Kontratave për Punët; Njësia e Kontrollit *ex ante* të Kontratave në Shërbimet e infrastrukturës dhe Njësia e Kontrollit *ex post*.

**Departamenti i Trajnimit dhe i Publikimeve** (17 punonjës) është përgjegjës për aktivitetet trajnuese, për shpërndarjen e materialeve të trajnimit, dhe për botimin e Buletinit të Prokurimeve Publike (PPB-së). Ai ka dy njësi: Njësia e Trajnimit dhe Publikimeve Edukative dhe Njësia e PPB-së. **Njësia për Trajnimin dhe Publikimet Edukative** (8 punonjës) shpërndan informacion për parimet dhe dispozitat e prokurimeve publike, organizon seminare dhe aktivitete trajnuese për arbitrat, përpunon publikimet dhe guidat për çështjet e zbatimit të dispozitave të prokurimeve publike dhe ofron shërbimin e uebsajtit të PPO-së. Ajo merr pjesë gjithashtu edhe në programet e mbështetjes të zbatimit të cilat ndihmojnë për zhvillimin e sistemit të prokurimeve publike në Poloni. Ajo kontrollon dhe shpërndan publikimet e përgatitura nga stafi i PPO-së ose nga konsulentët e jashtëm. Në vitin 2005, ajo organizoi rreth 80 kurse trajnimi për 2500 persona të financuara përmes buxhetit të PPO-së dhe 187 kurse për 5400 persona të financuara nga buxheti i PHARE. Buxheti i PHARE për trajnimet dhe botimet ka qenë 1.5 milion euro (buxheti i përgjithshëm i një programi asistence). Detyrat kryesore të **Njesisë së Buletinit të Prokurimeve Publike** (9 punonjës) lidhen me publikimin e PPB-së (sipas Nenit 14a të PPL-së) i cili është një burim zyrtar i informacionit për kontratat publike në Poloni. Njësia e PPB-së merr dhe kontrollon korrektësinë formale të njoftimeve të prokurimit që do të publikohen në Buletin, monitoron shpërndarjen e Buletinit të printuar dhe përgatit versionin elektronik që do të postohet në uebsajtin e PPO-së (7 punonjës). Në vitin 2005 u publikuan 36.029 njoftime. Në vitin 2005, autoritetet dhe entet kontraktuese polake publikuan 12.380 kontrata dhe njoftime për konkurrim në Gazetën Zyrtare të BE-së.

**Departamenti i Bashkëpunimit, i Studimeve dhe i Analizave Ndërkombëtare** (6 punonjës) është përgjegjës për kontaktet ndërkombëtare të PPO-së dhe për bashkëpunimin e tij me autoritetet përkatëse në vende të tjera dhe organizata ndërkombëtare që merren me çështjet e prokurimeve publike. Departamenti grumbullon dhe shpërndan informacion për dispozitat dhe procedurat e prokurimeve publike në vendet e tjera dhe në nivel ndërkombëtar. Ai gjithashtu analizon funksionimin e sistemit të prokurimeve publike të Polonisë, tregun e prokurimeve dhe zhvillimin e tij të ardhshëm. Ai përgatit raporte vjetore mbi funksionimin e sistemit të prokurimeve publike, të cilat pastaj dërgohen në Këshillin e Ministrave (3 punonjës). Departamenti është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e raporteve statistikore që dorëzohen në Komisionin Europian sipas përcaktimeve të dispozitave përkatëse të direktivave të BE-së. Dhe, së fundi, departamenti grumbullon të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera (3 punonjës).

**Zyra e Apelimit** (11 punonjës) kryen detyra që lidhen me procedurat e apelimit sipas përcaktimeve të PPL-së dhe ofron shërbime për panelet e apelimit. Ankesat kundër vendimeve të prokurimit duhet t'u bëhen enteve kontraktuese në fjalë (në shkallën e parë) përpara se panelet e pavarura të apelimit të PPO-së të shqyrtojnë rastin në shkallën e dytë. Gjykatat rajonale (krejtësisht të ndara nga PPO-të) shqyrtojnë rastin në shkallën e fundit. Apelimet shqyrtohen nga panele që përbëhen nga tre arbitra të emëruar nga kryetari i PPO-së nëpërmjet një përzgjedhjeje publike. Në vitin 2005, u bënë 4.094 apeline, 563 prej të cilave

shkuan deri në shkallën e tretë. Aktivitetet e zyrës mbulojnë: mbajtjen e regjistrit të arbitrave dhe të arkivit të rasteve të apeluara, përgatitjen e projekt vendimeve (që do të nxirren nga kryetari) për hyrjen në dhe heqjen nga regjistri i arbitrave. Kjo njësi bashkëpunon edhe me Departamentin e Trajnimit dhe të Publikimeve për të siguruar trajnim për arbitrat.

**Zyra e Organizimit dhe e Financave** (23 punonjës) mbështet aspektet e kontabilitetit, administrative dhe organizacionale të PPO-së. Detyrat përfshijnë hartimin e projekt buxheteve të PPO-së, të planeve të investimit dhe të grafikëve të shpenzimeve, dhe përgatitjen e raporteve dhe informacionit për shpenzimin e buxhetit. Zyra merr dhe shpërndan korrespondencën e jashtme, grumbullon dhe ruan dokumentet zyrtare dhe menaxhon arkivat e PPO-së. Kjo njësi administron edhe rrjetin e brendshëm kompjuterik si edhe uebsajtin e PPO-së.

Departamenti Juridik (Njësia për të Drejtën Europiane) (3 punonjës) është **pika e kontaktit për Komisionin** dhe është përgjegjëse për kontributin kombëtar në komisionet këshillimore të BE-së. Pjesëmarrja në PPN-në (3 punonjës) dhe kontributi kombëtar në UNCITRAL (1 punonjës) organizohen gjithashtu nga PPO përmes Departamentit të Bashkëpunimit, të Studimeve dhe të Analizave Ndërkombëtare. Kontributi Kombëtar në GPA (3 punonjës) kryhet përmes Departamentit Juridik (Njësia për të Drejtën Europiane). **Përfaqësimi tjetër ndërkombëtar** është përgjegjësi e Departamentit të Bashkëpunimit, të Studimeve dhe të Analizave Ndërkombëtare. **Këshillat ligjore dhe këshilla të tjera** për entet kontraktuese, shërbimet në infrastrukturë dhe tenderuesit ofrohen nga ndihma në tavolinë e PPO-së dhe nga Departamenti Juridik (Njësia e Opinioneve Ligjore), i cili jep mendime dhe interpretime për legjislacionin për prokurimet publike. Këshillim ligjor dhe këshilla të tjera ofrohen gjithashtu edhe nga firma private konsulence.

Të gjithë nëpunësit civilë dhe pothuajse të gjithë punonjësit e PPO-së kanë një diplomë universitare dhe shumë janë juristë. Në veçanti, stafi i Njesisë për të Drejtën Europiane (3 punonjës) dhe një pjesë e stafit të Departamentit të Bashkëpunimit, të Studimeve dhe të Analizave Ndërkombëtare (3 punonjës) e njohin mirë të drejtën europiane. I gjithë stafi i Departamentit Juridik, të Kontrollit, të Bashkëpunimit, të Studimeve dhe të Analizave Ndërkombëtare dhe i Departamentit të Trajnimeve dhe Publikimeve e njohin Ligjin e Prokurimeve Publike. Aspektet financiare dhe teknike të prokurimeve njihen nga disa punonjës me përvojë në autoritetet kontraktuese. Buxheti fillestar i PPO-së (pra fondet që jepen nga buxheti i shtetit) në vitin 2005 ishte afërsisht 9.5 milion PLN (afërsisht 2.37 milion euro). Ky buxhet është pjesë e buxhetit të shtetit dhe përgatitet në përputhje me ligjin për buxhetin. Kostot e procedurave të apelit mbuloohen nga tarifat e detyrueshme të regjistrimit.

**Këshilli i Prokurimeve Publike (PPC)** është një organ këshillimor i Kryetarit të PPO-së. PPC përbëhet nga 10-15 anëtarë të emëruar nga Kryeministri. Aktualisht, PPC-ë ka 14 anëtarë. Grupet parlamentare, organizatat kombëtare vetëqeverisëse dhe organizatat kombëtare të sipërmarrësve propozojnë kandidatë për në PPC-ë. Kryeministri emëron anëtarët e PPC-së. Kryetari i këshillit emërohet nga Kryeministri dhe është njëri nga anëtarët. Nënkryetari emërohet ndër anëtarët e këshillit. Roli i PPC-së është të shprehë mendimet e veta për çështje veçanërisht të rëndësishme në lidhje me sistemin e prokurimeve publike që i paraqiten nga Kryetari i PPO-së. Këshilli jep mendimin e vet për aktet normative në lidhje me kontratat publike, jep mendim për raportet vjetore të Kryetarit të PPO-së në lidhje me funksionimin e sistemit të kontratave publike dhe përcakton parimet e etikës profesionale për personat që kryejnë detyrat e specifikuar në PPL-ë brenda sistemit të kontratave publike.

Një numër i kufizuar detyrash kryhen jashtë PPO-së. Rastet e hetimit të korrupsionit dhe të veprave të tjera peale në prokurimet publike janë përgjegjësi e **Prokurorëve Publikë**. Në vitin 2005, Kryetari i PPO-së informoi **Agjentin për Disiplinën e Financave Publike** për rreth 18 shkelje të tilla. Agjenti përkrahet dhe inkurajohet të ndërmarrë veprime disiplinore kundër punonjësve kontraktues që shkelin PPL-në. Mbi bazën e një amendamenti të PPL-së i cili ka hyrë në fuqi në 25 maj 2006, Kryeministri mund të caktojë një institucion të luajë rolin e një **organi qendror blerjesh** për ente të tjera kontraktuese. Meqë ky është një rregull i ri, deri tani nuk ka ende ndonjë organ të caktuar i cili të jetë një organ qendror blerjesh. Gjykatat rajonale kanë detyrën e **shqyrtimit gjyqësor**.

## 17. Portugalia

Portugalia ka një strukturë të **decentralizuar** të prokurimeve publike e cila përfshin shumë institucione. Megjithatë, sistemi pritet të ecë drejt një strukture prokurimesh më të centralizuar. Ajo që ia vlen të vihet në dukje është se ekziston një plan për të ngritur një **Unidade Nacional de Compras (UNC, Organ Qendror për Prokurimet Publike)**. Kjo do të koordinojë prokurimet publike në nivel kombëtar dhe do të garantojë koordinimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave kombëtare midis departamenteve të prokurimeve publike të ministrive të ndryshme, si edhe do të udhëheqë procesin e prokurimeve elektronike. Portugalia e ka organizuar pjesërisht strukturën e prokurimeve të saj publike në mënyrë vertikale me Câmara Municipal dhe Junta de Freguesia dhe Regiões Autonomas de Açores e Madeira, të cilat kanë pavarësi për prokurimet publike në zonat e tyre.

Aktualisht, **Direção Geral dos Assuntos Comunitários (DGAC)** është pika e kontaktit për Komisionin dhe ky organizëm është përgjegjës për kontributin kombëtar në UNCITRAL. Kontributi kombëtar në komisionet këshillimore të BE-së organizohet nga **Direção Geral do Património (DGP)** për mallra dhe shërbime si dhe nga **Instituto de Mercados de Obras Públicas e Particulares Imobiliárias (IMOPPI)** për punët. DGAC, DGP dhe IMOPPI marrin pjesë në PPN-ë, ndërsa kontributi kombëtar në GPA koordinohet përmes DGAC dhe DGP. DGP dhe IMOPPI grumbullojnë të dhënat statistikore dhe të dhëna të tjera.

Hartimi i **legjislacionit** parësor, hartimi i procedurave dhe rutinave standarde si edhe formulimi i politikave të prokurimit janë të gjitha detyra të **qeverisë**. Departamentet e caktuara për të hartuar legjislacionin i dërgojnë projektet e tyre tek ministri i kabinetit, i cili i dërgon propozimet te palët e interesuara të cilat mund të bëjnë sugjerime për përmirësimin e dokumenteve. Qeveria ka nxjerrë një akt ligjor për dokumentet standarde të tenderave. Një sasi informacioni sigurohet përmes portalit [www.compras.gov.pt](http://www.compras.gov.pt), por nuk ekziston ndonjë tavolinë ndihme për prokurimet publike si të tilla. Program kombëtar trajnimesh nuk ka, megjithëse Instituto Nacional de Administração (INA) ofron disa kurse që kanë lidhje me këto çështje.

Organet qendrore të blerjeve janë të shumta. Një njësi e vogël e cila është pjesë e Ministrisë së Financave dhe e Administratës Publike (**Direção de Serviços do Aproveitamento Público – DSAP**, e integruar në **Direção General do Património – DGP**) përdor procedura ndërkombëtare për të krijuar kushte ekonomike dhe teknike për një numër produktesh që janë të rëndësishme për buxhetin e përgjithshëm. Kjo njësi ka edhe funksione të tjera përveç atyre që të prokurimeve. Ente të tjera prokuruese blejnë produkte sipas kushteve të marrëveshjeve kuadër të përcaktuara nga DSAP për kompjuterat, programet kompjuterike, rrjetet, veshjet, fotokopjuesit, letrën dhe artikuj të tjerë zyresh, naftë, shërbime të telefonisë celulare, automjete, dhe akomodime hotelerie dhe shërbime transporti. Ministria e Arsimit ka gjithashtu njësi për të blerë produkte për disa shkolla. Një njësi e ngjashme ekziston për sektorin e shëndetësisë (IGIF – Instituto de Gestão Financeira da Saúde), e cila raporton drejtpërdrejt në Ministrinë e Shëndetësisë. Në vitin 2005, vlera e kontratave shkoi në 224 milion euro dhe këto kontrata ishin dhënë mbi bazën e këtyre marrëveshjeve kuadër në një treg prokurimesh që vlente rreth 1.556 miliard euro. DGP-ë ndihmoi për 440 marrëveshje kuadër.

DGP-ë (e cila ka 9 nëpunës civilë me kohë të plotë që merren me prokurimet publike) ka një drejtor të përgjithshëm të emëruar nga ministri. Drejtuesit e institucioneve të tjera emërohen gjithashtu nga ministrat. Buxhetet e institucioneve të ndryshme janë pjesë e buxhetit të shtetit.

## 18. Rumania

Rumania ka një strukturë të **centralizuar** të prokurimeve publike të dominuar qartësisht nga Autoriteti Kombëtar për Rregullimin dhe Monitorimin e Prokurimeve Publike. Institucione të tjera kyç janë Inspektorati i Përgjithshëm për Komunikimin dhe Teknologjinë e Informacionit, Njësia për Verifikimin dhe Koordinimin e Prokurimeve Publike e Ministrisë së Financave dhe Këshilli për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve.

**Autoriteti Kombëtar për Rregullimin dhe Monitorimin e Prokurimeve Publike (NARMPP)** raporton drejtpërdrejt te Kryeministri. Funksionet e NARMPP-it përfshijnë: **këshillimin e qeverisë** për politikat e prokurimeve publike; hartimin e **legjislacionit** parësor e dytësor, të procedurave standarde, të formularëve të kontratave dhe të kushteve të përgjithshme për kontratat; lehtësimin e **marrëveshjeve kuadër**, të PPP-së dhe të koncesioneve; dhënien e **këshillave** ligjore dhe e këshillave të tjera për entet dhe shërbimet në infrastrukturë. Ai u vendos gjoha autoriteteve kontraktuese që shkelin rregullat e prokurimeve publike. NARMPP-i përgatit një **raport vjetor për qeverinë** në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimeve publike, mbështetur në të dhëna statistikore dhe në të dhëna të tjera. Ai publikon informacion mbi legjislacionin dhe politikat. Ai ka gjithashtu edhe **funksione trajnimi dhe kërkimi shkencor**, organizon një program kombëtar trajnimesh për sektorin publik dhe atë të shërbimeve infrastrukturore dhe lehtëson mësimdhënien dhe kërkimin e pavarur në universitete, në kolegjet trajnuese dhe nëpërmjet kompanive private. Për më tepër, ai organizon programin e kërkimeve mbi ligjin e prokurimeve publike, ekonominë dhe politikat dhe merr pjesë në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si edhe në veprimtari të tjera për ligjin e prokurimeve publike, ekonominë dhe politikat.

**Prokurimi elektronik** mbahet në përdorim nga NARMPP-i (në nivel politike) dhe nga **Inspektorati i Përgjithshëm për Komunikimin dhe Teknologjinë e Informacionit (GICIT)**, i cili është përgjegjës për pajisjet elektronike. NARMPP-i administron **Buletin Kombëtar të Prokurimeve Publike**, përfshirë këtu edhe refuzimin e reklamave që nuk plotësojnë kërkesat. GICIT administron teknikisht publikimin e njoftimeve dhe komunikon njoftimet e enteve kontraktuese në Gazetën Zyrtare (kjo ka rreth 30 punonjës).

NARMPP-i u krijua në qershor të vitit 2005 dhe u bë plotësisht funksional në nëntor 2005. Baza ligjore për ngritjen e tij është Ligji 111/2006 i cili miratoi Urdhërin e Urgjencës 74/2005. Ai kryesohet nga një **kryetar** dhe një **zëvendëskryetar** dhe të dy varen nga zyra e Kryeministrit. **Buxheti** i tij është pjesë e buxhetit të përgjithshëm të shtetit dhe shkon deri në 2.5 milion euro në vit (shifër e vitit 2005). NARMPP-i përbëhet nga **katër departamente**: Departamenti i Politikave dhe i Rregulloreve, Departamenti i Operacioneve, Departamenti i Monitorimit dhe Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Ekonomisë dhe Administrimit. Ky i fundit kryesohet nga një **sekretari i përgjithshëm** i NARMPP-it. Ekziston edhe një **bord këshillimor**. NARMPP-i aktualisht ka 70 punonjës me kohë të plotë, por numri i përgjithshëm i vendeve të punës që duhet të plotësohen sipas ligjit është 125. 90% e punonjësve kanë një diplomë universitare në fusha të ndryshme, përfshirë ekonominë, juridikun dhe inxhinierinë. Rregullat e administratës publike për ngritjen në detyrë vlejné edhe për NARMPP-in. Drejtuesit e nivelit të lartë dhe të mesëm në vitin 2005 kanë përfituar nga trajnimet e vazhdueshme të organizuara me mbështetjen e SIGMA-s. Për më tepër, kishte edhe një projekt binjakëzimi me vlerë 400.000 euro në vitin 2002, dhe projektet e asistencës teknike në vitin 2003 arritën vlerën 1.5 milion euro dhe në vitin 2006 arritën vlerën 2 milion euro (shih: [www.anrmap.ro](http://www.anrmap.ro)).

Njësia për Koordinimin dhe Verifikimin e Prokurimeve Publike (**UCVPP**) e **Ministrit së Financave Publike** kryen kontrole *ex ante* të kontratave të prokurimeve publike. Kjo ka filluar vetëm kohët e fundit me rastin e pranimit të Rumanisë në BE. Rreth 130 anëtarë të stafit janë duke punuar për këtë formë kontrolli në ministri.

**Instituti Kombëtar për Administratën** organizon seanca trajnimi për stafin e NARMPP-it.

**Këshilli Kombëtar për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Ligjore** (50 punonjës) në kuptim të Nenit 2 (8) të Direktivës 89/665/EEC është **organi i shqyrtimit të prokurimeve publike**. Vendimet e tij mund të apelojnë në Gjykatën e Apelit. **Zyrat e hetimit** merren me rastet e korrupsionit dhe të veprave të tjera penale në rastet e prokurimeve publike. **Gjykata e Auditimit** kontrollon aktivitetet e prokurimeve publike të enteve kontraktuese dhe ekzekuton shqyrtimin gjyqësor të vendimeve të prokurimeve publike.

## 19. Republika Sllovaqe

Republika Sllovaqe ka një strukturë të **centralizuar** të prokurimeve publike në të cilën Zyra për Prokurimet Publike (OPP) është e ngarkuar me shumicën e funksioneve. Për më tepër, disa funksione janë të organizuara **vertikalisht**: OPP-ë ka dy degë rajonale, por ato nuk kanë personalitet juridik.

**Zyra për Prokurimet Publike** u krijua në vitin 2000 me Ligjin për Prokurimet Publike (APP) Nr. 263/1999 të koleksionit. Megjithatë, baza aktuale ligjore e OPP-së është Ligji Nr. 25/2006 i 14 dhjetorit 2005, i cili përfaqëson zbatimin slllovak të Direktivave të reja të BE-së. OPP-ë harton **politikat** e prokurimeve, përgatit udhëzimet dhe instruksionet, dhe harton **legjislacionin** parësor e dytësor. Ky proces përfshin miratimin nga qeveria të Planit Vjetor të Detyrave Legjislative, dhe më pas OPP-ë përgatit projektin sipas këtij plani. Ministrinë dhe organet qendrore shtetërore kanë të drejtë të bëjnë komente. Pasi merren në konsideratë të gjitha këto komente, projekt-ligji i dërgohet qeverisë, e cila e miraton atë dhe e dërgon në parlament. Pastaj ligji firmoset nga Presidenti dhe më në fund publikohet. Detyrat e OPP-së përfshijnë edhe përgatitjen e koncepteve të prokurimeve publike, administrimin dhe mbikëqyrjen e prokurimeve publike, dërgimin e një raporti vjetor për aktivitetet e tij në qeveri dhe, me kërkesë, ia dërgon edhe një komisioni në parlament. OPP-ë njofton konvertimin në korona të kufijve monetarë për kontratat mbi kufijtë monetarë të direktivave, mban një listë të detyrueshme të tenderuesve, harton programet e formimit profesional e të vazhduar për prokurimet publike, lëshon çertifikata të kualifikimeve profesionale, mban një listë të personave të kualifikuar profesionalisht, ofron udhëzime metodologjike dhe harton procedurat dhe dokumentet standarde të tenderave, vendos gjoba dhe kryen aktivitete të tjera në përputhje me APP-në. OPP është gjithashtu edhe **pika e kontaktit për Komisionin** dhe jep kontributin e vet në komisionet këshillimore të BE-së dhe në grupet e punës që merren me prokurimet elektronike dhe statistikave. OPP-ë është anëtar i PPN-së dhe përgatit kontributin kombëtar për GPA-në. Ai ndihmon grupet e punës të CIRCA-s dhe kryen monitorimin e aktiviteteve të Laboratorit Mësimor të Prokurimeve Publike të BE-së, të Gazetës Zyrtare të BE-së, të SIMAP-it dhe të TED-it. Ai ka kontrata aktive me institucione partnere në shtetet anëtare të BE-së, në vende të treta dhe me partnerë të tjerë (Turqi, Rumania, vendet e CARDS-it, SHBA, Banka Botërore). OPP-ë monitoron **marrëveshjet kuadër** në përputhje me njoftimet për tendera vetëm për qëllime statistikore. *Informacioni Vjetor për Vlerësimin Statistikor të Procesit të Prokurimeve Publike* dërgohet zakonisht në qeveri në fund të muajit maj. OPP-ë nxjerr **Buletinin Kombëtar të Prokurimeve Publike** (të printuar dhe në version elektronik) dhe kontrollon nëse njoftimet i plotësojnë kërkesat. Në vitin 2005 u publikuan 13.052 kontrata. Publikime të tjera përfshijnë **Revisën e Prokurimeve Publike** (në 250 kopje), një konferencë ndërkombëtare vjetore, intervista dhe konferenca me median, si edhe bashkëpunim me gazetarët e shtypit të përditshëm dhe 119 publikime. Çdo autoritet ose ent kontraktues është përgjegjës për publikimin korrekt të njoftimeve të tij për tendera në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së. Në vitin 2005, punonjësi i Marrëdhënieve me Publikun iu përgjigj 786 kërkesave për informacion.

OPP-ë ka hartuar një **Program Kombëtar Trajnimi**, i cili ofrohet nga qendra trajnimesh të pavarura dhe të certifikuara. Në vitin 2005, 723 pjesëmarrës ndoqën 45 kurse treditore. OPP-ë lehtëson mësimdhënien dhe kërkimin e pavarur në universitete, në kolegjet e trajnimit dhe përmes kompanive private. Ajo ka përgatitur dhe publikuar prezantime për ligjin e ri të prokurimeve publike (APP) në vitin 2005 për ministrinë dhe në vitin 2006 për trajnerët. Që në shkurt 2006, sipas ligjit të ri të vitit 2005, “autoriteti kontraktues është i detyruar të njoftojë OPP-në me shkrim për fillimin e procedurës së negociuar pa publikimin menjëherë pas dërgimit të ftesës për të negociuar, megjithatë, jo më vonë se 14 ditë para mbylljes së kontratës”. OPP-ë përgjigjet vetëm për monitorimin dhe shqyrtimin e përdorimit korrekt të kësaj metode më pak konkurruese dhe jo për dhënien e ndonjë lejeje.

OPP është një **organ shqyrtues i Prokurimeve Publike** në kuptim të Nenit 2 (8) të Direktivës 92/13/EC. Ajo vendos gjoba ndaj autoriteteve kontaktuese që shkelin rregullat e prokurimeve publike. Në vitin 2005 pati 856 raste dhe ndaj 22 autoriteteve kontraktuese u vunë gjoba. **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve** midis enteve kontraktuese dhe kontraktorëve menaxhohet nga Drejtoria e Dispozitave të Brendshme dhe Vendimeve për Ankesat i OPP-së, i cili ka marrë 1089 kërkesa, prej të cilave 108 raste janë mbi kufirin monetar të BE-së. 16 apeline janë dërguar në Bordin e Apelimeve, i cili ka kërkuar bashkëpunimin e ekspertëve të pavarur. OPP-ë çon për ndjekjeçështjet që përbëjnë shkelje të ligjit të prokurimeve publike. Policia dhe Prokurori merren me rastet e korrupsionit dhe të shkeljeve të tjera penale në rastet e prokurimeve publike. Aktivitetet e prokurimeve publike të enteve kontraktuese auditohen nga kontrolli i brendshëm i OPP-së dhe nga një auditues i jashtëm. Masat disiplinore të OPP-së mund të prekin edhe

punonjësit individualë kontraktues: në vitin 2005 u dhanë 140 masa të tilla. OPP-ë nuk kryen ndonjë kontroll *ex ante* për kontratat.

OPP-ë **nuk merret me shqyrtimin gjyqësor** të prokurimeve publike. Vendime të tilla merren nga gjykata, e cila në vitin 2005 duhej të merrej me 22 raste.

OPP-ë e ka selinë në Bratislavë dhe kryesohet nga një **kryetar** i cili emërohet dhe shkarkohet nga qeveria. **Zëvendëskryetari** emërohet dhe shkarkohet nga qeveria me propozim të kryetarit. Kohëqëndrimi i tyre në detyrë është pesë vjetë me të drejtë rinovimi vetëm një herë. Sipas Nenit 111 të Ligjit Nr. 25/2006, kohëqëndrimi në detyrë i kryetarit dhe zëvendëskryetarit përfundon me mbarimin e afatit, me dorëheqje, me shkarkimin nga detyra nga qeveria ose me vdekjen apo me deklarin e vdekjes. Qeveria mund ta shkarkojë kryetarin dhe zëvendësin e tij nëse ata janë dënuar ligjërisht për një shkelje të rëndë, nëse humbasin aftësinë ligjore me një vendim të ligjshëm të gjykatës ose nëse kapaciteti i tyre ligjor është kufizuar, nëse ata kanë një detyrë ose kryejnë një aktivitet të papajtueshëm me punën e kryetarit ose të zëvendëskryetarit, nëse ata nuk e kanë ushtruar detyrën e tyre për një kohë mbi gjashtë muaj kalendarikë. Qeveria mund të pezullojë qëndrimin në detyrë të kryetarit dhe të zëvendëskryetarit nëse ndaj tyre është filluar një procedurë hetimore dhe e cila ka lidhje me detyrën. OPP-ë **ndahet** në Zyrën e Kryetarit, në Zyrën e Zëvendëskryetarit, në Drejtorinë e Legjislacionit dhe të Metodologjisë, në Drejtorinë e Revistës dhe të Listave, në Drejtorinë e Dispozitave të Brendshme dhe të Vendimeve për Ankesat, në Drejtorinë e Inspektimit, në Departamentin e Ekonomisë, të Teknologjisë së Informacionit, të Komisioneve dhe të Dëmshpërblimeve, në Departamentin e Integritit Europian dhe të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në Zyrën e Shërbimeve Shtetërore, dhe në Bordin e Apelit të Zyrës së Zëvendëskryetarit. Disa ndryshime organizative kanë ndodhur në fillim të vitit 2006 dhe kjo është skema organizacionale aktuale e OPP-së. Zyra ka një **staf** prej rreth 110 punonjësish, 90 prej të cilëve janë nëpunës civilë dhe 20 punonjës. Pothuajse i gjithë stafi ka arsim në nivel kolegji ose universiteti. Buxheti i OPP-së është zë i veçantë në buxhetin e shtetit (<http://www.finance.gov.sk/EN>). Në vitin 2005, ai ishte 58.42 milion SKK (1.475 milion euro). Gjjobat, tarifrat dhe garancitë përbëjnë të ardhura për buxhetin e shtetit.

OPP-ë ka tre **degë vendore** në Nitra (3 punonjës), Zilina (4 punonjës) dhe Košice (5 punonjës). Këto degë nuk kanë personalitet juridik më vete.

OPP-ë **nuk është e ngarkuar me kryerjen e funksioneve të blerjeve në nivel qendror**. Blerjet kryhen nga 7000 autoritete dhe ente kontaktuese të cilat janë plotësisht përgjegjëse për aktivitetet e tyre të prokurimeve publike. Qeveria ka plane të centralizojë blerjet e mallrave dhe të shërbimeve dhe të nxisë përdorimin e mjeteve elektronike në prokurimet publike. OPP-ë as nuk lehtëson koncesionet ose PPP-në, dhe as nuk administron një listë të zezë. Ajo mban një listë të të kualifikuarve, e cila në vitin 2005 përmbante 4.149 sipërmarrës (679 persona fizikë dhe 3.470 persona juridikë) dhe një listë të punonjësve të çertifikuar të prokurimeve. Në vitin 2005 u kryen 56 shqyrtime dhe nga 745 aplikantë, 697 persona iu shtuan listës së OPP-së, duke arritur një total prej 6.170 personash të kualifikuar në Republikën e Sllovakisë.

## 20. Sllovenia

Sllovenia ka një strukturë **gjysmë të centralizuar** të prokurimeve publike. Institucioni kryesor i prokurimeve publike i caktuar si i tillë nga një Ligj i Parlamentit, është **Departamenti për Prokurimet Publike, Infrastrukturën Publike dhe Koncesionet (DPPUC)**, i cili është pjesë e varur e Drejtorisë të Pronës Publike të Ministrisë së Financave (MoF). DPPUC-i nuk është i vetmi institucion prokurimesh publike, përderisa Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Shëndetësisë mbulojnë edhe ato disa detyra.

DPPUC-i kryen **funksione legjislative dhe politikëbërëse**, të tilla si hartimi i **legjislacionit** parësor e dytësor dhe hartimi i politikave të prokurimit, si edhe të procedurave dhe rutinave standarde, hartimi i dokumenteve standarde të kontratave dhe përgatitja e udhwzimeve. Ai u jep këshilla ligjore dhe këshilla të tjera enteve kontraktuese, ndrymarrjeve në infrastrukturë dhe tenderuesve. Në rolin e tij të **hartuesit të legjislacionit kombëtar për prokurimet**, DPPUC-i konsultohet me aktorë nga të dyja palët, do me thënë

me blerësit (kryesisht me organe në nivel qendror që drejtohen nga e drejta publike) dhe me shitësit (Dhoma e Tregtisë si ofruesi më i madh) nëpërmjet grupeve të punës në nivele të ndryshme. DPPUC-i është **pika e kontaktit** për Komisionin European, dhe kontribuesi kombëtar i Sllovenisë në komisionet këshillimore të BE-së, në UNCITRAL dhe në GPA. Ai merr pjesë në Rrjetin e Prokurimeve Publike. DPPUC-i nxjerr një **raport vjetor për qeverinë** në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimeve publike dhe grumbullon të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera. Ai nuk administron një listë të të kualifikuarve apo një listë të zezë. Për miratimin e prokurimeve me një ofertë të vetme ose me procedura më pak konkurruese dhe transparente nuk ekziston asnjë autoritet. Përgjegjësia bie mbi entin kontraktues, i cili përgjigjet për veprimet e tij tek autoriteti i shqyrtimeve dhe/ose i auditimit. Në vitin 2005 ishin 155 ente kontraktuese me një vëllim të përgjithshëm prokurimesh prej 108 milion eurosh.

DPPUC-i ka një **staf** të përbërë prej 8 nëpunësish civilë me kohë të plotë dhe me një formim akademik. Departamenti ka një përgjegjës, por nuk ka nënseksione. Detyrat e ndryshme janë ndarë midis anëtarëve të stafit. Financat e departamentit vijnë nga buxheti i përgjithshëm i ministrisë dhe i qeverisë.

**Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë** është përgjegjëse për publikimin e njoftimeve të prokurimeve dhe për kontrollin nëse reklammat i plotësojnë kërkesat. Numërimi kombëtar i njoftimeve të komunikuara në vitin 2005 nuk ka përfunduar ende.

Ekziston një **blerës qendror**: blerjet grumbullohen për disa mallra dhe shërbime për organe të ndryshme qeveritare në nivelin e qeverisë qendrore në Ministrinë e Administratës Publike (për njësitë administrative në nivel vendor dhe për disa artikuj të tillë si teknologjia e informacionit, mobiljet e zyrave, dhe automjetet). Ministria e Shëndetësisë prokuron pajisje mjekësore dhe disa mallra për spitalet dhe për institucione të tjera të kujdesit shëndetësor.

**Komisioni Kombëtar i Shqyrtimit** (NRC) është organi shqyrtues i prokurimeve publike në kuptim të Nenit 2 (8) të Direktivës 89/665/EEC. Në vitin 2005, NRC-ë auditoi 83 autoritete kontraktuese. Masa disiplinore nuk janë marrë ndaj punonjësve kontraktues, por 497 vendime iu nënshtruan vlerësimit të gjykatës. Nuk ka kontroll *ex ante* në formën e miratimit paraprak nga institucioni qendror i prokurimeve.

Nëpunësit civilë përgjegjës për prokurimet publike marrin pjesë në seminare të ofruara nga organizata private.

## 21. Suedia

Suedia ka një strukturë **gjysmë të centralizuar** të prokurimeve publike me një numër institucionesh qendrore përgjegjëse si edhe zgjidhje të decentralizuara në nivele vendore dhe rajonale. Në nivel qendror, organet kyçe të prokurimeve janë **NOU** (Nämnden for Offentlig Upphandling) dhe Ministria e Financave. Institucionet e prokurimeve në nivelet rajonale dhe bashkiake ofrojnë kryesisht këshillim ligjor dhe profesional për entet kontraktuese dhe iniciojnë një numër veprimesh me karakter zhvillimor. Duhet të vihet në dukje se shumë funksione kryhen nga sektori privat.

**Ministria e Financave** është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit parësor e dytësor dhe vepron si pika e kontaktit për Komisionin. Ministria ka caktuar një jurist për të kontribuar në UNCITRAL. Ministria ka tani tre nëpunës civilë me kohë të plotë që merren me çështjet e prokurimeve publike.

**NOU** është një organ mbikëqyrës që mbështet qeverinë. Ai është i përfshirë në politikëbërje, nxjerr opinione ligjore, ndihmon qeverinë përmes mbajtjes së kontakteve ndërkombëtare, dhe jep përgjigje me karakter këshillimor për ankesat nga tenderuesit ose për kërkesat e Komisionit European. Ai harton politikën e prokurimeve dhe përgatit udhëzimet, instruksionet dhe raportin vjetor për qeverinë në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimeve publike. Ai këshillon qeverinë në lidhje me politikën e prokurimeve publike dhe ofron informacion për legjislacionin dhe praktikën ligjore për entet kontraktuese, shërbimet në infrastrukturë dhe tenderuesit. Në vitin 2005, NOU organizoi edhe një konferencë mbi prokurimin për 500 pjesëmarrës. Në kontekstin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis enteve kontraktuese dhe tenderuesve, NOU mund të japë një mendim i cili nuk ka forcë detyruese. Megjithatë, ai nuk e ka

kompetencë në për të pezulluar procedurat ose për të caktuar kompesime. NOU varet nga Ministria e Financave por është i pavarur në veprimtarinë e vet të përditshme.

NOU është një **bord kombëtar** dhe anëtarët e tij emërohen nga qeveria me propozim nga aktorë të ndryshëm. I gjithë bordi, me të tetë anëtarët e tij, është kreu kolektiv i NOU-t. Anëtarët janë përfaqësues të autoriteteve kontraktuese ashtu edhe të tenderuesve. **Kryetari** është një gjykatës, i cili është edhe përgjegjës i departamentit nga Gjykata Administrative e Apelit. Bordi mbledhet një herë në muaj. Veprimtaria e tij e përditshme drejtohet nga një **sekretariat**, i cili ka nëntë ose dhjetë punonjës (kryesisht juristë dhe ekonomistë me diplomë universitare) dhe i cili kryesohet nga një **drejtor**. Sekretariati nuk ndahet në seksione. Në vitin 2005, NOU kishte një **buxhet** prej 9 milion SEK (afërsisht 994.750 euro) i cili jepet nga buxheti i përgjithshëm të qeverisë.

Bashkë me Ministrinë e Financave, NOU organizon kontributin kombëtar në komisionet këshillimore të BE-së, merr pjesë në PPN-ë dhe jep informacion për legjislacionin e ri për prokurimet publike. Kontributi kombëtar në GPA organizohet nga **Ministria e Jashtme** me mbështetjen e NOU-t dhe të **Bordit Kombëtar të Tregtisë (Kommerskollegium)**. NOU me ndihmën e **Agjencisë Shtetërore të Statistikave të Suedisë**, grumbullon të dhëna statistikore për prokurimet publike.

Legjislacioni propozohet nga një **komision qeveritar** dhe u dërgohet për konsultim autoriteteve, qeverisjes vendore dhe çdo aktori të interesuar, para se propozimi të kalohet në **parlament**. Në dhjetor të vitit 2005, ministri përgjegjës organizoi një seancë dëgjimore me aktorë të tillë si përfaqësues të blerësve publike, qeverisjen vendore, firmat ligjore, Dhomat e Tregtisë dhe NOU.

Hartimi i procedurave dhe rutinave standarde, hartimi i dokumenteve standarde të tenderave, dhe hartimi i dokumenteve standarde të kontratave janë detyra të **njësive të ndryshme**.

**Autoriteti i Konkurrencës** monitoron konkurrencën dhe në teori mund të ndërhyjë në rastet që kanë të bëjnë me ligjin e konkurrencës ose me keqpërdorimin e procedurave të prokurimeve.

Administrimi i **buletineve** të prokurimeve publike (në versionin e printuar apo në atë elektronik), përfshirë edhe kontrollin e reklamave për përmbushjen e kërkesave, bëhet nga **kompani private**, të tilla si Allego, Opic dhe të tjera.

Koordinimi i Prokurimeve Qeveritare dhe Shoqata Suedeze e Qeverisjes Vendore dhe Rajonale ofrojnë disa **këshilla**.

**Kurset e trajnimit** për prokurimet publike ofrohen nga Shoqata Suedeze e Blerësve Publikë dhe Allego. Pjesë e arsimit juridik universitar në Stockholm dhe Linköping janë edhe një kurs për blerësit dhe një kurs i posaçëm për juristët.

NOU dhe Autoriteti i Konkurrencës përfshihen kohë pas kohe në **kërkime**, por nuk ka programe kërkimi.

**Marrëveshjet kuadër** përdoren në prokurimet e përbashkëta të qeverisë dhe të qeverisjes vendore. Çdo autoritet që blen sasi të mëdha ose që ka njohuri të veçanta në disa fusha mund të bëjë një marrëveshje kuadër për të plotësuar nevojat e veta-dhe ato të autoriteteve të tjera-për mallra ose shërbime. Forcat e Armatosura të Suedisë për shembull, kanë një marrëveshje kuadër për udhëtime dhe akomodime hoteliere. Të tjerë i blejnë shumicën e pajisjeve të tyre të teknologjisë së informacionit dhe shërbimet po në të njëjtën mënyrë. Rreth 12% të të gjitha kontratave janë pjesë e marrëveshjeve kuadër të qeverisë por **nuk ekziston një institucion qendror blerjesh**. Prokurimi elektronik përdoret në disa raste, por nuk ka një procedurë të plotë të prokurimeve elektronike. Ajo që ekziston është kryesisht porosia dhe faturimi elektronik.

**Organet shqyrtuese** të prokurimeve publike, në kuptim të Nenit 2 (8) të Direktivës 89/665/EEC, janë 24 gjykatat administrative të cilat shqyrtojnë procedurat e kryera për rpara përfundimit të kontratave si edhe gjykatat civile të cilat merren me kompensimet. Edhe **arbitër** ka, por shërbimi i tij nuk është përdorur asnjëherë.



Ka plane për forcimin e sistemit të monitorimit dhe zhvillimin e **njesisë së praktikave më të mira**. Hollësi në lidhje me këto plane ende nuk janë bërë të njohura. Pritet të ketë legjislacion të ri diku aty nga gjysma e dytë e vitit 2007.

## 22. Mbretëria e Bashkuar

Mbretëria e Bashkuar ka një strukturë **gjysmë të centralizuar** të prokurimeve publike, por me **Zyrën e Tregtisë të Qeverisë (OGC)** si institucion kyç Megjithatë, një numër funksionesh në nivel kombëtar kryhen bashkarisht me disa organe dhe qeveritë rajonale të Skocisë, Irlandës së Veriut dhe të Uellsit kanë institucionet e tyre.

OGC është ngritur me vendim ministror në vitin 2000 pas shqyrtimit nga Sir Peter Gershon të prokurimeve civile qeveritare. Ky person u bë drejtori i parë ekzekutiv i organizatës. OGC u formua si një zyrë e pavarur e Thesarit të Madhërisë së Saj (Ministria e Financave), duke shkrirë një numër organizatash të prokurimeve qendrore dikur të distrikteve, përfshirë këtu Agjencinë e Blerjeve, Këshilluesit e Pronave për Pronat Shtetërore, Agjencinë Qendrore të Kompjuterave dhe të Telekomunikacioneve dhe Njësinë e Prokurimeve Publike të Thesarit. Krijimi i OGC-së pasqyroi njohjen e posaçme **të nevojës për një depozitim të fortë në nivel qendror të ekspertizës për çështjet e prokurimeve** për të ndihmuar sektorin publik të arrijë rezultate më të mira nga aktivitetet e tij tregtare që mbështesin qëllimet ambicioze të qeverisë për shpërndarjen e shërbimeve publike. Fusha e veprimit e OGC-së tani shtrihet përtej mandatit fillestar të qeverisë qendrore civile dhe po luan një rol kyç në çuarjen përpara të përpjekjeve të qeverisë për të arritur efikasitet edhe më të lartë në administratën publike. Këto përfshijnë: kursimin e parasë së thatë, e cila përdoret për të investuar në shërbimet e linjës së parë të frontit; rritjen e masës së suksesit të projekteve dhe programeve madhore të sektorit publik pjesërisht përmes përdorimit të një sistemi zyrtar të shqyrtimit të statusit të projekteve; lehtësimin e funksionimit efektiv të tregut të prokurimeve publike, të organizimit të administratës dhe të menaxhimit. Shumica e **legjislacionit** të Mbretërisë së Bashkuar është legjislacion dytësor. Juristë nga **Departamenti i Ministrisë të Thesarit** që e kanë zyrën në OGC janë përgjegjës për hartimin e legjislacionit nën drejtimin e OGC-së. **Konsultimi** përfshin zakonisht publikimin e një dokumenti konsultimi i cili përcakton çështjen që shqyrtohet dhe iniciativat e propozuara që e shoqërojnë atë. Pastaj aktorët e interesuar ftohen të japin përgjigje brenda një afati që caktohet në këtë rast. Përgjigjet pastaj studiohen dhe ripunohet politika e propozuar në mënyrën që shihet e përshtatshme. I gjithë procesi duhet të kryhet në përputhje me Kodin e Praktikës së Konsultimeve i cili përgatitet nga Zyra Ekzekutive e Rregullave më të Mira e Zyrës së Kabinetit. Hartimi i procedurave dhe rutinave **standarde**, i dokumenteve standarde të tenderave, i dokumenteve standarde të kontratave, dhe i udhëzimeve dhe instruksioneve janë pjesë e detyrave të OGC-së. Megjithatë, me këtë aktivitet merren edhe organizata të tjera brenda fushës së tyre të interesit. OGC-ë harton **politikën e prokurimeve** dhe është pika e kontaktit për Komisionin. Ajo është përgjegjëse për kontributin kombëtar në komisionet këshillimore të BE-së, për pjesëmarrjen në PPN-ë dhe për kontributin kombëtar në UNCITRAL dhe GPA dhe për **përfaqësimin e tjera ndërkombëtare**. Qeverisë nuk i dërgohet ndonjë raport vjetor mbi funksionimin e sistemit të prokurimeve publike, por OGC-ë përmbush një funksion të ngjashëm. Detyra të tjera të OGC-së janë edhe grumbullimi i **të dhënave statistikore dhe i të dhënave të tjera** si edhe përgatitja e udhëzimeve. Në vitin 2005 u hartuan rreth 10 dokumente të tilla zyrtare. OGC-ë administron një listë të punonjësve të çertifikuar të prokurimeve. OGC-ë publikon dhe përhap informacion mbi legjislacionin dhe politikën. Në vitin 2005 u publikuan rreth 10 zëra udhëzimesh të tilla. **Këshillimi i qeverisë** mbi politikën e prokurimeve publike është një funksion tjetër i rëndësishëm i OGC-së. OGC-ë jep edhe këshilla ligjore dhe këshilla të tjera për entet kontraktuese, për shërbimet në infrastrukturë dhe për tenderuesit (këshilla të përgjithshme dhe jo për raste specifike - autoriteteve kontraktuese u kërkohet ta kërkojnë ndihmën ligjore nga juristët e vet). OGC-ë merr pjesë në aktivitete akademike kombëtare e ndërkombëtare mbi ligjin e prokurimeve publike, ekonominë dhe politikën. Në vitin 2005 u mbajtën 10 aktivitete të tilla.

OGC-ë ka një departament juridik, një departament të politikave ose departament qendror, një departament për organizimin dhe financat. Roli i **Drejtorisë për Politikën e Prokurimeve (PPD)** i OGC-së ka për detyrë të përfaqësojë Mbretërinë e Bashkuar në çështjet e prokurimeve në Komisionin Europian, në

partnerë të tjerë të BE-së dhe në OBSH-ë e në vendet anëtare të saj, dhe të ndihmojë organet e sektorit publik të Mbretërisë së Bashkuar (MB) për të zbatuar rregullat në MB. Ajo ka rol drejtues në politikën e qeverisë për të arritur VFM-së në prokurimet publike. Ky rol përfshin studimin, këshillimin dhe hartimin e udhëzimeve me qëllim që të mbahen parasysh çështje të tilla si për shembull, që ndrueshmëria, brenda kuadrit të ligjeve dhe të politikave. Dy njësitë kryesore funksionale të PPD-së janë ekipet që merren me: 1) hartimin e politikave të prokurimeve, në veçanti në lidhje me çështjet e BE-së dhe të OBSH-së dhe 2) zbatimin e asaj politike duke u dhënë ndihmë organizatave të aktorëve në zbatimin e politikave të cilat është përpjekur të formësojë ekipi tjetër. PPD-ë mbikëqyret nga një nëpunës i lartë civil, i mbështetur nga Zyra e Menaxhimit të Drejtorive e cila raporton tek njëri prej drejtorëve ekzekutivë në lidhje me bordin e menaxhimit të OGC-së. **Ekipi i Shërbimeve Juridike** i OGC-së mbështet aktivitetet e PPD-së krahas pjesës tjetër të OGC-së duke dhënë këshilla mbi hartimin dhe zbatimin e politikave nga një këndvështrim ligjor. Në ekipin ligjor të OGC-së punojnë tetë persona. Mendohet se në vitin financiar 2005-2006 shpenzimet e OGC-së në të gjithë organizatën do të jenë rreth 58 milion GBP (afërsisht 86.117 milion euro). PPD-së i është alokuar një buxhet prej mbi 1 milion GBP (afërsisht 1.485 milion euro) për vitin financiar aktual. Këto shifra mbulojnë të gjitha kostot korrente dhe vetëm një pjesë e vogël do të duhet të merret nga burimeve të jashtme për mallrat dhe shërbimet. Buxheti korporativ vjetor i OGC-së miratohet nga Thesari i Madhërisë së Saj pas diskutimeve mbi përlogaritjet e niveleve të burimeve të kërkuara për realizimin e planit të tij të biznesit, i cili përbëhet nga planet e biznesit të njësisë të veçanta organizative. Planet dhe buxhetet e bizneseve individuale merren në shqyrtim nga Bordi i Investimeve dhe i Zbatimit i OGC-së, i cili garanton që burimet e alokuara për elementë të ndryshëm të organizatës të përputhen me përparësitë e gjithë korporatës. Buxheti i PPD-së miratohet po në të njëjtën mënyrë me atë të njësisë të tjera organizacionale. OGC-ë aktualisht punëson rreth 500 njerëz, shumica e të cilëve janë nëpunës civilë por edhe konsulentë. Prej këtyre, vetëm një pjesë e vogël merret me punët e politikave qendrore të prokurimeve publike, rreth 25 në tërësi. Formimi arsimor është i ndryshëm. Shumica e stafit të PPD-së ka marrë trajnim profesional për prokurimet dhe shumica e njohin mirë ligjin e prokurimeve publike dhe të drejtë europiane. Një pjesë e madhe e anëtarëve të stafit i njohin aspektet financiare dhe teknike të prokurimeve.

**Shkolla Komëtare e Qeverisjes dhe Instituti i Licensuar për Blerje dhe Oferta** bashkëpunojnë për mbajtjen dhe kryerjen e trajnimeve për prokuruesit publikë. OGC-ë jep ndihmën e vet në lidhje me përmbajtjen e trajnimeve.

Për lehtësimin e marrëveshjeve kuadër punojnë organizata të ndryshme. Më të rëndësishmet janë **Buying Solutions** (një njësi e OGC-së) dhe **Agjencia Kombëtare për Blerje dhe Oferta për Shërbimin Shëndetësor (PASA)**, por në këtë fushë veprojnë edhe organe të tjera si **konsorciumet rajonale të blerjeve në qeverisjen vendore** dhe **Shërbimi Kombëtar i Shëndetësisë**. **Buying Solutions** ka pasur aktive disa qindra marrëveshje. PASA ka pasur 4.500. Partneritetet MB dhe 4P-të gjithashtu lehtësojnë PPP-nw dhe koncesionet e saj. Prokurimi elektronik menaxhohet nga organizata të ndryshme, përfshirë **Buying Solutions** të OGC-së dhe **Departamentin e Komuniteteve dhe të Qeverisjes Vendore**. **Buying Solutions** mbikëqyr tre skema kryesore të prokurimeve elektronike.

OGC-ë nuk vepron si një organ qendror blerjesh për sektorin publik. Ky funksion realizohet nga Agjencia Ekzekutive e OGC-së, **OGC Buying Solutions**, e cila vetëfinancohet përmes aktiviteteve të veta dhe ka drejtorin e vet ekzekutiv. Kjo agjenci është anëtare e bordit të përgjithshëm të menaxhimit të OGC-së. Megjithatë, organet e sektorit publik nuk janë të detyruara të përdorin shërbimet e **Buying Solutions** nëse ata besojnë se mund të bëjnë blerje më të mira me parimin e VFM-së.

Në blerjet qendrore janë përfshirë organizata të ndryshme. Më të rëndësishmet janë **Buying Solutions** e OGC-së dhe **Agjencia Kombëtare për Blerje dhe Furnizime për Shërbimin Shëndetësor (PASA)**. Funksionet e **Buying Solutions** e OGC-së shtrihen në të gjithë sektorin publik të MB-së (mbi 100 autoritete kontraktuese). Fusha e veprimtimit e PASA-s është vetëm **Shërbimi Kombëtar i Shëndetësisë** (rreth 500 autoritete kontraktuese). Shpenzimet e përgjithshme të prokurimeve të sektorit publik në vitin 2005 ishin mbi 100 milion GBP (148.5 milion euro). Shpenzimet e përgjithshme përmes **Buying Solutions** në

vitin 2005 ishin mbi 2 miliard GBP (2.97 miliard euro). Shpenzimet e përgjithshme përmes PASA-s gjatë vitit financiar 2004/2005 ishin 3.6 miliard GBP (5.35 miliard euro). Siç u vu në dukje më sipër, ekzistojnë edhe organe të tjera qendrore të blerjeve, të tilla si konsorciumet e blerjeve të autoriteteve vendore.

Shqyrtimi i vendimeve për prokurimet në Mbretërinë e Bashkuar është përgjegjësi e sistemit të gjykatave kombëtare, i cili mbikëqyret nga Departamenti i Çështjeve Kushtetuese, por që është i ndarë nga funksionet ekzekutive të aparatit shtetëror. Konkretisht, rastet e Anglisë dhe të Uellsit do të dëgjohen nga Gjykata e Lartë. Kjo gjykatë është e ngarkuar të merret posaçërisht me dëgjimin e rasteve civile të këtij lloji. Në përgjithësi, veprat penale të tilla si korrupsioni, hetohen nga një numër autoritetesh hetimore në varësi të natyrës dhe të seriozitetit të veprës së kryer. Masat disiplinore ndaj punonjësve kontraktues të veçantë janë përgjegjësi e autoriteteve kontraktuese individuale.

Disa prokurime të rëndësishme publike kryhen në administratat e decentralizuara rajonale të Skocisë, Irlandës së Veriut si edhe në zyrat e prokurimeve në kontetë, në zyrat e prokurimeve publike të bashkive dhe në zyrat e grupeve të bashkive. Baza ligjore për këto njësi është e ndryshme meqë modeli i shpërndarjes së funksioneve është kompleks dhe ka edhe një mbivendosje midis organeve të ndryshme që kontrollohen nga qeveritë qendrore dhe vendore. Organet që luajnë një rol në interpretimin e politikave të prokurimit në nivel rajonal përfshijnë administratat e decentralizuara në tre vende të tjera përveç Anglisë të cilat kanë një bazë ligjore: Agjencia e Përmirësimit dhe e Zhvillimit për Qeverisjen Vendore dhe Qendrat Rajonale të Ekselencës së Prokurimeve në të cilat kontribuojnë grupet rajonale të autoriteteve vendore. Marrëdhëniet e midis tyre janë komplekse dhe nuk janë të përkufizuara saktësisht në pikëpamje hierarkike. Megjithatë, në përgjithësi organet nën nivelin kombëtar merren me ofrimin e udhëzimeve për zbatimin e politikave të përgjithshme të prokurimit në MB dhe të ligjit brenda fushës specifike të veprimit. Së fundi, interpretimet e tyre për politikën dhe legjislacionin varen shumë nga drejtimi i organit kombëtar i cili është OGC-ë e PPD-së.

Struktura e prokurimeve në nivel qendror e Mbretërisë së Bashkuar është komplekse. Ajo përbën një kompromis midis një qasjeje qendrore dhe hierarkike dhe një qasjeje federale dhe të decentralizuar dhe pasqyron kompleksitetin e marrëdhënieve midis krahëve qendrorë, rajonalë e vendorë të administratës publike. Megjithatë, kjo ka kuptimin që ajo e ka elasticitetin dhe reagimin që është në një qasje e cila është vetëm pjesërisht e federuar. Në të njëjtën kohë, drejtimi në nivel qendror realizohet nga organi qendror më i rëndësishëm i prokurimeve - OGC-i cili i jep një përqendrim të fortë qendror politikës së prokurimeve shumë pranë qendrës së qeverisë dhe përfaqëson Mbretërinë e Bashkuar në diskutimet e rëndësishme me partnerët ndërkombëtarë. Organet nën nivelin kombëtar janë në gjendje të përqendrohen në interpretimin e politikave brenda kontekstit specifik të fushës së veprimit të tyre dhe t'i lidhin ato me nevojat e tyre përkatëse.